



AUTORITETI I MBIQYRJES FINANCIARE

2016


Raporti Vjetor

© 2017

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.
Adresa: Rruga "Dora D'Istria", Nr. 10, P.O.Box. 8363, Tiranë
Tel: +355-4-2251355 / 6
Faks: +355-4-2250686
E-mail: amf@amf.gov.al
Web: www.amf.gov.al



Fjala Përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

I nderuar Lexues,

Me kënaqësi të veçantë, në emër të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, po ju paraqes Raportin Vjetor për vitin 2016, i cili përmban një pasqyrë të plotë të veprimtarisë sonë përgjatë këtij viti.

Misioni i Autoritetit është mbikëqyrja dhe rregullimi i tregjeve financiare për të garantuar sigurinë, transparencën dhe besueshmërinë e konsumatorëve në këto tregje, si dhe krijimin e sinergjisë me të gjithë aktorët për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2016 u përqendrua në konsolidimin e kuadrit rregullativ, në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, analizën e rreziqeve si edhe zbatimin e projekteve të asistencës. Autoriteti ka vepruar për nxitjen dhe mbështetjen e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare, si dhe për të siguruar ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve nën mbikëqyrje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bordi i Autoritetit ka aprovuar rregullore të reja në funksion të mbikëqyrjes dhe rregullimit efektiv të tregut të sigurimeve, pensioneve private vullnetare dhe fondeve të investimit.



Ervin Koçi
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Në fund të vitit 2016, totali i aktiveve për të tre tregjet financiare, tregun e sigurimeve, të fondeve të pensioneve private vullnetare dhe fondeve të investimeve ishte 96.6 miliardë lekë, me një rritje të lehtë prej 1.1% krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2016, **industria e sigurimeve** ka patur zhvillime pozitive në drejtim të zgjerimit të tregut. Megjithatë, tregu i sigurimeve në Shqipëri vijon të jetë kryesisht i orientuar drejt produkteve të sigurimit të detyrueshëm dhe të ketë shkallën më të ulët të penetrimit krahasuar me vendet e rajonit. Zhvillimi i produkteve vullnetare dhe atyre të Jetës mbetet një prioritet kyç, pasi ky segment i tregut, me gjithë tendencën e tij në rritje, zë një peshë të ulët në portofolin e produkteve të tregut të sigurimeve. Aplikimi i sistemit *Bonus-Malus* do të jetë një nga prioritetet e Autoritetit në vazhdimësi.

Edhe gjatë vitit 2016, **tregu i pensioneve private vullnetare** ka shënuar rritje të aseteve si dhe rritje të numrit të anëtarëve krahasuar me vitin 2015. Megjithatë vlera e aseteve mbetet ende në një masë të papërfillshme kundrejt PPB-së në Shqipëri, pra një potencial për rritje në të ardhmen.

Zhvillim i rëndësishëm në **tregun e fondeve të investimeve** gjatë vitit 2016 ishte licencimi i shoqërisë së dytë administruese të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, duke krijuar premisat për rritjen e konkurrencës në këtë treg. Ecuria e këtij tregu paraqitet në nivele të njëjta në vitet e fundit, megjithëse, gjatë vitit 2016 ky treg pati një rënie të lehtë të aseteve. Forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve, nëpërmjet përmirësimit të administrimit të rreziqeve dhe rritjes së transparencës, përbën një tjetër drejtim zhvillimi për Autoritetin.

Autoriteti po harton një paketë të gjerë masash për informim dhe ndërgjegjësim të publikut lidhur me rreziqet që mbartin format e reja të investimit, sidomos ato online. Të gjitha këto do të rrisin më tej besimin e konsumatorit te roli i Autoritetit për mbrojtje të interesave të tij.

Gjatë vitit 2016, Autoriteti ka zgjeruar bashkëpunimin me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare. Asistenca e Bankës Botërore, Sekretariatit të Shtetit Zvicerian për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC) për qëndrueshmërinë dhe rritjen e burimeve njerëzore, kanë siguruar mbështetje insitucionale në punën e Autoritetit. Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullative të institucionit për t'iu përgjigjur dinamikës së tregjeve nën mbikëqyrje, mbetet një nga objektivat kryesore për vitet në vazhdim.

Autoriteti, në kuadrin e procesit të integritit evropian të vendit, po punon për përafrimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës për tregjet financiare jobankare me *acquis* të BE-së. Forcimi i llogaridhënies, rritja e transparencës përmes një komunikimi të hapur me publikun, si dhe rritja e nivelit të edukimit financiar të konsumatorit mbeten drejtime të rëndësishme të zhvillimit të institucionit. Autoriteti është i përkushtuar të ndërtojë një sistem mbikëqyrës të drejtë, efektiv dhe transparent në mbrojtje të konsumatorëve dhe investitorëve të ndershëm.

Raporti në vijim ofron një pasqyrë të detajuar të tregjeve financiare, si dhe do t'ju njohë më në detaje me punën e Autoritetit gjatë vitit 2016, rolin e tij në ruajtjen e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare jobankare dhe kontributit të tyre në stabilitetin financiar të vendit.

Besoj se ky Raport përcjell te Ju informacion të dobishëm dhe me interes.

Me respekt,




Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Misioni, Objektivat, Funksionet Kryesore	7
Veprimtaria e Bordit të AMF-së	8
Përbushja e Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për Vlerësimin e Veprimtarisë Financiare për Vitin 2016	10
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	16
Kapitulli 1	
Tregu i titujve	21
1 Tregu i fondeve të investimit në Shqipëri	21
2 Ndërmjetës të tjerë financiarë	31
Kapitulli 2	
Tregu i sigurimeve në Shqipëri	35
3 Aspekte të tregut të sigurimeve në Shqipëri	35
4 Të ardhurat nga primet	44
5 Pozicioni Financiar	50
6 Ecuria e tregut të sigurimeve	61
7 Sigurimi i detyrueshëm motorik: Primet dhe Dëmet	64
8 Kuadri Ligjor dhe Rregullator	67
9 Mbikëqyrja e kujdesshme me fokus riskun	72
10 Mbrojtja e konsumatorit	79
11 Edukimi për sigurimet – Qendra e Edukimit	85
12 Byroja Shqiptare e Sigurimit	86
13 Inspektimet	89
14 Masat mbikëqyrëse dhe administrative	89
Kapitulli 3	
Tregu i pensioneve private vullnetare	92
15 Struktura e Tregut	92
16 Mbikëqyrja dhe Analiza e Rreziqeve të Tregut	93
17 Pozicioni Financiar	94
18 Kuadri ligjor dhe rregullator	96
19 Transparenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit	98
Kapitulli 4	
Projektet, Partneriteti, Bashkëpunimi Rajonal, Proceset Integruese	99
20 Partneriteti Kombëtar	99
21 Partneritete dhe Anëtarësime në Organizata Ndërkombëtare	100
22 Bashkëpunimi Rajonal	102
23 Projektet	104
24 Proceset Integruese për Tregjet në Mbikëqyrje	108

Kapitulli 5	
Organizimi	113
25 Kuadri Ligjor dhe Rregullator i AMF-së	113
26 Struktura Organizative dhe Politikat e Burimeve Njerëzore	114
27 Pasqyrat Financiare	116
28 Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	117
29 Auditi i Brendshëm	118
30 Sfidat dhe Objektivat	119
SHTOJCA	122
A: Struktura e AMF-së	
B: Lista e institucioneve të mbikëqyrura	
C: Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshtruara nga AMF	
D: Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
E: Pasqyrimi mediatik për tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së	



Misioni, Objektivat, Funkcionet Kryesore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur e që raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Ai vepron në dobi të interesit publik me mision themelor sigurimin e funksionimit efektiv të tregjeve financiare jobankare, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Në këtë mënyrë AMF kontribuon njëkohësisht edhe në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar shqiptar në tërësi.

Në funksion të realizimit të këtij misioni AMF ushtron:

- Funksionin Rregullativ, i cili përfshin ndërtimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor e rregullativ për hyrjen në treg dhe zhvillimin e veprimtarisë së institucioneve që mbikëqyren, si edhe përmirësimin e këtij kuadri nëpërmjet adoptimit të standardeve ndërkombëtare dhe direktivave të Bashkimit Evropian;
- Funksionin Mbikëqyrës, i cili realizohet përmes monitorimit dhe një mbikëqyrjeje të kujdesshme në distancë dhe kontrolleve në vend të aktivitetit të operatorëve të licencuar të tregut, si edhe zbatimit të masave korrektuese sipas kuadrit rregullativ. Për ushtrimin e këtij funksioni AMF aplikon metodologjinë e mbikëqyrjes me bazë rrezikun, e cila mundëson realizimin efektiv të misionit të AMF-së, me një përdorim më eficient të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Funksioni rregullativ dhe mbikëqyrës i AMF-së realizohet në shërbim të krijimit të një tregu të qëndrueshëm dhe mbrojtjes konsumatore.

Konkretisht AMF licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të letrave me vlerë dhe operatorëve të tij, aktivitetin e tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tij, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare. Rritja e pavarësisë institucionale dhe pavarësia financiare, të parashikuara në Ligjin nr. 54, datë 29.05.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”” synojnë forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së.

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, AMF synon:

- Mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe konsumatorëve;
- Nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyren;
- Sigurimin e respektimit të ligjit.

Veprimtaria e Bordit të AMF-së

Bordi i AMF-së gjatë vitit 2016 përbëhej nga 5 anëtarë:

Z. Pajtim Melani, Kryetar Bordi
Znj. Enkeleda Shehi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv
Z. Arjan Salati, Anëtar
Z. Klodion Shehu, Anëtar

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 37/2017, miratoi më 6 prill 2017, në seancë plenare, emërimin e Z. Ervin Koçi, si anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.




Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, prill 2017

Në përmbushje të funksioneve të tij, gjatë vitit 2016, Bordi i AMF-së, ka zhvilluar 17 mbledhje dhe ka marrë 228 vendime. Tabela më poshtë, pasqyron numrin e vendimeve të Bordit të AMF-së të ndarë sipas llojeve.

Tabela 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	160
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	22
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare	3
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	5
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	19
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së	19
Vendime në tërësi	228



Sikurse shihet edhe në tabelë, numrin më të madh të vendimeve e zënë ato të lidhura me tregun e sigurimeve. Në tërësi, në vendimet e Bordit përfshihen vendimet për masat administrative dhe korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së tyre; për përcaktimin dhe mënyrën e shlyerjes së vlerës së Fondit të Kompensimit; për miratimin apo ndryshimin e statuteve apo prospekteve të shoqërive, kryesisht për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë por dhe të emetimit të dëftesave tregtare; për miratimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo bordit drejtues të shoqërive; dhe për miratimin e ndërmjetësve në sigurime. Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me qëllim promovimin e rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për aktuarët, Bordi miratoi Kodin Etik të Aktuarëve. Në mbështetje të zbatimit të rekomandimeve të FSAP 2013 për forcimin dhe zhvillimin e pensioneve private në Shqipëri, në kuadër të projektit të financuar nga programi FIRST Initiative me asistencën e Bankës Botërore, u miratua Manuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit. Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave u miratua në kuadër të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar.

Me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tregjeve dhe të institucioneve të mbikëqyrura, si edhe të vetë Bordit, Bordi i Autoritetit ka miratuar 17 rregullore dhe 17 ndryshime ose shtesa në rregulloret ekzistuese.

Gjatë këtij viti, Komiteti Këshillimor i ngritur nga Bordi, hartoi dokumentin e zhvillimit strategjik të tregut të sigurimeve, me qëllim dhënien e rekomandimeve për zhvillimin, zgjerimin dhe diversifikimin e tregut të sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare në Shqipëri.

Përmbushja e Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për Vlerësimin e Veprimtarisë Financiare për Vitin 2016

Në vijim paraqitet ecuria e zbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015", për të gjitha pikat e saj:

1. Forcimi i integritetit institucional dhe rolit mbikëqyrës, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve inspektuese dhe audituese, për kryerjen e inspektimeve me fokus rrezikun dhe hartimin e një një plani të qartë për kryerjen e këtyre inspektimeve në të gjitha shoqëritë e sigurimeve.

Gjatë vitit 2016 janë marrë disa masa në funksion të forcimit të integritetit të institucionit dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, që janë:

- Punësimi në AMF i stafit të ri dhe trajnimi i tyre;
- Miratimi i rregulloreve të reja dhe amendimi i disa rregulloreve ekzistuese;
- Amendime ligjore;
- Zbatimi i manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun;
- Inspektime të plota për 3 shoqëri sigurimi dhe inspektime tematike për 5 shoqëri sigurimi, nga të cilat një prej tyre në bashkëpunim me DPPP dhe një në bashkëpunim me Autoritetin Mbikëqyrës të Maqedonisë;
- 40 analiza *off-site* për të 10-ta shoqëritë e sigurimit.

Inspektimet janë kryer sipas praktikave më të mira ndërkombëtare me fokus rrezikun duke u përqendruar në identifikimin dhe analizimin e rreziqeve që karakterizojnë aktivitetet e biznesit të shoqërive të sigurimit, si dhe aftësinë e administrimit dhe zbutjes së tyre nga menaxhimi dhe drejtuesit e lartë të shoqërive.


2. Të evidentohen problematikat në lidhje me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe në përgjithësi për Fondin e Kompensimit dhe Autoriteti të shqyrtojë dhe përdorë hapësirat ligjore për zgjidhjen e tyre në funksion të respektimit të të drejtave dhe trajtimit të barabartë të investitorëve.

Gjatë vitit 2016 Autoriteti ka propozuar ndryshime të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, të cilat ndër të tjera synojnë edhe rregullimin e administrimit të Fondit të Kompensimit dhe funksionimin e dy institucioneve të veçanta si Byroja e Sigurimit për Kartonin Jeshil (sigurimi motorik ndërkombëtar) dhe Enti i Kompensimit për rregullimin e veprimtarisë në tregun e brendshëm.

Bordi ka zhvilluar një seancë dëgjimore me drejtuesit e shoqërive të sigurimit për zgjidhjen e problematikës së trashëguar të Fondit të Kompensimit dhe ka marrë një sërë vendimesh rregullative dhe administrative ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit:

- Vendimin nr. 119, datë 19.07.2016 "Për Marrjen e Masave lidhur me Përzgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit";
- Vendimin nr. 158, datë 03.10.2016 "Mbi Auditimin e Veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimit".

Në vijim, gjatë vitit 2017, puna e Autoritetit do të përqendrohet tek evidentimi dhe dhënia zgjidhje e problemeve të akumuluar ndë vite në Byronë Shqiptare të Sigurimit. Për këtë



qëllim është planifikuar që gjatë vitit 2017 Byroja Shqiptare e Sigurimeve të kryejë auditimin e veprimtarisë nga auditues të pavarur, ndërsa do të kryhen inspektime në vend nga ana e Autoritetit.

3. Të vazhdojë të monitorojë plotësimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimit ndaj Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve për kryerjen e pagesave të dëmeve objekt i këtij Fondi në kohën e duhur, duke hartuar një plan shlyerje në zbatim të rekomandimeve të FSAP.

Gjatë vitit 2016 ka vijuar të monitorohet zbatimi i vendimeve të Bordit të AMF-së për kryerjen e pagesave të Fondit të Kompensimit. Hartimi i planit të shlyerjes do të ndiqet dhe monitorohet nga Autoriteti gjatë vitit 2017.

Autoriteti, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me qëllim shlyerjen e gjithë detyrimeve që i përkasin ngjarjeve të sigurimit 2002-2006, si dhe në zbatim të vendimit të Bordit nr. 35, datë 24.03.2016 “Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016”, ka marrë Vendimin nr. 185, datë 31.10.2016, “Për pagesat e praktikave Fond Kompensimi”.

4. Të verifikohet algoritmi i serverit dhe sistemi i TI-së në lidhje me sistemin e shitjes së të gjithë tregut, në përdorim të brokerit, i cili tregon TPL, Karton jeshil dhe kufitare, për të siguruar konkurrencë të lirë dhe pa pengesa për shkak të këtij algoritmi.

Autoriteti po kryen veprimet e duhura për të zbatuar rekomandimin sipas rezolutës.

5. Të paraqesë brenda vitit 2016, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, amendimet ligjore për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, si dhe të vijojë zbatimin e masave stabilizuese në tregun e sigurimeve dhe vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, nivelin e likuiditetit, mjaftueshmërisë së kapitalit, praktikave të provigjonimit dhe sidomos përmirësimin e raportit dëme/prime.

Autoriteti ka përfunduar dhe ka paraqitur në muajin shtator 2016, në Ministrinë e Financave, ndryshimet në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar. Në vitin 2017, do vijohet bashkëpunimi në mënyrë që drafti final i ndryshimeve ligjore të propozuara të miratohet dhe të fillojë efektet e tij.

Gjithashtu, janë miratuar në Bord:

- Rregullore nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Rregullore nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti”;
- Rregullore nr. 87, datë 27.06.2016 “Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit të shoqërive të sigurimit”;
- Rregullore nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”;
- Rregullore nr. 38, datë 31.03.2016 “Për përmbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit”;

- Rregullore nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”.

Gjatë vitit 2017 do të vijojë monitorimi i zbatimit të rregulloreve të mësipërme.

6. Duke konsideruar që investimi në tituj, është një fushë ende e panjohur investimi për individët shqiptarë dhe duke konsideruar që të dhënat e ofruara nga tregu, janë sinjale të qarta të fillimit të funksionimit të tregut të titujve në nivel investitori institucional, të shqyrtohet marrja e masave të posaçme të karakterit informues dhe edukues të publikut.

AMF, në kuadër të një strategjie për edukimin e investitorëve, ka përfshirë në objektivat strategjike të vitit 2017 edukimin dhe informimin e individëve në lidhje me zhvillimet aktuale dhe të ardhshme në tregun e titujve.

7. Fillimi i operimit të platformave të tregtimit online, të dhënat për funksionimin e skemave të tilla edhe të palicencuara nga AMF, si dhe shenjat e dhëna nga tregu për lindjen dhe shtimin e rasteve të emetimit të obligacioneve, të shoqërohen nga AMF, me reagime institucionale, masa ligjore dhe fushata informuese mediatike për publikun në lidhje me riskun që mbartin këto lloj investimesh.


Duke marrë shkas nga zhvillimet e këtij tregu, Autoriteti ka vënë theksin tek ndërgjegjësimi i publikut për rreziqet që mbart investimi në platformat online dhe marrja e shërbimeve financiare nga subjekte të palicencuara. Autoriteti ka vepruar për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut nëpërmjet faqes zyrtare por edhe me shkrime dhe dalje në media.

Në faqen zyrtare të AMF-së është publikuar njoftimi “Investitorë Kujdes”, me qëllim që publiku të sigurohet para çdo investimi se ofrimi i shërbimeve financiare vjen nga shoqëri të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Nëpërmjet deklaratave për shtyp dhe disa komunikimeve të tjera në median e shkruar, AMF ka këshilluar lidhur me risqet që ka investimi në platformat online të investimeve dhe bursat ndërkombëtare. Gjithashtu, ka patur edhe pasqyrime mediatike të shkurtra në edicionet e lajmeve me intervista të drejtuesve dhe ekspertëve të AMF-së.

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (GKSF), në takimet e zhvilluara gjatë vitit 2016, ka trajtuar çështjet për platformat e tregtimit online dhe informimin e investitorëve. Njoftimet për shtyp të takimeve të GKSF-së me informacionin e plotë janë pasqyruar në faqen online të AMF-së.

Në këtë drejtim, Autoriteti ka patur bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Ministrinë e Inovacionit, Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe Policinë e Shtetit. Bashkëpunimi ndërinsitucional për marrjen e masave të nevojshme për çështjet që lidhen me operimin e platformave të tregtimit online nevojitet të vijohet dhe të forcohet më tej gjatë vitit 2017. Angazhimi i AMF-së në këtë proces ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë konstruktiv edhe në të ardhmen nëpërmjet fushatave informuese për investitorët.

8. Inkurajimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët në rolin e investitorit, si dhe me median. Hartimi dhe respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, në mënyrë që të inkurajohet dhe rritet besimi i konsumatorit në rolin e AMF-së, nëpërmjet rritjes së efektshmërisë së funksioneve të AMF-së.



Gjatë vitit 2016, me synim informimin sa më të shpejtë dhe të saktë të publikut, AMF ka përdorur disa forma komunikimi. Bashkëpunimi me median dhe përcjellja e informacioneve, shfrytëzimi i faqes online të AMF-së si portal mjaft i rëndësishëm, duke pasqyruar në të informacione në funksion të mbrojtjes së investitorit dhe konsumatorit, si edhe takimet tematike me grupe të veçanta të synuara në komunikim, kanë qenë disa nga format e përdorura.

Në maj 2016, Bordi i AMF-së miratoi Rregulloren nr. 75 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit”, e cila përcakton procedurat dhe mënyrën e komunikimit të Autoritetit me median dhe publikun, përcakton përmbajtjen dhe klasifikimin e publikimeve, si dhe hartimin dhe funksionimin e faqes zyrtare të internetit të Autoritetit.

Në zbatim të kësaj rregulloreje, dhe në zbatim të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me organizma ndërkombëtarë financiarë, gjatë vitit 2016 AMF realizoi:

- Seanca informuese për tregun e pensioneve private vullnetare në vend, si pjesë e projektit “Shqipëria: Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve”;
- Disa komunikime mediatike për të këshilluar publikun lidhur me risqet që ka investimi në platformat online të investimeve dhe bursat ndërkombëtare;
- Publikime periodike, si në format të shkruar, ashtu edhe nëpërmjet faqes online, për informimin dhe edukimin e konsumatorit.

9. Forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet homologe të rajonit, duke synuar thirrjen dhe organizimin e konferencave dhe forumeve të diskutimit mbi çështje të tregjeve të licencuara dhe mbikëqyrura nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2016 ka vijuar bashkëpunimi rajonal dhe me partnerë ndërkombëtarë, i cili do të forcohet dhe thellohet më tej gjatë vitit 2017.

10. Përbushjen e detyrimeve që kanë lënë dokumentet e hartuara nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe FSAP që i referohen veprimtarisë së Autoritetit.

Përsa i përket rekomandimeve të FMN-së dhe BB-së, Autoriteti do të ketë një qasje të re në marrëdhënie me këto institucione dhe do të jetë i përqendruar tek:

- Ndërmarrja e hapave dhe iniciativave për shtimin e numrit të bankave depozitare në treg;
- Forcimi i bashkëpunimit të mëtejshëm me Bankën e Shqipërisë, kryesisht në kuadër të përgatitjeve për nënshkrimin e protokollit të bashkëpunimit;
- Përpilimi dhe zbatimi i një kuadri të menaxhimit të krizave, etapat dhe hapat që duhet të ndërmerren, përcaktimi i kanaleve të komunikimit, aplikimi i simulimeve në rast krize në bashkëpunim me subjektet nën mbikëqyrje;
- Zbatimi i projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së – fokusi tregu i kapitalit”, financuar nga SECO dhe zbatuar me mbështetjen e Bankës Botërore;
- Përfundimi me sukses i zbatimit të Projektit “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend”;
- Zbatimi i Projektit FIRST të asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të tre tregjet nën mbikëqyrje.

11. Rishikimin e rregullores “Mbi marrëdhëniet e punës” drejt rritjes së kompetencave të Bordit për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve të drejtorive dhe departamenteve sipas rregullores së BSH-së.

Gjatë vitit 2016 nuk janë ndërmarrë veprime nga ana e Autoritetit për rishikimin e Rregullores “Mbi marrëdhëniet e punës” sipas rekomandimeve të Kuvendit.

Me vendimin e Bordit nr. 13, datë 03.02.2017 janë miratuar ndryshimet në Rregulloren nr.129, datë 26.11.2015 “Për Marrëdhëniet e Punës së Punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, sipas rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit.

12. Miratimin në Bord të shoqërisë së auditit të jashtëm financiar dhe rishikimin e strukturës duke krijuar njësinë e auditit të brendshëm të pavarur nga drejtuesi ekzekutiv që raporton në Bord.

Pas zhvillimit të procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 226, datë 27.12.2016, miratoi shoqërinë audituese “Grant Thornton” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2016.

Lidhur me njësinë e Auditit të Brendshëm nuk janë ndërmarrë veprime për përbushjen e rekomandimit të rezolutës. Kjo çështje do të mbahet në vëmendje gjatë veprimtarisë së vitit 2017.


13. Raportet vjetore në vijim, të respektojnë pa u kufizuar në parashikimet e ligjit, për sa i takon çështjeve të detyrueshme për tu përfshirë në Raportim.

Raporti Vjetor 2016 reflekton rekomandimet e lëna në Rezolutën e Kuvendit dhe është përgatitur në përbushje të kërkesave të parashikuara në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

14. Të merren masa urgjente për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në raportin e Auditimit të Performancës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Një pjesë e rekomandimeve të KLSH-së është zbatuar, gjithsesi ndjekja e tyre do të mbahet në vëmendje gjatë punës së Autoritetit në vitin 2017.

Për vitin 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi një kontroll mbi hartimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH, u auditua zbatimi i rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhëmtimit. Në përfundim, KLSH për një kuadër rregullativ më të plotë dhe efektiv, ka lënë 4 rekomandime. Autoriteti ka marrë masat e duhura për zbatimin e tyre, ndërsa rekomandimi lidhur me llogaritjen e provigjoneve teknike të katastrofës, rezulton se Autoriteti në bashkëpunim me ekspertët të Bankës Botërore, në kuadrin e projektit “Shqipëria: reforma e tregut të sigurimeve”, ka hartuar rregulloren “Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e Sigurimit”, rregullore e cila bazohet në praktikën më të mira të BE-së dhe që do adresojë kërkesat ligjore në lidhje me rezervën e katastrofës. Draft-rregullorja u diskutua me palët e interesuara dhe në mbledhjen e Bordit të datës 26.5.2017 kjo rregullore u miratua. Për vitin 2017, do të vazhdojë ndjekja në vijimësi e zbatimit të rekomandimeve të lëna.



- 15. Të hartohen rregulla të qarta për sa i takon hartimit të Buxhetit dhe për mënyrën e parashikimit dhe dokumentimit të shpenzimeve të natyrës së përgjithshme, si dhe të rishikohen tarifat e aplikuar nga Autoriteti në funksion të shpenzimeve të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë mbikëqyrëse, të kontrollit dhe të tjera të lidhura me to.**

Gjatë vitit 2017 në funksion të zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe rolit mbikëqyrës, infrastrukturës së Autoritetit, rritjen e informimit të publikut dhe edukimit financiar, hartimit të një strategjie afatgjatë për tregjet nën mbikëqyrje do të vendosen në balancë të ardhurat dhe shpenzimet në buxhetin e Autoritetit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2016 u përqendrua në këto drejtime kryesore:

- Në plotësimin e kërkesave të paraqitura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në rezolutën mbi vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2016;
- Në zbatimin e Mbikëqyrjes me Fokus Rreziku;
- Në përgatitjen e projektligjeve, akteve nënligjore dhe amendimeve për të treja tregjet nën mbikëqyrje;
- Në zbatimin e axhendës së projekteve të asistencës teknike të Bankës Botërore në fushën e pensioneve të sigurimeve dhe fondeve të investimit;
- Në plotësimin e rekomandimeve të FSAP, të cilat shtrihen për të gjitha tregjet që mbikëqyr e rregullon AMF dhe i përkasin një periudhe afatmesme.


Në vijim paraqitet një përmbledhje e zhvillimeve kryesore të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Rritja e Tregjeve

Gjatë vitit 2016, tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së kanë vijuar prirjen e tyre për zgjerim. Më 31.12.2016 totali i aktiveve në këto tregje arriti në rreth 98.58 miliardë lekë, me një rritje prej 3% kundrejt vitit 2015. Për rrjedhojë, edhe kontributi i këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar është rritur ndjeshëm. Tregu më i madh për t'u mbikëqyrur nga pikëpamja e aktiveve mbetet tregu i fondeve të investimeve. Pesha e këtij tregu për vitin 2016 në tregjet financiare që mbikëqyr AMF, arriti në rreth 66.6%, ndërsa pesha e tregut të sigurimeve dhe tregut të pensioneve ishin përkatësisht 32.1% dhe 1.3%. Raporti i aseteve ndaj PBB-së për vitin 2016 ishte 4.4% për tregun e fondeve të investimit, 2.1% për tregun e sigurimeve dhe 0.1% për tregun e pensioneve. Totali i aseteve të tregjeve nën mbikëqyrje në raport me PBB-në ishte 6.7% në vitin 2016.

Përsa i përket zhvillimit të tre tregjeve në veçanti, duhet theksuar që gjatë vitit 2016, tregu i fondeve të investimit numëroi 3 fonde të hapura investimesh me ofertë publike të administruara nga dy shoqëri administruese. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH. Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve më 31.12.2016 arritën në 65.43 miliardë lekë, me një rënie prej 1.6 miliardë lekë ose 2.33%, krahasuar me 31.12.2015. Forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore në lidhje me administrimin e risqeve me të cilat përballen këto fonde dhe shoqëritë që i administrojnë kanë qenë prioritet të punës së mbikëqyrësit gjatë vitit 2016.

Primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve në tërësi kanë shënuar vlerën rreth 15.4 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 9.1%, ose rreth 1.3 miliardë lekë në 31.12.2016, në krahasim me një vit më parë. Në ecurinë e primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve ndikimin kryesor e kanë dhënë shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, duke qenë se kanë një pjesëmarrje dominuese, rreth 93.6% kundrejt pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit të jetës, rreth 6.4%. Ndërkohë që primet e shkruara bruto për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë në 31.12.2016 kanë vijuar rritjen me 10.2% ose rreth 1.3 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë, duke arritur vlerën rreth 14.4 miliardë lekë, primet e shkruara bruto për tregun e sigurimeve të jetës janë tkurrur me 4.8%, ose rreth 49.6 milionë lekë, duke shënuar vlerën rreth 978 milionë lekë.



Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që me fillimin e aktivitetit të tij, ka patur tendencë në rritje, përsa i përket aseteve që menaxhon, si dhe numrit të kontribuesve. Megjithatë, vlera neto e aseteve të këtij tregu është ende në masë të papërfillshme kundrejt PPB-së në Shqipëri. Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2016 është 1,318.74 milionë lekë me një numër prej 17,317 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2016 kanë pësuar një rritje me 41.99%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 37.89% krahasuar me fundin e vitit 2015.

Licenca të Reja dhe Dinamika e Zhvillimit të tyre

Në fund të vitit 2016, Autoriteti numëron 560 licenca për ushtrim veprimtarie në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Nga numri total i licencave, 73 janë licenca për shoqëri ku përfshihen edhe bankat; 6 licenca janë për fonde pensioni dhe investimi dhe 481 licenca janë për individë, profesionistë të fushave nën mbikëqyrje të Autoritetit.

Zhvillimi më i rëndësishëm në veprimtarinë e licencimit ishte dhënia e licencës në maj 2016 për shoqërinë “Credins Invest” për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Kështu, licencimi i shoqërisë së dytë për administrimin e fondeve të investimit, i përqendruar para vitit 2016 vetëm tek një shoqëri administruese, krijoi premisat për rritjen e aktivitetit konkurrues në tregun e fondeve të investimit. Në tregun e sigurimeve, risia e vitit 2016 lidhet me përfshirjen e bankave në tregun e brokerimit. Kështu, gjatë vitit 2016, Autoriteti miratoi licencimin për herë të parë të tre bankave të nivelit të dytë për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës. Ndërkohë, në veprimtarinë licencuese, Autoriteti vijoi me miratimin e licencave për shoqëri brokerimi në sigurime, brokera si individë, agjentë në sigurime të Jo-Jetës, vlerësues të dëmeve në sigurime, si dhe përfshirjen e disa subjekteve me aktivitet financiar dhe tregtar në aktivitetin e agjentit në sigurime. Në tregun e titujve, Autoriteti licencoi subjekte të reja si dhe miratoi licenca shtesë për subjektet ekzistuese. Kështu, një bankë e re u shtua numrit të shoqërive komisionere dhe bankave kujdestare për të vepruar në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, u rrit numri i shoqërive dhe individëve që ushtrojnë veprimtari këshillimi në tituj.

Kuadri Ligjor dhe Rregullator

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti vijoi punën për hartimin dhe miratimin e akteve në zbatim të këtij ligji. Gjatë 2016, u hartuan dhe u miratuan 12 rregullore të reja dhe Kodi i Etikës së Aktuarëve. Me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes sa më efektive të aktivitetit të tregut të sigurimeve dhe operatorëve të këtij tregu, AMF realizoi ndryshime gjatë vitit 2016 ku u bënë disa shtesa e ndryshime në 6 rregullore të tregut të sigurimeve.

Në përputhje me rekomandimet e Bankës Botërore dhe në funksion të zgjidhjes së problematikës së krijuar ndër vite për Fondin e Kompensimit, përshtatjes me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të sigurimeve, si edhe zbatimit të sistemit Bonus-Malus, në shtator 2016 janë dërguar në Ministrinë e Financave ndryshimet në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

Duke pasur parasysh dinamikën e shpejtë të zhvillimit të tregut të fondeve të investimeve dhe nevojën për të përforcuar mbrojtjen e interesave të investitorit, duke mbajtur në konsideratë edhe karakteristikat e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, si edhe nevojat e objektivat e investitorëve të tanishëm dhe potencialë të këtyre fondeve u miratua Ligji nr. 36, datë 31.03.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009

“Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, lidhur me administrimin e riskut dhe procesin e pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave. Duke u bazuar në Ligjin 36/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” AMF, gjatë vitit 2016, finalizoi edhe 3 rregullore të rëndësishme, si dhe u rishikuan 2 rregullore të tregut të letrave me vlerë.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, për ta përshtatur atë me zhvillimet e fundit në fushën e pensioneve vullnetare, me direktivat e BE-së, si dhe në zbatim të rekomandimeve të progres raporteve të BE-së, AMF finalizoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Aktet e Autoritetit në tregun e Pensioneve Private Vullnetare konsistuan në miratimin e Manualit të Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit dhe amendimin e një rregulloreje.


Zbatimi i Projekteve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2016, ka punuar në zbatim të projekteve për secilin nga tre tregjet nën mbikëqyrje. Falë bashkëpunimit të frytshëm e të vazhdueshëm me institucione si Banka Botërore, Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC) janë mundësuar dhe është punuar për projektet e mëposhtme:

- Projekti FIRST i asistencës teknike “Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve”, ku gjatë vitit 2016 është punuar për zbatimin me sukses të projektit nëpërmjet realizimit dhe finalizimit të manualeve dhe rregulloreve përkatëse të parashikuara në projekt;
- Projekti i asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, zbatimi i të cilit ka filluar në korrik të vitit 2016. Gjatë vitit 2016 përfundoi faza e parë e projektit, i cili synonte zhvillimin e kapaciteteve të AMF-së për të mbikëqyrur dhe rregulluar sektorin e tregut të fondeve të investimeve, si dhe vlerësimi i nevojës për mbikëqyrje të AMF-së përballë zhvillimit të shpejtë të këtij sektori;
- Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve “Shqipëria: Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve”, zbatimi i të cilit përfundoi me sukses gjatë gjysmës së parë të vitit 2016;
- Projekti i asistencës teknike në fushën e menaxhimit të krizave në sektorin e fondeve të investimeve, financuar nga USAID dhe zbatuar nga Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC), ku gjatë muajit nëntor 2016, u hartua kuadri i menaxhimit të skenarëve të krizave për fondet e investimit.

Mbikëqyrja me Fokus Rrezikun

Në funksion të rolit të vet mbikëqyrës dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit të ri nr. 52/2014 për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, AMF vijoi me aplikimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun. Gjatë vitit 2016, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka kryer inspektime të plota në vend në tre shoqëri sigurimi Jo-Jetë sipas metodologjisë me fokus rrezikun. Bazuar në këtë metodologji, inspektimet u fokusuan në identifikimin dhe analizimin e rreziqeve që karakterizojnë aktivitetet e biznesit të shoqërive të sigurimit, si dhe aftësinë e administrimit dhe zbutjes së tyre nga menaxhimi dhe drejtuesit e lartë të shoqërive. Për vitin 2017, është planifikuar që procesi i mbikëqyrjes sipas metodologjisë me fokus rrezikun të zbatohet edhe për tre shoqëritë e sigurimeve Jo-Jetë, të cilat nuk janë inspektuar, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e profilit të rrezikut të secilës shoqëri sigurimi, si dhe të nivelit të rrezikut të tregut të sigurimeve në tërësi.



Përsa i përket tregut të fondeve të pensionit në kuadrin e metodologjisë së re mbikëqyrëse me bazë rreziku, gjatë vitit 2016, AMF me asistencën teknike të konsulentëve të Bankës Botërore, kreu inspektim pilot pranë një prej shoqërive që administron një fond pensioni. Për vitin 2017, është planifikuar që procesi i mbikëqyrjes sipas metodologjisë me bazë rrezikun të vijojë të zbatohet edhe për subjekte të tjera nën mbikëqyrje që lidhen me veprimtarinë e fondeve të pensioneve duke u bazuar në vlerësimin e bërë sipas matricës së rrezikut dhe vendimeve të komitetit të rrezikut.

Gjithashtu, bazuar në manualin me fokus rrezikun për Parandalimin e Pastrimit të Parave, AMF gjatë vitit 2016 ka kryer 2 inspektime në bashkepunim me DPPP-në (Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave). Për vitin 2017 është planifikuar që procesi i mbikëqyrjes sipas këtij manuali të vijojë edhe në shoqëritë nën mbikëqyrje, të cilat do të jenë subjekt i inspektimeve të plota.

Zbatimi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun, jo vetëm në tregun e sigurimeve dhe fondeve të pensioneve vullnetare, por edhe shtrirja e kësaj metodologjie në tregun e Jo-Jetës, por edhe në tregun e sigurimeve të Jetës, Risigurimeve dhe fondeve të investimeve përbën një nga objektivat që AMF synon të arrijë në vijim me mbështetjen e Projektit "FIRST Shqipëria: Reforma e tregut të sigurimeve" dhe Projektit "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve".

Vendimmarrja e Bordit për Masat Korrektuese dhe Masat Administrative

Në përmbushje të funksioneve të tij, gjatë vitit 2016, Bordi i AMF-së, ka zhvilluar 17 mbledhje dhe ka marrë 228 vendime. Numrin më të madh të vendimeve (me 160 vendime) e zënë vendimet e lidhura me tregun e sigurimeve. Më kryesoret ndër to janë vendimet e marra mbi masat administrative dhe korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me përcaktimet ligjore, vendimet që përcaktojnë vlerën e Fondit të Kompensimit, miratimin apo ndryshimin e statuteve apo prospekteve të shoqërive, kryesisht për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë, por dhe të emetimit të dëftesave tregtare, miratimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo bordit drejtues të shoqërive, si dhe miratimin e ndërmjetësve në sigurime.

Rritja e Kapaciteteve Administrative

AMF, për vitin 2016, vijoi funksionimin në bazë të strukturës së miratuar nga Bordi i Autoritetit, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 27, datë 28.04.2015. "Mbi strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimeve të punës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar.


Numri i punonjësve, në përputhje me strukturën e miratuar, është rritur gradualisht. Në fund të vitit 2016, numri i punonjësve në AMF, ishte 70 vetë. Shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar, për vitin 2016, ka arritur në 89.7%. Plotësimi i vendeve të lira të punës, kryesisht në plotësimin e funksioneve mbikëqyrëse në Autoritet ka ndihmuar në përballimin më cilësor të vëllimit gjithnjë në rritje të aktivitetit të AMF-së në përmbushje të objektivave.

Integrimi Evropian dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Në Progres Raportin për Shqipërinë publikuar nga Komisioni Evropian më datë 9 nëntor 2016 janë dhënë vlerësimet e Komisionit Evropian për përparimet e bëra në fushën financiare jobankare. Në fushën e sigurimeve dhe pensione, Raporti vlerëson progresin e arritur kryesisht në kuadrin legjislativ. Raporti gjithashtu vlerëson punën e AMF-së edhe në fushën e tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit, ku vë në dukje se: “Janë miratuar ndryshimet në ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Edhe gjatë vitit 2016, AMF ka vijuar të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, autoritetet homologe dhe donatorët. Edhe gjatë vitit 2016, bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit ka qenë mjaft i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së rolit të AMF-së për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jobankare. Ndër marrëveshjet e nënshkruara gjatë vitit 2016 mund të përmendet marrëveshja me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë, FMA, Për Koordinimin e Kolegjeve Mbikëqyrëse VIG, e cila ka për qëllim të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij Grupi, shkëmbimin e informacionit dhe sekreteve profesionale midis tyre, bashkëpunim se më efikas mes anëtarëve të Grupit dhe eprorit, si dhe një konsultim për procesin e vendimmarrjes mes anëtarëve të Grupit. Gjatë vitit 2016 në kuadër të Kolegjit të Mbikëqyrësve të Grupit UNIOA u lidh edhe Marrëveshja e Konfidencialitetit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut Financiar Zviceran, FINMA.

Një bashkëpunim të ngushtë AMF ka dhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Sllovene. Në këtë kuadër, në mars 2016 këto dy institucione firmosën Marrëveshjen e Mirëkuptimit për Bashkëpunimin Reciprok dhe Shkëmbim të Informacionit për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni) firmosën këtë Memorandum Mirëkuptimi duke marrë në konsideratë rritjen e treguesve të zhvillimit ndërkombëtar në tregun e sigurimeve dhe nevojën për bashkëpunim reciprok.



1. TREGU I FONDEVE TË INVESTIMIT NË SHOIPËRI

1.1 Struktura e Tregut

Viti 2016 shënoi rritjen e numrit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe njëkohësisht numrin e fondeve të investimit që shërbejnë si një alternativë investimi për shumë investitorë shqiptarë.

Në mbledhjen e datës 30.05.2016, Bordi i AMF-së miratoi dhënien e licencës për shoqërinë “Credins Invest” sh.a. për të kryer veprimtari administrimi të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Shoqëria “Credins Invest” sh.a. përfaqëson zgjerimin e shoqërisë administruese të fondit të Pensionit SiCRED, e licencuar më 23.11.2011 për të kryer veprimtari dhe mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit vullnetar dhe pagesat për pension. Kështu, administrimi i fondeve të investimit, i përqendruar para vitit 2016, vetëm tek një shoqëri administruese, me licencimin e shoqërisë së dytë u bë një aktivitet më konkurrues për tregun e fondeve të investimit.

Gjatë vitit 2016, tregu i fondeve të investimit numëroi 3 fonde me objekt investimi në tituj me të ardhura fikse, kryesisht bono dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare.

1.2 Pozicioni Financiar dhe Mbikëqyrja e Tregut

Tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga viti 2012 dhe ky treg tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Gjatë këtyre viteve, asetet neto të tregut të fondeve të investimeve arritën në 65.43 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2015 asetet neto të fondeve të investimit gjatë vitit 2016 pësuan një rënie prej 1.6 miliardë lekë ose 2.33%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 29,267, nga të cilët 99.99% janë investitorë individualë.

Investimet e tregut të fondeve të investimit konsistojnë në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., Bono thesari të Qeverisë së R.SH., Obligacione të shoqërive jashtë vendit, si dhe kuota në fonde investimi. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., të cilat përbëjnë 64.37% të aseteve të këtij tregu.

Tabela 2: Vlera e kuotave të fondeve të investimeve

(Në lekë)

Përshkrimi	Vlera fillestare e vlerës neto të aseteve për kuotë	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.'15	Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.'16
Raiffeisen Prestigj	1,000 ¹	1,290	1,381
Raiffeisen Invest EURO ²	14,000 ³	15,042	15,395
Credins Premium	1,037 ⁴	N/A	1,059

Shënim:

¹ Vlera fillestare në 01.03.2012

² Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin në periudhën përkatëse

³ Vlera fillestare në 22.11.2012.

⁴ Vlera fillestare në 01.08.2016.

Tabela 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore të vitit 2016 (Në mln. lekë)

Përshkrimi	Vlera			
	31.03.'16	30.06.'16	30.09.'16	31.12.'16
Periudha	31.03.'16	30.06.'16	30.09.'16	31.12.'16
Asetet neto të fondeve	69,491	71,760	69,759	65,429
Totali i aseteve të fondeve	69,723	72,023	70,106	65,613
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	43,873	45,968	45,442	42,234
Obligacione të Shoqërive	2,303	3,025	3,052	2,830
Bono Thesari	15,787	14,389	11,624	9,404
Investime të tjera	707	1,676	2,371	2,173
Mjete Monetare	6,261	6,155	6,705	8,295
Asete të tjera	791	811	911	677
Totali i Detyrimeve të Fondeve	232	263	347	184

Tabela 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve, 31.12.'15-31.12.'16

Përshkrimi	Vlera (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj totalit (në %)	
	31.12.'15	31.12.'16		31.12.'15 -31.12.'16	31.12.'15
Periudha	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'15 -31.12.'16	31.12.'15	31.12.'16
Asetet neto të fondit	66,989	65,429	(2.33)		
Totali i aseteve të fondeve	67,151	65,613	(2.29)	100	100
<i>nga të cilët:</i>		-	-		
Obligacione Qeveritare	47,155	42,234	(10.44)	70.22	64.37
Obligacione të Shoqërive	1,586	2,830	78.44	2.36	4.31
Bono Thesari	11,696	9,404	(19.60)	17.42	14.33
Investime të tjera	682	2,173	218.62	1.02	3.31
Mjete Monetare	5,133	8,295	61.60	7.64	12.64
Asete të tjera	898	677	(24.61)	1.34	1.03
Totali i Detyrimeve të Fondeve	161	184	14.29	0.24	0.28



Figura 1: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.'15 (Në %)






Figura 2: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.'16 (Në %)



Rritja e konsiderueshme në asetet e fondeve të investimit dhe pesha që ato zënë në tregjet e mbikëqyrura nga AMF, kanë rritur sfidat me të cilat kjo e fundit duhet të përballet për një mbikëqyrje efektive të këtij tregu në Shqipëri.

Në këto kushte, forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore në lidhje me administrimin e rreziqeve me të cilat përballen këto fonde dhe shoqëritë që i administrojnë kanë qenë prioritete të punës së mbikëqyrësit gjatë vitit 2016. Në korrik 2016, AMF miratoi Rregulloren nr. 110, datë 19.07.2016 “Për administrimin e rrezikut të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”. Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të rrezikut që krijon shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, i cili përfshin të gjitha procedurat që lidhen me administrimin e rreziqeve kryesore si rreziku i kreditit, rreziku i tregut, rreziku operacional dhe rreziku i likuiditetit, si dhe rreziqeve të tjera që ajo ndesh gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Shoqëritë të paktën një herë në vit, brenda muajit janar duhet të shqyrtojnë dhe të depozitojnë në AMF strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut. Në vijim, AMF pas shqyrtimit të strategjisë dhe politikave të administrimit të rrezikut depozituar nga shoqëritë, do të vlerësojë përshtatshmërinë e tyre si dhe do të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin e tyre nga ana e shoqërive administruese.

Në shtator 2016 u miratua Rregullorja nr. 154, datë 29.09.2016 “Mbi pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve”. Nëpërmjet kësaj rregulloreje u përcaktuan më qartë arsyet që mund të jenë shkak i pezullimit të tregtimit të kuotave, lloji dhe forma e informacionit që do t’i përcillet investitorit aktual ose atij potencial gjatë pezullimit, si dhe bashkërendimi i veprimeve dhe komunikimit midis shoqërisë administruese, depozitarit dhe AMF-së.

Ndjekja dhe zbatimi i rregullave që lidhen me njohjen, vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve në tregun e fondeve të investimit ka vijuar të jetë prioritet gjatë mbikëqyrjes së këtij tregu.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së: Fokusi te zhvillimi i tregut të kapitaleve”

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së: Fokusi te zhvillimi i tregut të kapitaleve” është financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) përmes Grantit (Trust Fund Grant). Ky projekt mbështetet nga Banka Botërore, e cila do të ndjekë edhe zbatimin e tij. Fushat që do të mbulojë ky projekt janë kryesisht:

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të fondeve të investimit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për tu përgatitur për emetimin e obligacioneve të shoqërive dhe qeverive lokale.

Gjatë vitit 2016 nisi zbatimin i fazës së parë të këtij projekti, e cila u fokusua në këto drejtime:

- Shqyrtimi i kapaciteteve institucionale të AMF-së sa i përket strukturës organizative, stafit dhe nevojave të trajnimit lidhur me fushën e mbikëqyrjes së fondeve të investimit;
- Ndërtimi i një strategjie zhvillimi afat mesme në lidhje me kapacitetet administrative mbikëqyrëse të AMF-së dhe një axhende të detajuar për zbatimin e saj;
- Shqyrtimi i tregut të fondeve të investimeve në Shqipëri.

Në përfundim të fazës së parë të këtij projekti, raportet e përgatitura nga konsulentët në lidhje me drejtimet e mësipërme janë prezantuar në AMF.

Inspektime të përbashkëta për mbikëqyrje të konsoliduar të tregjeve financiare

Gjatë vitit 2016, AMF në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, ka kryer një inspektim të përbashkët pranë një prej shoqërive administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Objektivi i këtij inspektimi ishte vlerësimi i elementëve të transparencës dhe mënyra e dhënies së informacionit nga punonjësit e degëve të bankës (agjentët e shitjes së fondeve të investimeve) për klientët e fondeve të investimeve. Duke qenë se një pjesë e punonjësve të degëve të bankës mëmë njihen nga AMF si agjentë të shitjes së fondeve të investimeve, roli i AMF-së konsistoi në vlerësimin e elementëve të veçantë të transparencës në përputhje me kërkesat e bazës ligjore në fuqi.

Ky inspektim u zhvillua pranë agjencive/degëve të Bankës mëmë, në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Nga inspektimi, i cili konsistoi në intervistimin e personave të autorizuar dhe plotësimin e një pyetësori mbi mënyrën e shitjes dhe shlyerjes së kuotave të fondeve të investimit, rezultuan disa gjetje për të cilat u njoftua shoqëria administruese bashkë me rekomandimet përkatëse. Verifikimi i realizimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të mbikëqyrjes nga ana e Autoritetit.

Inspektime të përbashkëta me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) dhe në zbatim të hapësirave ligjore që AMF ka në bazë të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, dhe në bazë të Ligjit nr. 10197, datë 1.12.2009, “Për fondet e pensionit”, gjatë vitit 2016 u krye inspektimi pranë një shoqërie administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Fokusi i këtij inspektimi ishte respektimi nga shoqëria administruese i kuartrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

Në përfundim të inspektimit nuk u verifikuan shkelje administrative në kuadër të ligjeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe masave kundër financimit të terrorizmit.



1.3 Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, struktura e organizimit dhe drejtimit të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive paraqitet në skemën më poshtë.

Figura 3: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të administrimit të fondeve të pensioneve dhe investimeve




Tabela 5: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Emërtimi	Numri
Shoqëri administruese	3
Aksionarë gjithsej	6
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>	
Nën 10%	1
Mbi 10% nën 20%	1
Mbi 33% nën 50%	1
Mbi 50%	3
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës</i>	
Aksionarë të huaj	0
Aksionarë vendas	6
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>	
Aksionarë individë	1
Aksionarë shoqëri	5

Figura 4: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese

(Në %)




Figura 5: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës

(Në %)



Figura 6: Të dhëna për aksionarët sipas statusit

(Në %)





Tabela 6: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutoare

(Në numër shoqëri)

Arsyeja e ndryshimit të statutit	2012	2013	2014	2015	2016
Statut i ri e ndryshime të tjera	-	-	1	2	1
Rritje kapitali	1	1	1	-	1
Ndryshim i strukturës aksionare	-	1	1	-	1



1.4 Kuadri Ligjor dhe rregullator

Ligji nr. 36, datë 31.03.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive””

Kriza e fundit financiare botërore nxori në pah nevojën për përmirësimin e proceseve dhe strukturave të administrimit të rrezikut. Administratorët dhe strukturat drejtuese të SIK⁵ duhet të jenë në gjendje të kuptojnë plotësisht ekspozimet e tyre ndaj rrezikut, të kryejnë monitorimin e tyre në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të identifikojnë të gjitha rreziqet në kohën e duhur dhe të ndërtojnë një kuadër efikas gjithëpërfshirës dhe me standarde të larta të administrimit të rrezikut. Meqenëse në mjedisin e sotëm të biznesit firmat e investimeve janë gjithnjë e më komplekse dhe me një dinamikë të lartë zhvillimi, është i nevojshëm zbatimi i parimeve të shëndosha të rrezikut dhe mekanizmave të qëndrueshme të mbikëqyrjes.

Duke pasur parasysh dinamikën e shpejtë të zhvillimit të tregut të fondeve të investimeve dhe nevojën për të përforcuar mbrojtjen e interesave të investitorit, duke mbajtur në konsideratë edhe karakteristikat e tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, si edhe nevojat e objektivat e investitorëve të tanishëm dhe potencialë të këtyre fondeve, u gjykua i domosdoshëm propozimi i amendimeve në ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive⁶ lidhur me:

- Forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) në vend, duke vënë theksin në forcimin e administrimit të risqeve të tregut të fondeve të investimit dhe operatorëve të këtij tregu, me synim kontrollin dhe zbutjen e risqeve kundrejt të cilave ekspozohen këto fonde, si dhe;
- Përforcimin e mbrojtjes së interesave të investitorëve nëpërmjet saktësisht dhe përmirësimit të regjimit të pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave.

Akte nënligjore të reja

Gjatë vitit 2016, AMF duke u bazuar në Ligjin 36/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” punoi për finalizimin e 3 rregulloreve të rëndësishme, bazuar në eksperiencat e vendeve të zhvilluara, si dhe duke bërë një përafrim me direktivat e BE-së, e më konkretisht:

- Rregullorja nr. 110, datë 19.07.2016 “Për administrimin e riskut të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”. Synimi i kësaj rregulloreje është forcimi i mëtejshëm i tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në vend, nëpërmjet krijimit, organizimit dhe funksionimit të sistemit të administrimit të risqeve me të cilat përballen shoqëritë administruese, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të kuptojnë plotësisht ekspozimet e tyre ndaj riskut, të kryejnë monitorimin e tyre në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të identifikojnë të gjitha risqet në kohën e duhur dhe të ndërtojnë një sistem efikas gjithëpërfshirës dhe me standarde të larta të administrimit të riskut përafruar pjesërisht me Direktivën e Komisionit 2010/43/KE e datës 1 korrik 2010 mbi zbatimin e Direktivës 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me kërkesat organizative, konfliktet e interesit, zhvillimin e biznesit, administrimin e riskut dhe përmbajtjen e marrëveshjes ndërmjet një depozitari dhe një shoqërie administruese;
- Rregullorja nr. 154, datë 29.09.2016 “Mbi pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve”, qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe procedurave për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në

Shënim: ⁵ SIK - këtu e në vijim SIK është shkurtim i “Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”

⁶ Ligji nr.10 198, date 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

fondet e investimeve - përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS);

- Rregullorja nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e shoqërisë audituese, dokumentacionin e kërkuar, procedurën për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar, si edhe rastet e refuzimit të shoqërisë audituese. Në kuadrin e ndryshimit të metodologjisë së mbikëqyrjes drejt asaj me bazë rreziku, auditimi dhe certifikimi i pasqyrave financiare nga shoqëritë e auditit të jashtëm për shoqëritë administruese dhe fondet që ato administrojnë, paraqesin një rëndësi të veçantë, pasi janë një burim i rëndësishëm informacioni për AMF-në.

Amendime

Krahas akteve të reja si më sipër, gjatë 2016 u rishikuan 2 rregullore të tregut të letrave me vlerë, si:


- Rregullorja nr. 96, datë 25.06.2014 “Për formën, llogaritjen dhe shumën e kapitalit që duhet të ketë detyrimisht shoqëria administruese e SIK”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 121, datë 24.08.2016, ndryshim i cili lidhet me formën e kapitalit që duhet të mbajë shoqëria administruese duke bërë përqasje me direktivën 2011/61/EU “Për administratorët e Fondeve të Investimit alternative”, si dhe;
- Rregullorja nr. 120, datë 02.10.2008 “Për licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 173, datë 31.10.2016. Ky ndryshim u realizua në përputhje me direktivën e MiFID 2014/65/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, e cila nuk ka përcaktuar kufizime në lidhje me natyrën dhe origjinën e personit që mund të jetë aksionar i bursës, por ka parashikuar vetëm kërkesa përshtatshmërie për aksionarin influencues.

1.5 Transparenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit

- Mbrojtja e investitorëve
- Sigurimi që tregjet janë të drejta, efikase dhe transparente
- Reduktimi i rrezikut sistematik

Qëllimi kryesor i Autoritetit në funksion të mbrojtjes së investitorëve është identifikimi nga investitori i fushave kryesore si:

- Procesi i ofertës fillestare publike;
- Vlerësimi i shoqërive me teknologji të lartë duke përfshirë kontabilitetin dhe raportimin financiar;



- Efektet e strategjive të tregtimit afatshkurtër në lidhje me reziqet e investitorëve dhe pritshmëritë e tyre;
- Ruajtja e konfidencialitetit të investitorit.

Mjetet e Autoritetit në arritjen e këtij qëllimi në funksion të mbrojtjes së investitorëve janë:

- Licencimi;
- Mbikëqyrja e vazhdueshme;
- Ndjekja e ofruesve që veprojnë në mënyrë të paligjshme;
- Sigurimi sa më shumë i transparencës në tregjet financiare.

Autoriteti ka ndjekur në vazhdimësi zbatimin nga Fondet e Investimit të kërkesave ligjore lidhur me dhënien e informacionit kryesor për investitorin përpara nënshkrimit të kuotave/aksioneve të SIK. Gjithashtu, Autoriteti monitoron përputhshmërinë me kushtet dhe politikën e investimit të fondeve të investimit, kërkesat e raportimit, sjelljen në treg dhe zbatimin e akteve ligjore.

Gjatë këtij viti është trajtuar nga Autoriteti dhe kërkesa për pajisjen me prospektet e përditësuara me ndryshimet më të fundit të miratuara nga Autoriteti të të gjithë degëve dhe agjencive, në të cilat shiten kuotat e fondeve të investimeve.

Gjatë vitit 2016, me qëllim mbrojtjen dhe informimin e investitorëve, Autoriteti publikoi në faqen e tij *online* një rubrikë me emërtimin “Investitorë Kujdes”. Informacionet e dhëna në të synojnë të tërheqin vëmendjen e të ndërgjegjësojnë publikun se ofrimi i shërbimeve financiare vjen vetëm nëpërmjet shoqërive të licencuara nga AMF. Nëpërmjet nënndarjeve dhe rubrikave të veçanta në faqen *online* të AMF-së jepen operatorët e licencuar nga AMF në tregun e titujve.

Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun: Tregu i Fondeve të Investimit dhe Titujve

Një tematikë e ndjeshme, e pasqyruar në media gjatë vitit 2016, lidhej me investimet në fondet e investimeve dhe tregtimin e letrave me vlerë. Pasqyrimi i tyre lidhet edhe me rritjen e transparencës dhe informacionit për konsumatorin dhe mundësinë për të investuar në këto tregje. AMF licencoi gjatë vitit 2016 edhe një tjetër fond investimi, duke arritur kështu në tre numri i fondeve të investimit ku mund të investohet në Shqipëri.

Duke vlerësuar rrezikun e konsiderueshëm që mbart investimi në platformat e tregtimit *online*, sidomos nëpërmjet subjekteve të pamiratuara, AMF gjatë vitit 2016 është prononcuar në televizionet me shtrirje kombëtare, si edhe në televizionet apo portalet e dedikuara informacioneve ekonomike. Ndër prezantimet më të plota kanë qenë intervistat e gjata të Kryetarit të Bordit në 18 nëntor 2016 në emisionin “Ekonomia që duam” në Televizionin Publik Shqiptar. Gjatë programit televiziv u shpjegua ecuria e të tre tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe më konkretisht iu kushtua vëmendje investimeve në platformat e tregtimit *online*. Programe të gjata televizive ka pasur edhe në televizionin Ora News, ku në 22 nëntor 2016 në emisionin “Ekopolitikë” është diskutuar lidhur me funksionimin e platformave të investimit *online*, risqet që lidhen me to si edhe për mundësinë e hapjes së Bursës Shqiptare.

Po kështu, nëpërmjet faqes së saj *online*, por edhe gazetave të përditshme me qarkullim të lartë në vend, AMF këshilloi investitorët të jenë të kujdesshëm dhe të konsultojnë faqen *online* të AMF-së për të parë cilat janë subjektet e licencuara, për të promovuar investimet financiare *online* në bursat ndërkombëtare. AMF nëpërmjet komunikimit me publikun synon të rritë ndërgjegjësimin për reziqet e investimit dhe ndërmarrjen e vendimeve financiare

vetëm në rastet kur ekziston kultura e nevojshme financiare. Ky mesazh është përçar tek publiku edhe nëpërmjet deklaratave për shtyp të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, ku përgjatë vitit 2016 është diskutuar disa herë çështja e investimit në platformat e tregtimit *online*.

AMF organizoi në nëntor 2016 edhe disa komunikime të tjera mediatike në gazetat e shkruara me tirazh më të lartë për të këshilluar lidhur me mundësitë dhe rreziqet që ka investimi në platformat *online* të investimeve dhe bursat ndërkombëtare. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bëri thirrje për kujdes, pasi jo të gjitha këto platforma *online* të investimeve janë të licencuara dhe të kontrolluara. AMF theksoi se këto investime janë me rrezik të konsiderueshëm, ndaj publiku i interesuar duhet të tregohet i kujdesshëm dhe t'i realizojë ato nëpërmjet subjekteve të licencuara, mbi bazën e një informacioni të plotë dhe vetëm në rastet kur ekziston kultura e nevojshme financiare që lejon njohjen dhe ndërgjegjësimin rreth rreziqeve që shoqërojnë këto veprimtari. Ky informacion u shfaq edhe në portalet *online* të disa mediave të tjera duke ndihmuar në këtë mënyrë në zhvillimin e kulturës financiare dhe të tregut financiar.

Në faqen *online* të AMF-së janë prezantuar edhe informacione lidhur me ecurinë e projektit për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së me fokus tek zhvillimi i tregut të kapitaleve.



2. NDËRMJETËS TË TJERË FINANCIARË

2.1 Licencimi

Gjatë vitit 2016, Autoriteti licencoi subjekte të reja, si dhe miratoi licenca shtesë për subjektet ekzistuese. Kështu, një bankë e re iu shtua numrit të shoqërive komisionere për të vepruar në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Njëkohësisht, kjo bankë u licencua për të vepruar si kujdestar i titujve të Qeverisë. Numri i shoqërive komisionere në fund të vitit 2016 arriti në 15, ndërsa numri i kujdestarëve në 9.

Një nga shoqëritë komisionere e licencuar më parë për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në tituj shprehu interesin për ushtrimin e veprimtarisë së këshilltarit të investimeve në tituj. Pas licencimit të kësaj shoqërie, numri i shoqërive që ushtrojnë veprimtari këshillimi në tituj arriti në dy. Ndërkohë, gjatë vitit 2016 u rrit numri i brokerave fizikë dhe këshilltarëve të investimeve.

Pjesa më aktive e tregut të letrave me vlerë është tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë shqiptare. Në këtë treg operojnë kryesisht bankat, të licencuara nga AMF, për të kryer këtë veprimtari.

Tabela 7: Subjekte të tjera që veprojnë në tregun e titujve 2010-2016

(Në numër)

Subjekte	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shoqëri komisionere	12	13	13	13	13	14	15
Broker fizik në shoqëri komisionere	16	17	18	18	18	19	21
Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh.	7	8	8	8	8	8	9
Regjistruar aksionesh	1	1	1	1	1	1	1
Shoqëri këshillimi për investime në tituj	0	0	0	1	1	1	2
Këshilltar për investime në tituj	0	0	0	1	1	1	3
Agjent i lidhur	0	1	1	1	1	2	2

Të dhëna për tregun me pakicë të titujve të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2016 u dominua në masën 82% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 18% nga instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 93.76% e të gjitha transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Transaksionet “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dominojnë tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për vitin 2016. Ato arritën përkatësisht në masën 56.34% dhe 28.41% kundrejt volumit të përgjithshëm të transaksioneve. Investitorët individualë dominojnë në këtë treg duke kryer rreth 99.52% të të gjitha transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Tabela 8: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
	2015	2016	'16/'15-1
A Blerje në tregun primar	49,724	38,732	(22.11)
Individë	25,647	27,861	8.63
Persona juridikë	24,077	10,872	(54.85)
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	7,752	6,511	(16.01)
Individë	6,324	5,397	(14.66)
Persona juridikë	1,428	1,114	(21.98)
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	2,689	3,507	30.42
Individë	2,552	3,025	18.51
Persona juridikë	136	482	253.30
D Vendosje e bonos si kolateral	1,468	465	(68.34)
Individë	889	289	(67.51)
Persona juridikë	579	176	(69.60)
E Shlyerje e vlerës nominale në maturim	12,288	19,534	58.97
Individë	9,547	18,365	92.36
Persona juridikë	2,740	1,169	(57.34)

Figura 7: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, 2015 (Në %)






Figura 8: Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, 2016 (Në %)



- A** Blerje në tregun primar
- B** Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C** Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D** Vendosje e bonos si kolateral
- E** Shlyerje e vlerës nominale në maturim



Gjatë vitit 2016, sistemi i raportimit elektronik AMF In-Reg, vazhdon të funksionojë duke rritur efektivitetin dhe duke garantuar siguri dhe besueshmëri në analizën e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Ndërkohë, AMF synon që ta shtrijë plotësisht këtë sistem gjatë vitit 2017 për të gjeneruar raporte mbi këtë treg.

Platforma GSRM (Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë)

Gjatë vitit 2016, platforma e GSRM-së, vazhdoi të funksionojë dhe të përmbushë rolin e saj duke siguruar rritje të transparencës në kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Gjatë këtij viti, kjo platformë u zgjerua dhe me një operator të ri, "American Bank of Investments", duke e çuar në 11 numrin e operatorëve të licencuar nga AMF, për të tregtuar letrat me vlerë të Qeverisë.

Kjo platformë synon mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve, monitoron veprimtarinë e këtyre operatorëve dhe kujdeset që informacioni të jetë i përditësuar dhe në kohë reale. Platforma përfshin edhe një bazë të dhënash historike, e cila u vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna për qëllime statistikore apo akademike.

Platforma e GSRM-së jep një informacion të plotë për publikun dhe investitorët institucionalë në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë.

Gjatë vitit 2016, në platformën GSRM janë kryer 37,216 klikime, duke zënë 7.63% të të gjithë vizitave në faqen zyrtare të AMF-së.

Tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare

Gjatë vitit 2016, Autoriteti vijoi me miratimin e prospekteve për emetimin e obligacioneve me ofertë private. Karakteristikat e këtyre obligacioneve janë: interesi fiks, kuponi gjashtëmujor, afati i gjatë i maturimit. Obligacionet e shoqërive aksionare janë një segment potencial i zhvillimit të tregut të titujve. Gjatë vitit 2016, shumica e emetimit të obligacioneve të miratuara arriti në 1,665 milionë lekë.

Në vitin 2016, një nga shoqëritë tregtare që operojnë në tregun shqiptar emetoi për herë të parë dëftesa tregtare me afat 3 dhe 6 muaj. Këto dëftesa tregtare u emetuan përmes ofertave private dhe norma e interesit të tyre u orientua nga norma e interesit të bonove të thesarit me të njëjtin afat maturimi duke i shtuar marzhin e riskut që lidhet me investimin në këto tituj.

Platformat e tregtimit *online*

Në zbatim të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt" dhe Vendimit nr. 55, datë 30.03.2011 "Për njohjen e veprimtarisë së agentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë", Autoriteti miraton çdo subjekt që promovon një platformë të tregtimit *online*, e administruar nga një broker titujsh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Aktualisht, Autoriteti ka licencuar 2 shoqëri për të vepruar si agjentë në emër dhe për llogari të shoqërive të brokerimit të licencuara jashtë territorit, të cilat kanë nën administrim platforma të tregtimit *online*.

Në funksion të kompetencave të veta dhe mbështetjes ligjore, AMF në lidhje me subjektet e palicencuara dhe të pamiratuara që promovojnë platformat *online* të investimit ka ndjekur të gjithë hapat e duhur, duke:

- Kërkuar nga subjektet e palicencuara ndërprerjen e menjëhershme të çdo reklame, portali apo aktiviteti tjetër që sjell çorientim të publikut për veprimtari, të cilat duhet të kryhen vetëm me licencë;
- Komunikuar me autoritetet homologe (vendi i origjinës) të platformave *online*;
- Diskutuar në të gjitha mbledhjet e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), gjatë vitit 2016, për marrjen e masave dhe sidomos rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet e investimit në platformat *online* duke publikuar deklaratat për shtyp të GKSF;
- Komunikuar me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT);
- Komunikuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit (OKB);
- Njoftuar dhe komunikuar me Drejtorinë Kundër Krimit Ekonomik Financiar pranë Policisë së Shtetit.

Kapitulli 2 TREGU I SIGURIMEVE NË SHOIPËRI




3. ASPEKTE TË TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHOIPËRI

3.1 Struktura e Tregut

Në strukturë, tregu vazhdoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën rreth 93.09% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, sollën 6.36% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë 2016, sigurimet vullnetare zunë 38.13% dhe ato të detyrueshme zunë 61.87% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.

Figura 9: Struktura e tregut të sigurimeve, 2016

(Në %)



Primet e shkruara bruto në tregun shqiptar të sigurimeve u rritën me 9.13% krahasuar me vitin 2015, duke arritur në 15.37 miliardë lekë në fund të vitit 2016. Në vitin 2016 primet e Jo-Jetës kanë njohur një rritje prej 9.69% në ndryshim nga primet e jetës që kanë pësuar ulje me rreth 4.86%, krahasuar këto të dhëna me vitin 2015.

Figura 10: Primet e shkruara bruto ndër vite, 2007-2016




Tabela 9: Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe ndryshimi vjetor, 2014-2016

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto (mln. lekë)			Ndryshimi (në %)	
	2014	2015	2016	2015/2014	2016/2015
Jetë	1,026	1,028	978	0.19	(4.86)
Jo-Jetë	10,570	13,043	14,307	23.39	9.69
Risigurimi	27	13	84	(52.47)	548.85
Total	11,623	14,084	15,369	21.17	9.13

Numri i shoqërive të sigurimit që kanë operuar në tregun shqiptar të sigurimeve gjatë periudhës 2009-2016 paraqitet si më poshtë:

Tabela 10: Shoqëri sigurimi të licencuara sipas klasave të sigurimit

(Në numër)

Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Sigurim Jo-Jetë	7	7	7	8	8	7	7	7
Sigurim Jetë	2	2	2	2	2	2	2	2
Miks (Jetë dhe Jo-Jetë)	1	1	1	1	1	1	1	1

Privatizimi i INSIG

Në gjashtë mujin e parë të vitit 2016, shoqëria e sigurimit “INSIG” sh.a. si e vetmja shoqëri sigurimi me kapital shtetëror në tregun e sigurimeve u përfshi në procesin e privatizimit. Në maj 2016, Bordi i Autoritetit miratoi pjesëmarrjen influencuese të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a. në shoqërinë “INSIG” sh.a. në masën 100%.

Shoqëria “INSIG” sh.a. ka kryer veprimtarinë e sigurimit në klasat e Jo-Jetës dhe njëkohësisht të Jetës. Në mbështetje të kërkesave ligjore, me privatizimin e shoqërisë filloi edhe procesi i ndarjes së veprimtarisë.

Në muajin dhjetor, Bordi i AMF-së, pas miratimit të statutit të ri të shoqërisë INSIG dhe INSIG JETË, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të çdo shoqërie, miratimit të administratorëve të shoqërive respektive dhe ndjekjes së procedurave të duhura nga shoqëria mëmë INSIG, vendosi të miratojë ndarjen e shoqërisë INSIG në dy shoqëri të reja: shoqëria “INSIG” sh.a. me veprimtari në fushën e sigurimit për klasat e Jo-Jetës dhe shoqëria “INSIG JETË” sh.a. me veprimtari në fushën e sigurimit për klasat e Jetës. Megjithatë vlen të përmendet që deri në fund të vitit 2016 INSIG sh.a. ka vepruar dhe raportuar si një shoqëri mikse (Jetë dhe Jo-Jetë). Në janar 2017 shoqëritë “INSIG” sh.a. dhe INSIG JETË” sh.a. kanë filluar aktivitetin si shoqëri më vete respektivisht në klasat e Jo-Jetës dhe të Jetës.

3.2 Të Ardhurat në Tregun e Sigurimeve

Pjesa më e madhe e të ardhurave për tregun e sigurimeve gjenerohet nga aktiviteti i sigurimit, ose e thënë ndryshe, nga primet e fituara neto, si për aktivitetin e sigurimit të Jetës, ashtu edhe për sigurimin të Jo-Jetës. Të ardhurat e tregut të sigurimeve kanë ardhur duke u rritur vazhdimisht ndër vite.

Siç evidentohet në grafikët më poshtë, të ardhurat totale për tregun e sigurimit të Jetës kanë ruajtur një rënie të lehtë në krahasim me një vit më parë dhe në strukturën e të ardhurave për tregun në tërësi kanë shfaqur rënie të peshës. Shkak për këtë është bërë rritja e të ardhurave për sigurimin Jo-Jetë, duke rritur kështu peshën e këtyre të fundit në totalin e të ardhurave për tregun. Në 31.12.2016 të ardhurat nga sigurimi Jo-Jetë zunë 91.6% të të ardhurave të tregut të sigurimeve, kundrejt 8.4% që zunë të ardhurat nga sigurimi i Jetës. Në 31.12.2015, raporti ka qenë 89.5% për sigurimin Jo-Jetë, kundrejt 10.5% për sigurimin e Jetës.




Figura 11: Të ardhurat e tregut të sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës

(Në lekë)





Figura 12: Struktura e të ardhurave të tregut të sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës

(Në %)



Në 31.12.2016, të ardhurat për tregun e sigurimeve në tërësi janë rritur në masë të konsiderueshme, me rreth 14.7%, ose rreth 1.56 miliardë lekë në krahasim me 31.12.2015. Ndikimin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë primet e fituara që janë rritur me rreth 16.3%, ose 1.6 miliardë lekë. Gjithashtu, të ardhurat nga investimet kanë pësuar një rritje tepër modeste, me rreth 3.7%, ose rreth 15 milionë lekë, ndërkohë që të ardhurat e tjera, si p.sh. të ardhura nga paditë e regresit apo nga trajtimi i dëmeve shërbyese të Kartonit Jeshil, kanë rënë me rreth 32%, ose rreth 81 milionë lekë në krahasim me fundin e vitit 2015. Të ardhurat totale për tregun e sigurimeve kanë shfaqur një rritje të konsiderueshme gjatë tre viteve të fundit, duke arritur në rreth 12.2 miliardë lekë në 31.12.2016.

Në strukturën e të ardhurave për tregun e sigurimeve dominojnë primet që kanë arritur në 95.1%, në 31.12.2016, nga 93.8% në 31.12.2015. Ndërkohë, të ardhurat nga investimet kanë shfaqur një rënie të lehtë duke zënë 3.5% të totalit të të ardhurave, nga 3.8% një vit më parë dhe të ardhurat e tjera kanë shfaqur rënie të dukshme duke zënë një peshë 1.4% ndaj totalit të të ardhurave, nga 2.4% në 31.12.2015. Referuar grafikut të mëposhtëm, në strukturën e të ardhurave totale për tregun e sigurimeve ndër vite vërehet një trend i rritjes së peshës së të ardhurave nga primet, ndërkohë që ka një reduktim të vazhdueshëm të peshës së të ardhurave nga investimet, kurse të ardhurat e tjera kanë shfaqur luhatje duke shfaqur një trend në rënie për dy vitet e fundit.

Figura 13: Të ardhurat për tregun e sigurimeve dhe struktura e tyre

(Në lekë)





Figura 14: Struktura e të ardhurave për tregun e sigurimeve

(Në lekë)



Mundësitë e investimit në tregun vendas janë të kufizuara, dhe kryesisht konsistojnë në: depozita bankare, letra me vlerë dhe aktive të qëndrueshme. Në kushtet e pas krizës financiare globale me një realitet normash të ulëta interesi edhe niveli i të ardhurave nga investimet ka shënuar rënie.



Në 31.12.2016, të ardhurat për tregun e sigurimeve të Jetës kanë rënë, me rreth 7.8% ose 87 milionë lekë në krahasim me 31.12.2015. Ndikimin kryesor në këtë rënie e kanë dhënë të ardhurat e tjera dhe të ardhurat nga investimet, të cilat kanë rënë përkatësisht me 89% ose rreth 82 milionë lekë dhe 11%, ose rreth 8.5 milionë lekë, ndërkohë që të ardhurat nga primet janë rritur në mënyrë thuajse të papërfillshme me rreth 0.3% ose 3 milionë lekë në krahasim me fundin e vitit 2015.

Të ardhurat totale për sigurimin e Jetës, kanë shfaqur një rritje të vazhdueshme nga viti 2012 deri në vitin 2015, kur arritën vlerën rreth 1.1 miliardë lekë, duke vijuar më pas me një rënie në rreth 1 miliardë lekë në vitin 2016.

Në strukturën e të ardhurave për sigurimin e Jetës dominojnë të ardhurat nga primet e fituara, të cilat kanë arritur në 92.5%, në 31.12.2016, nga 85% në 31.12.2015, ndërkohë që të ardhurat nga investimet kanë rënë modestisht, duke arritur në 6.5%, nga 6.8% në 31.12.2015 dhe të ardhurat e tjera kanë shfaqur rënie në 1%, nga 8.2% në 31.12.2015. Referuar grafikut të mëposhtëm, në strukturën e të ardhurave totale për sigurimin e Jetës ndër vite vërehet një trend i rritjes së peshës së të ardhurave nga primet e fituara, përjashtuar këtu vitin 2015, ndërkohë që ka një reduktim të peshës së të ardhurave nga investimet dhe të ardhurave të tjera.

Figura 15: Të ardhurat në sigurimin e Jetës

(Në lekë)





Figura 16: Struktura e të ardhurave për sigurimin e Jetës

(Në %)



Në 31.12.2016, të ardhurat për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës janë rritur në masë të konsiderueshme, me rreth 17.3% ose rreth 1.6 miliardë lekë në krahasim me 31.12.2015. Ndikimin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë të ardhurat nga primet e fituara që janë rritur me rreth 18% ose 1.6 miliardë lekë. Gjithashtu, edhe të ardhurat nga investimet janë rritur me rreth 7.1% ose 23.5 milionë lekë, ndërsa të ardhurat e tjera janë rritur në masë të papërfillshme, me 0.6%, ose rreth 945 mijë lekë. Të ardhurat totale për sigurimin e Jo-Jetës, kanë shfaqur rritje të konsiderueshme gjatë tre viteve të fundit, duke arritur në rreth 11.2 miliardë lekë në 31.12.2016.

Në strukturën e të ardhurave për sigurimin e Jo-Jetës dominojnë të ardhurat nga primet e fituara, të cilat kanë arritur në 95.4% të totalit të të ardhurave për sigurimin e Jo-Jetës në 31.12.2016, nga 94.8% në 31.12.2015. Pësia e të ardhurave nga investimet ka rënë marzhinalisht në 3.2% në 31.12.2016, nga 3.5% në 31.12.2015, dhe të ardhurat e tjera kanë shfaqur rënie të lehtë në 1.5%, nga 1.7% në fund të vitit 2015. Referuar grafikut të mëposhtëm, në strukturën e të ardhurave totale për sigurimin e Jetës ndër vite vërehet një trend i rritjes së peshës së të ardhurave nga primet e fituara gjatë tre viteve të fundit, ndërkohë që ka një reduktim të peshës së të ardhurave nga investimet dhe të ardhurat e tjera.

Figura 17: Të ardhurat për sigurimin e Jo-Jetës

(Në lekë)







Figura 18: Struktura e të ardhurave për sigurimin e Jo-Jetës

(Në %)



3.3 Ndërmjetësit në Sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësitit në sigurime, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ushtrohet nga:

Agjentë, shoqëri agjentësh, bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, si dhe subjekte të tjera, kur shitja e produkteve të sigurimit nga këto subjekte, përputhet apo plotëson veprimtarinë parësore tregtare të tyre;

Brokera, shoqëri brokerimi, banka dhe/ose dega e bankës së huaj në Shqipëri.

Në procesin licencues të ndërmjetësve në sigurime, Autoriteti është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitetet në fushën e ndërmjetësitit të jenë të qarta, objektive dhe transparente. Këto kërkesa që pasqyrohen në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës” dhe Rregulloren nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, (e ndryshuar), e vënë theksin tek rritja e profesionalizmit dhe integritetit të personave që do të ushtrojnë aktivitetin në ndërmjetësimin e produkteve të sigurimit.

Broker në sigurime

Zhvillimet në tregun e sigurimeve dhe nevoja për mbrojtjen e interesave të individëve dhe bizneseve në procesin siguroes kanë rritur interesin e subjekteve për licencimin në tregun e ndërmjetësitit, veçanërisht në atë të brokerimit. Risia e vitit 2016 në këtë aspekt lidhet me interesin e bankave për t’u përfshirë në tregun e brokerimit.

Gjatë vitit 2016, Autoriteti miratoi licencimin për herë të parë të tre bankave të nivelit të dytë për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës, si dhe licencimin e dy shoqërive të reja brokerimi në sigurime të Jo-Jetës. Po kështu, numri i brokerave fizikë që punojnë për llogari të shoqërive të brokerimit u rrit ndjeshëm në krahasim me fundin e vitit 2015, gjë që pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Tabela 11: Të dhëna mbi brokera të licencuar në sigurime

(Në numër)

Statusi i Brokerit	Të licencuar në fund të 2015	Licenca të reja në 2016	Rinovim licence në 2016	Tërhequr licenca në 2016	Përfunduar licenca në 2016	Të licencuar në fund të 2016
Shoqëri brokerimi	9	5	-	-	-	14
Broker fizikë	14	24	6	-	9	35

Sipas llojit të licencës, shoqëritë e brokerimit klasifikohen si më poshtë:

Tabela 12: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit

(Në numër)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	3	7	5	5	5	4	5	6
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	-	-	-	1	2	2	2	5
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risig.	1	1	1	1	1	2	2	3
Totali	4	8	6	7	8	8	9	14

Agjentë në sigurime

Gjatë vitit 2016 vazhdoi miratimi i personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime të Jo-Jetës, jo vetëm në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimit: "INSIG" sh.a., "SIGAL UNIOA Group Austria" sh.a., "SIGAL LIFE UNIOA Group Austria" sh.a., "ANSIG" sh.a., por edhe për shoqëritë e sigurimit "ALBSIG" sh.a., "INTERSIG VIG" sh.a. dhe "Sigma Inter-Albanian VIG" sh.a. Ndërkohë në procesin e licencimit të veprimtarisë së agjentit u përfshinë edhe disa subjekte me aktivitet financiar dhe tregtar.

Tabela 13: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime

(Në numër)

	Të licencuar në fund të vitit 2015	Rinovim licence në 2016	Licenca të reja në 2016	Përfunduar afati i licencës në 2016	Tërheqje licence në 2016	Të licencuar në fund të vitit 2016
Persona juridikë	1	1	6	-	-	8
Person fizikë	256	36	116	38	36	334



Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Gjatë vitit 2016, AMF miratoi 8 licenca të reja për vlerësues të dëmeve në sigurime dhe rinovoi 7 licenca ekzistuese.

Tabela 14: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të licencuar

(Në numër)

<i>Vlerësues dëmsh në sigurime</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2015</i>	<i>Licencime të reja në 2016</i>	<i>Rinovim Licence në 2016</i>	<i>Përfunduar afati i licencës në 2016</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2016</i>
<i>sipas statusit të vlerësuesit</i>					
I pavarur	36	5	2	2	41
I punësuar	29	3	5	3	34
Licenca jo aktive	4	-	-	2	2
<i>sipas llojit të licencës</i>					
Për dëme materiale	4	1	1	2	4
Për dëme shëndetësore	12	2	1	1	14
Për dëme materiale dhe shëndetësore	53	5	5	4	59
Gjithsej vlerësues të licencuar	69	8	7	7	77

Aktuar në sigurime

Në zbatim të Rregullores së re nr. 57, datë 28.04.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”, gjatë muajit shtator dhe nëntor 2016, u rinovua licenca e 11 aktuarëve të autorizuar. Rinovimi i licencës u miratua pas përmbushjes së numrit të caktuar të krediteve në lidhje me përditësimin e njohurive profesionale.

Testi profesional në fushën e sigurimeve

Në zbatim të kërkesave rregullative, licencimi i profesionit të brokerit në sigurime, apo i vlerësuesit të dëmeve në sigurime është i lidhur me kalimin me sukses të testit për njohuritë profesionale në fushën përkatëse. Gjatë vitit 2016, Autoriteti ka organizuar 2 testime për aplikantët që kërkojnë të pajisen me licencën e brokerit në sigurime dhe 2 testime për vlerësuesit e dëmeve. Qëllimi i organizimit të testeve ka qenë certifikim i njohurive profesionale, me synim kryerjen e shërbimeve financiare nga profesionistë që njohin legjislacionin dhe fushën e aktivitetit ku do të operojnë.

4. TË ARDHURAT NGA PRIMET

4.1 Prime Jete

Edhe gjatë vitit 2016 aktivitetin e sigurimit të Jetës e ushtruan tri shoqëri sigurimi.

Në vitin 2016 primet e shkruara nga sigurimi i Jetës përbënin vetëm 6.36% të të ardhurave totale të aktivitetit siguroes kundrejt 7.30% që përbënin në vitin 2015.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës gjatë vitit 2016 pësuan një ulje prej 4.86%, ndërsa numri i kontratave pati një ulje prej 0.06%, krahasuar me vitin 2015.


Tabela 15: Klasat e sigurimit të Jetës në vitin 2016


(Në mln. lekë)

Klasat e sigurimit të Jetës	Primet e shkruara bruto
Jetë e debitorit	521.77
Jetë e kombinuar	44.88
Jetë dhe shëndet në udhëtim	32.10
Jetë në grup	123.75
Jetë e studentit	0.87
Jetë e nxënësit dhe studentit	1.57
Jetë me kursim	172.66
Flexi plani	15.21
Plani i pagesave "cash"	65.46
Të tjera	0.15
Gjithsej	978.42

Figura 19: Ndarja e tregut të sigurimit të Jetës

(Në %)





4.2 Prime Jo-Jete

Gjatë vitit 2016 aktivitetin e Sigurimit të Jo-Jetës e ushtruan 8 shoqëri sigurimi.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës gjatë vitit 2016 kanë njohur rritje prej 9.69% dhe numri i kontratave një rritje prej 2.97%, krahasuar me vitin 2015.

Figura 20: Struktura e primeve të shkruara bruto të tregut të Jo-Jetës, 2016

(Në %)




Figura 21: Ndarja e tregut të sigurimit të Jo-Jetës

(Në %)




Tabela 16: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës sipas portofoleve të sigurimit (Në mln. lekë)

Portfolet	2013		2014		2015		2016	
	Primet	%	Primet	%	Primet	%	Primet	%
Sigurimet Motorike	4,383	58.26	7,398	69.99	9,053	69.41	10,230	71.51
Sigurimet e Pasurisë	2,472	32.85	2,366	22.38	2,871	22.01	2,930	20.48
Sigurimi i Shëndetit	669	8.89	807	7.63	1,119	8.58	1,147	8.01
Gjithsej	7,524	100	10,570	100	13,043	100	14,307	100

Sigurimi Motorik

Në vitin 2016 të ardhurat e sigurimeve motorike zunë 71.51% të të ardhurave totale të sigurimeve të Jo-Jetës, kundrejt 69.41 që zinin në 2015. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë vitit 2016, shënoi rritje të primeve të shkruara bruto me rreth 13.01% krahasuar me vitin 2015, duke vazhduar të zërë peshën kryesore në këtë treg.

Sigurimi i Pasurisë

Në vitin 2016, megjithë rritjen në vlerë, sigurimet e pasurisë zunë 20.48% të të ardhurave totale të sigurimeve të Jo-Jetës, kundrejt 22.01% që zinin në 2015. Peshën kryesore në sigurimin e pasurisë e zuri sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës me rreth 46.66% të totalit të këtij portofoli. Në portofolin sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës, gjatë vitit 2016, vihet re një ulje prej 11.13% e volumit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli dhe një rritje me 14.87% e numrit të kontratave të sigurimit, krahasuar me vitin 2015.

4.3 Risigurimet


Për kontratat e sigurimit, vlera e rreziqeve të së cilave tejkalon mbulimin maksimal, vlerën 10% të vlerës së kapitalit, sipas përcaktimit në kuadrin ligjor dhe rregullator, të miratuar nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar.

Për produkte dhe raste të veçanta sigurimi, shoqëritë kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të Risigurimit Fakultativ për të zbutur efektet financiare të dëmeve të mëdha, të mundshme.

Strategjia e ndjekur nga tregu i sigurimit për transferimin e rrezikut, në përgjithësi, është realizuar nëpërmjet bashkësigurimit (kalimit të një pjese të rrezikut të kontratës së sigurimit në një kompani tjetër sigurimi), kalimit në risigurim të portofoleve të sigurimit si dhe

Risigurimi Fakultativ

Risigurimi Fakultativ nënkupton transferimin e një pjese të një rreziku të veçantë të siguruar nga shoqëria e sigurimit të shoqëria e risigurimit, sipas një kontrate të veçantë të risigurimit.



mbulimit me risigurim fakultativ të kontratave të veçanta. Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, AMF ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Marrëveshjet risiguroese në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim Humbje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit Surplus dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12. 2016 rezultojnë:


- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën prej 2.75 miliardë lekë ose sa 17.92 % e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu;
- Për sigurimin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.72 miliardë lekë ose sa 18.88% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 0.04 miliardë lekë ose sa 3.66% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës.

Gjatë vitit 2016, vlera e primeve të ceduara në risigurim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015:

- Në nivel tregu është ulur me rreth 63.84 milionë lekë ose 2.27 %;
- Për sigurimin e Jo-Jetës, është ulur me rreth 71.37 milionë lekë ose 2.56%;
- Për sigurimin e Jetës, është rritur me rreth 7.53 milionë lekë ose 26.61%.

Figura 22: Ecuria e primeve të ceduara në risigurim, 2011-2016

(Në lekë)



Paraqitja grafike e primeve të ceduara në risigurim në raport me primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës, jepet si më poshtë:

Figura 23: Primet e ceduara në risigurim në raport me primet e shkruara bruto (Në %)





Figura 24: Primet e ceduara në risigurim ndaj primeve të shkruara bruto, Jo-Jetë (Në %)






Paraqitja grafike e primeve të ceduara në risigurim në raport me primet e shkruara bruto për sigurimin e Jetës, jepet si më poshtë:

Figura 25: Primet e ceduara në risigurim ndaj primeve të shkruara bruto, Jetë

(Në %)



Në mënyrë të ngjashme me historikun e viteve të kaluara, pjesëmarrësit kryesorë në kontratat e risigurimit, për sigurimin e Jo-Jetës kanë qenë VIG Re, UNIOA Re, Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Partner Re, Scor, Lloyd's syndicates, etj. Për sigurimin e Jetës, shoqëria e vetme risiguroese e përfshirë në këtë program është Scor Global Life. Më shumë se 90% e partnerëve risiguroes të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BB nga Standard & Poors, nga ku mbi 60% kanë klasifikim më të lartë se A.

5. POZICIONI FINANCIAR

5.1 Aftësia Paguese


Në zbatim të kuadrit ligjor ekzistues, AMF gjatë vitit 2016 ka mbikëqyrur dhe ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore për nivelin e kërkuar të Mjaftueshmërisë së Kapitalit.

Mjaftueshmëria e Kapitalit për tregun e sigurimeve në 31.12.2015 ka qenë në nivelin 4.8 miliardë lekë. Ky nivel tejkalonte me rreth 297 milionë lekë nivelin e kërkuar të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (4.5 miliardë), i cili përfaqëson riskun e shoqërive të sigurimit në lidhje me aktivitetin e marrjes në sigurim. Në 31.12.2016, Mjaftueshmëria e Kapitalit për tregun rezultoi të jetë në nivelin 3.5 miliardë lekë, prej të cilit rreth 61% i përket tregut të shoqërive të Jo-Jetës dhe rreth 39% shoqërive të Jetës.


Për shoqëritë e sigurimit të Jetës, Mjaftueshmëria e Kapitalit në 31.12.2016 ka arritur në nivelin rreth 1.36 miliardë lekë apo rreth 249 milionë lekë mbi nivelin minimal të kërkuar. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ka rënë nga 150% në fund të vitit 2015, në 122% në 31.12.2016. Ky tregues për tregun e sigurimit të Jetës nuk paraqet shqetësim, edhe nëse paraqet një trend rënës gjatë tre viteve të fundit, pasi ka qenë gjithmonë dhe mbetet në masë të konsiderueshme mbi nivelin minimal të kërkuar me ligj.

Figura 26: Treguesi i aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të Jetës

(Në %)




Për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, Mjaftueshmëria e Kapitalit në 31.12.2016 ka arritur në nivelin rreth 2.1 miliardë lekë. Që në vitin 2013 ky tregues ka rezultuar më i ulët se minimumi i kërkuar. Në 31.12.2016 treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ka rënë akoma më ndjeshëm nën nivelin minimal të kërkuar, duke shënuar 60%. Përgjegjës për gjendjen e këtij treguesi janë tre nga shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë (nga tetë të tilla), të cilat rezultojnë nën nivelin e kërkuar të Mjaftueshmërisë së Kapitalit.



Shkaqet kryesore të rënies së Mjaftueshmërisë së Kapitalit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë janë: rritja e investimeve të tyre në pjesëmarrje në shoqëri sigurimi brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe si rrjedhim nevojat për transferim kapitali në këto degë dhe filiale, dhënia e huave nga shoqëritë brenda grupit të sigurimit të cilat sipas përcaktimeve ligjore janë elementë që ulin aftësinë paguese, ulja e normave të interesit për investimet financiare me pasojë uljen e fitimit dhe kufizimin e mundësive për shtesa të kapitalit nëpërmjet fitimit. Gjithashtu, gjatë vitit 2016, kjo diferencë është evidentuar më tepër si rrjedhim i aplikimit të mbikëqyrjes efektive me fokus rrezikun, përmirësimit të kërkesave rregullatore, raportuese dhe monitoruese nga AMF edhe në zbatim të plotësisht të rekomandimeve të lëna në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Figura 27: Treguesi i aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës

(Në %)



Gjatë vitit 2016, AMF ka ndërmarrë masa korrektuese mbikëqyrëse, si dhe masa ndëshkuese administrative ndaj shoqërive të sigurimit që janë në shkelje të kërkesave ligjore për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe që çënojnë shëndetin financiar të tregut të sigurimeve në tërësi. Autoriteti është duke mbajtur në monitorim të vazhdueshëm nivelin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit për shoqëritë e sigurimit, ka kërkuar nga shoqëritë respektive marrjen e masave të posaçme si pjesë të planeve korrektuese dhe është në ndjekje të zbatimit të masave korrektuese për përmirësimin e këtij treguesi.

5.2 Aktivitet dhe Investimet

Aktivitet, përfshirë këtu edhe Investimet e tregut të sigurimeve në 31.12.2016 u rritën me 4.4 miliardë lekë, ose 16.95%, krahasuar me 31.12.2015. Shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës kanë shfaqur një rritje domethënëse të aktiveve me rreth 4.98 miliardë lekë, duke kontribuar kështu në rritjen e aktiveve në nivel tregu, ndërkohë që shoqëritë e sigurimit të Jetës kanë pasur një rënie të totalit të aktivitetit me rreth 570 milionë lekë. Investimet përbëjnë 68.85% të totalit të aktivitetit dhe janë rritur me 2.41 miliardë lekë, ose 12.67%, krahasuar me 31.12.2015. Shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës kanë kontribuar në rritjen e investimeve në nivel tregu, duke shfaqur një rritje me rreth 2.57 miliardë lekë, ndërkohë që shoqëritë e sigurimit të Jetës kanë pasur një reduktim modest në totalin e investimeve, me rreth 161 milionë lekë.

Tabela 17: Dinamika e aktivitetit dhe investimeve në tregun e sigurimeve


(Në mln. lekë)

Periudha Ushtrimore	2012	2013	2014	2015	2016
Totali i aktiveve	20,343	21,839	24,451	27,610	32,014
Jetë	3,207	3,788	4,009	3,857	3,287
Jo-Jetë	17,136	18,051	20,442	23,752	28,728
Totali i investimeve	13,692	14,082	15,721	18,996	21,404
Jetë	2,748	2,971	2,684	2,904	2,743
Jo-Jetë	11,334	12,750	15,175	16,092	18,660

Investimet dominuan totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit dhe janë përqendruar në Depozita në institucione krediti (banka), Bono thesari dhe Obligacione. Në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, depozitat zënë peshën kryesore me 27.12%, duke u ndjekur nga Aksione dhe Interesa Pjesëmarrëse në Filiale me 19.07%, Bono Thesari dhe Obligacione me 8.66% dhe Toka dhe Ndërtesa me 7.46%. Tek shoqëritë e sigurimit të Jetës, investimet përbëjnë rreth 83.46% të totalit të aktivitetit dhe ndryshe nga ato të sigurimit Jo-Jetë, kanë një përqendrim të lartë në Bono Thesari dhe Obligacione, me 43.69% dhe në depozita, me 37.93% të aktivitetit të tyre.

Tabela 18: Struktura e Aktivitetit dhe Investimeve në tregun e sigurimeve, 31.12.2016 (Në mln. lekë)

Investimet	Tregu	% Aktivitet	Tregu i Jo-Jetës	% Aktivitet	Tregu i Jetës	% Aktivitet
Investime I+II+III	21,404	66.86	18,660	64.96	2,743	83.46
I. Toka dhe ndërtesa	2,165	6.76	2,144	7.46	22	0.66
II. Investime në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse	5,905	18.44	5,866	20.42	39	1.19
Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në filiale	5,478	17.11	5,478	19.07	-	0.00
Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në shoqëri me interesa pjesëmarrëse	47	0.15	8	0.03	39	1.19
Investime të tjera në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse	380	1.19	380	1.32	-	0.00
III. Investime të tjera financiare	13,333	41.65	10,651	37.07	2,683	81.62
Bono thesari dhe Obligacione	3,923	12.25	2,487	8.66	1,436	43.69
Depozita në bankë	9,037	28.23	7,790	27.12	1,247	37.93
Investime të tjera financiare	374	1.17	374	1.30	-	0.00




5.2.1 Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike

Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike për tregun e sigurimeve për periudhën 31.12.2016 është 96.27%, duke rezultuar me një rënie prej 10.54%, krahasuar me fundin e vitit 2015. Në nivel tregu ky tregues vazhdon të jetë nën nivelin minimal të kërkuar (100%). Ndikimin kryesor në rënieën e këtij treguesi e ka pasur Treguesi i Aktiveve në Mbulim të Provigjoneve Teknike për tregun e sigurimit të Jo-Jetës, i cili ka rënë në 95.37% në 31.12.2016, nga 104.56% në fund të vitit 2015. Treguesi i Aktiveve në Mbulim të Provigjoneve Matematike për tregun e sigurimit të Jetës qëndron mbi nivelin minimal të kërkuar (100%), por ka shfaqur gjithashtu rënie, nga 124.18%, në fund të vitit 2015, në 103.63% në 31.12.2016.

Figura 28: Aktivet në mbulim të provigjoneve për tregun e sigurimeve

(Në %)



Në Aktivet e Lejuara në Mbulim të Provigjoneve Teknike, peshën kryesore e zënë Depozita Bankare dhe Certifikata Depozitash, me 31.69%, ndjekur nga Letra me vlerë të Qeverisë me 23.22%, Risiguresit dhe Pjesa e Risiguruesve në Provigjone Teknike me 21.41%, Toka dhe Ndërtesa me 11.72% dhe Aktive të tjera me 11.96%.

Tabela 19: Aktivet e Lejuara në Mbulim të Provigjoneve Teknike për tregun e sigurimeve në 31.12.2016

(Në mln. lekë)

Përshkrimi	Tregu	% Aktivit	Jo-Jetë	% Aktivit	Jetë	% Aktivit
Letra me vlerë të Qeverisë	3,479	23.22	2,443	18.46	1,036	59.17
Bono Thesari	1,664	11.11	628	4.75	1,036	59.17
Obligacione të qeverisë	1,441	9.62	1,441	10.89	-	0.00
Të tjera	374	2.49	374	2.82	-	0.00
Depozita bankare	4,750	31.69	4,214	31.84	536	30.62
Toka dhe Ndërtesa	1,757	11.72	1,745	13.18	12	0.69
Mjete monetare	396	2.64	350	2.65	45	2.58
Risigurues >= BBB-	134	0.90	134	1.02	-	0.00
Pjesa e risiguruesve në P.T.	3,208	21.41	3,185	24.06	23	1.31
Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	688	4.59	632	4.77	56	3.21
Interesa dhe qira të llogaritura	106	0.71	86	0.65	20	1.14
Aktive afatgjata materiale të ndryshme nga Toka dhe Ndërtesa	469	3.13	446	3.37	22	1.28
Aktive të tjera	-	0.00	-	0.00	-	0.00
Total Aktivi të Lejuar	14,987	100.00	13,236	100.00	1,751	100.00
Mbulimi i Provigjoneve Teknike		96.27		95.37		103.63

Shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë kanë ndikimin kryesor në ecurinë e tregut në tërësi. Në 31.12.2016, pesë nga këto shoqëri janë nën nivelin minimal të kërkuar përse i përket treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

5.2.2 Portofoli i investimeve në letra me vlerë sipas maturitetit

Në 31.12.2016, portofoli i investimeve në letra me vlerë është në vlerën 3.9 miliardë lekë dhe përbën 12.25% të totalit të Aktivit. Për Shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, Portofoli i Investimeve në letra me vlerë përbën 8.66% të investimeve për klasën e Jo-Jetës, ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, ky portofol përbën 43.69% të investimeve për këtë klasë. Rritja e portofolit të letrave me vlerë të shoqërive të sigurimit, edhe gjatë vitit 2016, ndjek një trend të ngjashëm me atë të vitit 2015, ku arsyeja kryesore është rendimenti më i lartë në këto tituj.



Tabela 20: Struktura e Portofolit të Investimeve në Letra me Vlerë në 31.12.2016 (Në mln. lekë)

Portofoli i investimeve në letra me vlerë	Tregu	Tregu i Jo-Jetës	Tregu i Jetës
Letra me vlerë të Qeverisë	3,922.78	2,486.78	1,436.00
<i>Bono thesari</i>	1,362.70	884.90	477.80
0-6 muaj	-	-	-
6-12 Muaj	1,362.70	884.90	477.80
<i>Obligacione të qeverisë</i>	2,560.08	1,601.88	958.20
2-5 Vjeçare	819.07	223.07	596.00
> 5 Vjeçare	1,741.01	1,378.81	362.20

5.2.3 Portofoli i investimeve në depozita bankare

Fondi i Garancisë

Fondi i Garancisë është një shumë në mjete monetare (vlera e së cilës është përcaktuar në Nenin 81 të Ligjit nr. 52/2014) e depozituar nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit në një llogari bankare qëllimore me të njëjtin emër, në bankat në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku shoqëria ka selinë qendrore të saj, e detyrueshme për t'u disponuar nga sigurosi që nga çasti i fillimit të veprimtarisë dhe në vazhdim. Shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në "depozita qëllimore" me afat 1-vjeçar pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari dhe obligacione qeveritare.

Totali i fondeve të bllokuara për fondin e garancisë për tregun është në vlerën rreth 5.04 miliardë lekë në 31.12.2016. Gjatë vitit 2016, ky fond është investuar në depozita pranë bankave tregtare dhe në letra me vlerë, përkatësisht në masën 83% dhe 17%.

Tabela 21: Struktura e Investimit të Fondit të Garancisë në 31.12.2016 (Në mln. lekë)

	Tregu	Jo-Jetë	Jetë
Fondi i Garancisë	5,037.12	3,913.04	1,124.08
Depozita	4,166.12	3,442.04	724.08
Bono Thesari	871.00	471.00	400.00

Depozitat përbëjnë 42.22% të investimeve dhe janë të përbëra nga depozita me afat maturimi nga 3 muaj, deri në 2 vjet. Diversifikimi i këtij portofoli sipas monedhës paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela 22: Struktura e Investimit në Depozita Bankare në 31.12.2016 (Në mln. lekë)

	Tregu	Jo-Jetë	Jetë
Depozita bankare	9,036.92	7,790.26	1,246.66
Lekë	4,752.84	4,307.94	444.90
Valutë ⁷	4,284.08	3,482.32	801.76

Shënim: ⁷ Konvertuar në Lekë me kursin e publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 31.12.2016.

5.3 Provigjonet teknike

Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Në analizën e treguesve, mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Në nivel tregu provigjonet teknike, ndër vite, shfaqin një tendencë në rritje duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit të Jetës dhe Jo-Jetës. Në vazhdimësi, peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, duke reflektuar edhe strukturën e tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguresi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit. Provigjonet teknike përfshijnë:

Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për reziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;

Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit, (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;

Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;

Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;

Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit, me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe reziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga reziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe reziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Rregullorja e Provigjoneve Matematike

Gjatë vitit 2016 është miratuar rregullorja "Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes së provigjoneve matematike, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike dhe kriteret e procedurat e miratimit të tyre".

Kjo rregullore vjen si nevojë e përshtatjes së bazës rregullatore me zhvillimet e aktivitetit të sigurimit të Jetës dhe në kuadrin e projektit me Bankën Botërore për asistencën teknike në Sigurime (FIRST Insurance), lidhur me metodologjitë më të mira për t'u përdorur në llogaritjen e provigjoneve matematike.

Risite kryesore të kësaj rregulloreje kanë të bëjnë me:

- Thellimin në përcaktimin e parimeve kryesore, që duhet të zbatohen nga shoqëritë e sigurimit të Jetës gjatë përlllogaritjeve aktuariale të nivelit të provigjoneve matematike;
- Përcaktimin e parimeve kryesore lidhur me pjesën e shpenzimeve në provigjonet matematike, ku theksohet rëndësia e vlerësimit të tyre mbi bazën e hipotezave të qëndrueshme dhe realiste dhe duke përdorur metoda të përshtatshme të vlerësimit të pjesës së shpenzimeve në tarifën e primit;




- “Zilmerizimin” (ose metoda e Zilmerit) që konsiston në procesin aktuarial të Zilmerizimit, i cili nënkupton rritjen e shumës së primeve neto të ardhshme për efekt të llogaritjes së provigjoneve matematike, si rezultat i përfshirjes në këtë shumë të shpenzimeve të marrjes në sigurim të paguara në fillim të kontratës;
- Përcaktimin e bazave financiare të llogaritjes së provigjoneve matematike, lidhur me normat e interesit që përdoren në llogaritjen e provigjoneve matematike, për lloje të ndryshme produktesh në varësi të karakteristikave teknike të tyre dhe, mbështetur në praktikat më të mira dhe direktivat përkatëse;
- Dispozita shtesë për mbajtjen e llogarive të veçanta. Konkretisht, shoqëria e sigurimit duhet të mbajë dhe paraqesë të veçanta llogaritë që janë objekt i kësaj rregulloreje për sigurimet e Jetës si edhe sigurimet e tjera të natyrës afatgjatë që janë të ngjashme me to për nga mënyrat e llogaritjes.

Rregullorja është miratuar me Vendimin e Bordit nr. 187, datë 24.11.2016

Figura 29: Provigjonet teknike bruto, 2007–2016

(Në mln. lekë)



Provigjoni Teknik Bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik

Provigjoni teknik bruto për produktin e MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Për 31.12.2016 ky tregues ka vijuar tendencën në rritje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 70% për këtë periudhë nga 67% për 31.12.2015. Kjo tendencë është në linjë me strukturën e primeve të lëshuara në nivel tregu.

Tabela 23: Vlera e provigjonit teknik të sigurimit të detyrueshëm

Emërtimi	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Provigjone bruto total MTPL	4,594,762	4,903,000	5,876,000	7,606,407	8,259,209	9,757,238
Provigjone bruto total Jo-Jetë (Në lekë)	6,781,384	7,375,000	7,980,000	9,662,572	12,409,665	13,866,272
Raporti i sigurimeve të detyrueshme ndaj totalit të tregut (në %)	68%	66%	74%	79%	67%	70%

Tabela 24: Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm

(Në %)

Emërtimi	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	62	56	52	53	52	52
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL	38	44	48	47	48	48
Provigjone bruto total MTPL	100	100	100	100	100	100

Gjithashtu përsa i përket strukturës së provigjontit teknik të sigurimit të detyrueshëm në ndarjen, provigjon teknik i dëmeve dhe provigjon i primit të pafituar, në vazhdimësi vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve. Gjatë vitit 2016, vlen të theksohet që kjo shpërndarje e peshave është ruajtur me gjithë reflektimin e rritjes së tarifave të shitjes së sigurimit të detyrueshëm gjatë muajit gusht të këtij viti, tregues i cili shfaq efektin e vet tek provigjoni i primit të pafituar.

5.4 Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Administrimi i infrastrukturës së shërbimeve dhe përmirësimi i sistemeve informatike të teknologjisë së informacionit (TI) me elementë të rinj kanë qenë gjithnjë ndër synimet e teknologjisë në AMF, duke i shërbyer mbikëqyrjes dhe analizës sa më efektive të tregut.


Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik përbëhet nga Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, si dhe Regjistri i Dëmeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, të cilat kanë një bazë të plotë të dhënash me policat e shitura për sigurimet e detyrueshme motorike në Republikën e Shqipërisë, si dhe bazën e të dhënave të raportimit *online* për dëmet e ndodhura e cila ka edhe të dhënat bazuar në informacionin historik të akumuluar. Të dhënat e Qendrës përditësohen përmes regjistrimit *online* në kohë reale të policave të shitura nga shoqëritë e sigurimit dhe regjistrimit *online* të të dhënave për dëmet.

Në këtë bazë të dhënash kryhet raportimi dhe identifikimi në kohë reale i shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, gjatë vitit 2015, përfundoi zbatimi teknik i sistemit *Bonus-Malus*. Ky sistem bën të mundur tarifimin me fokus rrezikun në sigurimin motorik. Sistemi mundëson edhe integrimin e lidhjes me regjistrin e automjeteve nga i cili shoqëritë e sigurimit mund të marrin të dhënat e mjetit, të cilat e vendosin atë në një kategori të caktuar e cila nuk mund të ndryshohet. Kjo kufizon mundësitë e abuzimeve dhe gabimeve duke përmirësuar procesin e lëshimit të policës.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, përbën infrastrukturën bazë për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit *Bonus-Malus*. Ajo administrohet nga AMF dhe përbëhet nga:

- Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi dhe identifikimi në kohë reale të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar;
- Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike, i cili është një platformë raportimi e dëmeve të ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike.



5.4.1 Sistemi Bonus-Malus

Ky sistem bën të mundur tarifimin me fokus rrezikun në sigurimin motorik. Aktualisht agjentët e shitjeve të policave të sigurimit mund të kërkojnë të dhëna mbi automjetin dhe pronarin e automjetit nëpërmjet targës dhe numrit të shasisë. Në këtë fazë, përveç të dhënave të mësipërme të automjetit, sistemi gjeneron dhe dërgon edhe të dhëna rreth kategorisë së automjetit sipas informacionit bazuar në Regjistrin Kombëtar të Automjeteve, por agjentët nuk kanë të drejtë t'i ndryshojnë të dhënat duke parandaluar në këtë mënyrë abuzime të ndryshme.

Sistemi *Bonus-Malus* prezanton një skemë universale të vlerësimit të tarifës për policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, ku për çdo rinovim të policës së sigurimit, për cilindo të siguruar, në varësi të dëmeve të ndodhura gjatë periudhës së mëparshme të sigurimit, përlogaritjet koeficienti që do të aplikohet mbi tarifën bazë të sigurimit. Ky koeficient do të ndikojë në rritjen ose uljen e vlerës së tarifës së sigurimit, respektivisht nëse i siguruari ka bërë dëme ose jo gjatë periudhës së siguruar.

Sistemi *Bonus-Malus* pasqyron profilin e riskut, duke individualizuar tarifën e primeve. Kjo nënkupton, nëse i siguruari përfshihet në një nga klasat e *Bonusit*, primi do të zvogëlohet dhe e kundërta do të ndodhë nëse përfshihet në klasat e *Malusit*, në varësi të historikut të dëmeve që i siguruari do të ketë për një periudhë të caktuar.

Autoriteti në bashkëpunim me palët e interesuara kanë përcaktuar algoritmin, si dhe numrin e klasave të sistemit *Bonus-Malus*. Konkretisht, sistemi është i përbërë nga 18 klasa, ku në mënyrë konvencionale klasa 1 do jetë klasa në të cilën të siguruarit do paguajnë më pak prim dhe klasa 18 më penalizuesja. Me fillimin e zbatimit të sistemit të gjithë të siguruarit do të caktohen në klasën 13, të cilës i përket koeficienti *Bonus-Malus* i barabartë me 1, në vijim klasa që i është shënuar një të siguruari për periudhën e sigurimit është e përcaktuar nga klasa paraardhëse dhe nga numri i dëmeve të raportuar të një viti më parë. Secilës klasë i përket një koeficient primi i veçantë β_p , ku P nënkupton numrin e klasave dhe $\beta_1 \leq \dots \leq \beta_{18}$.

Sistemi *Bonus-Malus* për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL do të konsistojë në:

- Uljen e klasës së riskut me një klasë në rastet e të siguruarit që nuk shkakton asnjë dëm gjatë vitit të kontratës;
- Rritjen e klasës së riskut me: 2 (dy) klasë nëse i siguruari bën një dëm gjatë vitit të kontratës; 5 (pesë) klasë nëse bën dy dëme, etj.


Zbatimi i sistemit *Bonus-Malus* nga ana e të siguruarve do hyjë në fuqi me miratimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar, ku parashikohet edhe përfshirja në ligj e aplikimit të këtij sistemi në mënyrë të detyruar nga shoqëritë e sigurimeve në përlogaritjen e tarifave të primeve.

Një përmirësim dhe funksionalitet shumë i rëndësishëm i Qendrës së Informacionit, që është efektiv prej 2014 është konsultimi në kohë reale nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile duke ofruar numrin personal të pronarit të mjetit si çelës për kërkimin e historikut *Bonus-Malus* dhe kategorizimin e saktë të pronarëve në nivelet e rrezikut, i cili është në përdorim nga shoqëritë e sigurimit prej vitit 2015.

Me përfundimin e dy fazave sistemi është plotësisht funksional dhe parametrat e rrezikut, që janë numri i dëmeve dhe numri i viteve të plota TPL dërgohen drejt sistemeve të shoqërive të sigurimit duke bërë të mundur tarifimin me bazë rreziku.


AMF ka përgatitur dhe draft rregulloren përkatëse për zbatimin e sistemit *Bonus-Malus*, e cila pritet të miratohet në kuadrin e ndryshimeve të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, ku parashikohet edhe përfshirja në ligj i aplikimit të këtij sistemi në mënyrë të detyrues nga shoqëritë e sigurimeve në përlogaritjen e tarifave të primeve.

5.4.2 Sistemi i Administrimit të Informacionit



AMF dhe shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në treg kanë në përdorim të vazhdueshëm sistemin “AMF In-Reg”, i cili përbëhet nga një platformë raportimi *online* nëpërmjet së cilës operatorët e subjekteve të mbikëqyrura raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet një aplikacioni web.

Ky sistem për administrimin e informacionit administrohet dhe mirëmbahet nga AMF.




6. ECURIA E TREGUT TË SIGURIMEVE

6.1 Tregu i Sigurimit të Jetës

Përsa i përket rezultatit financiar për tregun e sigurimit të jetës, në periudhën raportuese 31.12.2016 vihet re një ulje e konsiderueshme prej 67.2%, në krahasim me vitin 2015. Në grafikun e mëposhtëm rezultati financiar për sigurimin e jetës paraqitet i qëndrueshëm ndër vite, ndërkohë që rezultati financiar i tregut të sigurimeve në tërësi shfaq luhajtje.

Figura 30: Rezultati financiar për shoqëritë e sigurimit të Jetës


(Në lekë)



Rezultati financiar i shoqërive të sigurimit të Jetës, në 31.12.2016 zë një peshë prej 15.7% mbi rezultatit të tregut, duke rënë nga 38.3% që ka qenë në fund të vitit paraardhës. Ky fenomen ndjek rënien e primeve të shkruara bruto dhe zvogëlimin e pjesëmarrjes në treg për shoqëritë e sigurimit të Jetës, ndërkohë që tregu i sigurimeve në tërësi ka shfaqur zgjerim të vazhdueshëm.

Figura 31: Pesha e rezultatit financiar për shoqëritë e sigurimit të Jetës ndaj totalit

(Në %)



Aktivet e tregut të sigurimeve të Jetës më 31.12.2016 janë 3,286,875,122 lekë dhe zënë 10.36% të totalit të aktiveve të tregut të sigurimeve. Raporti i aktiveve të tregut të sigurimit të jetës mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) është rreth 0.22%.

6.2 Tregu i Sigurimeve të Jo-Jetës

Përsa i përket rezultatit financiar të shoqërive të sigurimit Jo-Jetë, për vitin 2016, vihet re një rritje prej 9.5% ose rreth 36 milionë lekë, krahasuar me vitin 2015. Pesha specifike e rezultatit financiar të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës ndaj rezultatit të tregut të sigurimeve në total është 84.3%. Krahasuar me vitet e mëparshme, vërehet një rritje e peshës së rezultatit të këtyre shoqërive ndaj rezultatit total, siç paraqitet edhe në grafikët e mëposhtëm.



Figura 32: Rezultati financiar për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës

(Në Lekë)





Figura 33: Peshë e rezultatit financiar mbi totalin e tregut për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës

(Në %)



Në vitin 2016, aktivet e tregut të sigurimeve Jo-Jetë janë në vlerën 28 miliardë lekë dhe përbëjnë rreth 89.63% të totalit të aktiveve të tregut të sigurimeve. Aktivet e tregut të sigurimit të Jo-Jetës për vitin 2016 përbëjnë rreth 1.94% të PBB-së në këtë periudhë.

7. SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK: PRIMET DHE DËMET

7.1 Sigurimi i Detyrueshëm Motorik

Primi i rrezikut

Në kuadër të projektit të Bankës Botërore FIRST, lidhur me sigurimin e detyrueshëm TPL, mbi liberalizimin e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, shoqëritë e sigurimit janë njohur dhe kanë pranuar modelin e llogaritjes së primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, metodologji e cila është përshtatur dhe përdorur dhe në vlerësimin e primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të Kartonit Jeshil dhe atë Kufitar. Bazuar në kërkesat e kësaj metodologjie, ku elementët kryesorë për përcaktimin e primit të rrezikut, janë frekuenca dhe kostoja mesatare e dëmeve, shoqëritë e sigurimit marrin në konsideratë inflacionin e dëmit ndër vite si dhe bëjnë projeksionin e tij për periudhat e ardhshme financiare, element ky i rëndësishëm në përcaktimin e një vlere sa më të saktë të primit të rrezikut të ardhshëm.

Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti pasardhës. Ky prim është orientues për tregun e sigurimit lidhur me vlerësimin e primit të rrezikut që do të kryejnë vetë shoqëritë e sigurimit.

Në terma konkretë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015, vihet re një rritje me rreth 4.3% e primit të rrezikut në nivel tregu për portofolin TPL e brendshme (e llogaritur si mesatare e ponderuar e të gjitha kategorive të TPL-së), si rezultat i rritjes së koston mesatare të dëmeve të ndodhura, që përfshijnë dëmet e paguara dhe ato të provigjonuara, si dhe vlerës së dëmeve për Fondin e Kompensimit. Konkretisht, vlera e primit të rrezikut për vitin 2016 ka rezultuar 12,682 lekë kundrejt 12,160 lekë në vitin 2015.

Primi mesatar i kategorive kryesore të mjeteve për sigurimin e detyrueshëm MTPL

Primi i paguar nga të siguruarit përbëhet nga disa elementë. Këto elementë përfshijnë, primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit si dhe taksat.

Primi i paguar nga të siguruarit përfshin primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit si dhe taksat.

Tabela 25: Primi mesatar i paguar për motoçikleta, autovetura, furgonë 2015 - 2016 (Në lekë)

Emërtimi/Kategoria	A1/1	A1/2	B1/1	B1/2	B2/1	B2/2
2015	5,640	8,550	15,100	15,850	24,500	29,050
2016	6,150	9,210	16,330	17,120	26,500	31,440



Nëse i referohemi kategorisë B1/1, që përfaqëson autoveturat deri në 1600 cm³, primi i paguar nga i siguruari duke përfshirë taksat dhe kontributet rezulton 13,630 lekë.

Primi mesatar i paguar nga të siguruarit për kategoritë kryesore për periudhën janar-shtator 2016, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka pësuar një rritje afërsisht me 2.5%. Rritja e konstatuar është më e ulët se rritja e taksës mbi primin nga 3% në vitin 2015 në 10% nga janari i vitit 2016.


7.2 Raporti Dëme/Prime

Dëmet

Gjatë vitit 2016, shoqëritë e sigurimeve paguan rreth 4.24 miliardë lekë dëme, ose rreth 16.64% më shumë se në vitin 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimeve motorike me rreth 2.6 miliardë lekë, apo 61.45% të totalit.

Figura 34: Dëmet e paguara bruto të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe vullnetar në vite

(Në mln. lekë)



Në 31.12.2016, raporti dëme/prime neto⁸ ka shënuar një rënie prej 8.07%, krahasuar me një vit më parë. Ky raport në 31.12.2016 është 29.22% nga 37.29% që ishte në 31.12.2015.

Arsyeja kryesore e rënies së këtij raporti është bërë rritja e ndjeshme e primeve të fituara neto, ndërkohë që shpenzimet neto për dëmet e ndodhura janë ulur.


Primet e fituara neto në 31.12.2016 janë rritur me 16%, ose 1.6 miliardë lekë, ndërkohë që shpenzimet neto për dëmet e ndodhura kanë pësuar një rënie prej 7%, ose rreth 272 milionë lekë, në krahasim me një vit më parë.


⁸ Shënim: Në raportin dëme/prime neto, si për shpenzimet për dëmet, ashtu edhe për primet e fituara, vlerat janë netuar për rezervat teknike dhe pjesën që i takon risiguruesit.

Më poshtë paraqitet në formë grafike tendenca e raportit dëme/prime që nga viti 2012 në nivel tregu, për të gjithë aktivitetin e sigurimeve, Jetë dhe Jo-Jetë, në Shqipëri:

Figura 35: Raporti Dëme/Prime Neto për tregun e sigurimeve

(Në %)





8. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

8.1 Projektligj dhe akte nënligjore, të reja dhe ndryshime tek ekzistueset

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit””, i ndryshuar.

Qëllimi i hartimit të projektligjit është:

- Zgjidhja e problemeve të hasura gjatë zbatimit në praktikë të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar;
- Përafrimi i mëtejshëm me direktivat evropiane;
- Përshtatja me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të sigurimeve;
- Zbatimi i sistemit *Bonus-Malus*.

Nevoja për ndryshime në këtë ligj erdhi edhe si angazhim i AMF-së në përmbushje të rekomandimeve të Komisionit Evropian, të evidentuara si në progres raportet ashtu edhe në takimet vjetore të Nën Komitetit BE-Shqipëri “Tregu i brendshëm dhe Konkurrenca”.

Në fokus të këtij projektligji është përcaktimi i saktë i disa koncepteve jo të qarta, të cilat kanë krijuar probleme gjatë zbatimit të ligjit ekzistues duke krijuar shpesh hapësira interpretuese, e zbatim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave. Më konkretisht, në lidhje me zbatimin e kufijve të përgjegjësisë të dëmit jo pasuror, duke krijuar një situatë me efekte negative në tregun e sigurimeve, duke dëmtuar interesat e të siguruarve apo dhe aktorëve të tjerë që operojnë në këtë fushë.

Në tërësi, projektligji synon të:

- Ndikojë në uljen e numrit të drejtuesve të mjeteve të transportit që qarkullojnë të pa pajisur me kontratën e sigurimit të detyrueshëm;
- Përmirësojë zbatimin e ligjit aktual të sigurimit të detyrueshëm nga ana e autoriteteve përgjegjëse;
- Përmirësojë procedurat dhe afatet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim nga ana e shoqërive të sigurimit;
- Ndikojë në edukimin, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin e konsumatorit;
- Shmangë konflikte të mundshme të ardhura nga zbatimi i gabuar i ligjit.

Nga kjo paketë ndryshimesh, ata që do të përfitojnë të parët janë konsumatorët, si në drejtim të mbrojtjes së interesave të tyre në rastet e dëmshpërblimit, ashtu edhe në drejtim të mbrojtjes së tyre në përgjithësi përkundrejt shërbimeve që do t’u ofrohen dhe garancive që ata do të kenë nga shoqëritë e sigurimit.

Me këtë projektligj synohet përafrimi i pjesshëm me Direktivat Evropiane të fushës së sigurimit motorik, të cilat kanë për qëllim harmonizimin e funksionimit dhe mbikëqyrjes së kësaj veprimtarie dhe konkretisht Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.

Më 5 shtator 2016, me Nr. Prot. 2106, projektligji është dërguar nga Autoriteti pranë Ministrisë së Financave për të ndjekur procedurën e miratimit të këtij projektligji së bashku me relacionin përkatës dhe tabelat e përputhshmërisë në shqip dhe në anglisht.

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016 Autoriteti shqyrtoi dhe zbatoi, rast pas rasti, të gjitha komentet e ardhura nëpërmjet Ministrisë së Financave nga ministrinë e linjës dhe nga palët e interesit.

Me shkresën Nr. Prot. 2896/5, datë 15.12.2016, Autoriteti ka ridërguar përsëri në Ministrinë e Financave, pas përfundimit të procesit të zbatimit të komenteve nga palët e interesit, ministrinë e linjës dhe Banka Botërore, versionin e përditësuar të këtij projektligji, për vazhdimin e ndjekjes së procedurave përkatëse të miratimit të tij nga ana e kësaj ministrie. Në këtë version të përditësuar të projektligjit janë shqyrtuar dhe reflektuar përkatësisht komentet e mëposhtme të:


- Ministrisë së Drejtësisë (Shkresë nr. 6173/2, datë 03.10.2016);
- Ministrisë së Integritit (Shkresë nr. 11938/5, datë 06.10.2016);
- Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (Shkresë nr. 11938/13, datë 17.10.2016);
- Autoritetit të Konkurrencës (Shkresë nr. 11938/19, datë 03.11.2016);
- Ministrisë së Financave (Shkresë nr. 11938/22, datë 25.11.2016);
- Ministrisë së Shëndetësisë (Shkresë nr. 11938/17, datë 26.10.2016);
- Byrosë Shqiptare të Sigurimit (Shkresë nr. 11938/18, datë 31.10.2016).

8.2 Akte nënligjore

Të reja

Gjatë vitit 2016, u hartuan dhe u miratuan 12 rregullore të reja, 1 Kod Etik dhe 1 Manual Mbikëqyrjeje:

1. Rregullorja nr. 1, datë 25.01.2016 “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, përcakton formën, procedurën dhe mënyrën e depozitimit të informacionit e dokumentacionit për burimin e kapitalit të derdhur nga aksionarët në shoqërinë e sigurimit, si në momentin e themelimit ashtu dhe për çdo shtesë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë;
2. Rregullorja nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i formës, afateve dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare dhe raporteve statistikore që detyrohet të përgatisin dhe depozitojnë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare shoqëritë e agjentëve dhe shoqëritë e brokerimit në sigurime;
3. Rregullorja nr. 8, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti”, synon të përcaktojë bazat, metodat e llogaritjes së provigjoneve matematike për klasat e sigurimit të Jetës apo në klasa të tjera sigurimi ku primet janë grumbulluar në formën e një fondi kursimi ose një fondi për t’u përdorur për mbulimin e rreziqeve të viteve të ardhshme, të cilat janë të natyrës afatgjatë dhe janë subjekt i tabelave të probabilitetit dhe llogaritjeve të njëjta me ato të Jetës, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti;
4. Rregullorja nr. 9, datë 25.01.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti”, ka për objekt përcaktimin e bazave, metodave të llogaritjes, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike për klasat e sigurimit të Jo-Jetës, si dhe kriteret dhe procedurat e miratimit të tyre nga Autoriteti;



5. Kodi i Etikës së Aktuarëve u miratua me vendim Bordi nr. 15, datë 26.02.2016 me qëllim promovimin e rregullave dhe parimeve të sjelljes e të etikës profesionale për aktuarët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fushat që ushtrojnë veprimtarinë;
6. Rregullorja nr. 38, datë 31.03.2016 “Për përmbajtjen, mënyrën, formën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF” nga shoqëritë e sigurimit”, paraqet në mënyrë të detajuar rastet kur shoqëria e sigurimit është e detyruar të raportojë, njoftojë në Autoritet, në lidhje me faktet, rrethanat, duke i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar;
7. Rregullorja nr. 40, datë 31.03.2016 “Mbi formën, përmbajtjen dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave të ndërmjetësve në sigurime”, përcakton përmbajtjen, formën dhe rregullat për mbajtjen e regjistrave të personave fizikë dhe juridikë që janë licencuar nga Autoriteti, për të kryer veprimtari ndërmjetësimi në sigurime;
8. Rregullorja nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi metodën e llogaritjes së normës së likuiditetit dhe nivelit minimal të saj nga shoqëria e sigurimit, që ushtron veprimtari në klasat e Jo-Jetës”, ka në fokus të saj metodën e llogaritjes së normës së likuiditetit, planin e masave të përshtatshme për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit si edhe përmbajtjen, mënyrën dhe afatet kohore për njoftimin në Autoritetin e Mbrojtjes Financiare;
9. Rregullorja nr. 57, datë 28.04.2016 “Mbi trajnimet e vazhdueshme profesionale dhe rinovimin e licencës së aktuarit të autorizuar”, trajton rregullat e trajnimit profesional dhe vlerësimit të njohurive teknike të nevojshme për ushtrimin e detyrave të aktuarit të autorizuar;
10. Rregullorja nr. 76, datë 30.05.2016 “Mbi kategoritë e investimeve të lejuara, kufizimet që zbatohen dhe përdorimin e instrumenteve financiare derivative”, cakton kategoritë e investimeve të lejuara, kufizimet që zbatohen për investimin e aktiveve, përdorimin e instrumenteve financiare derivative, si dhe përmbajtjen, mënyrën dhe afatet kohore për njoftimin e Autoritetit të Mbrojtjes Financiare;
11. Rregullorja nr. 87, datë 27.06.2016 “Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit të shoqërive të sigurimit”, qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave më të detajuara lidhur me elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit dhe klasat e aktiveve ku ato zbatohen;
12. Rregullorja nr. 187, datë 24.11.2016 “Mbi bazat dhe metodat e llogaritjes së provigjoneve matematike, mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike dhe kriteret e procedurat e miratimit të tyre”. Kjo rregullore vjen si produkt i komponentit të projektit me Bankën Botërore për asistencën teknike në Sigurime (*FIRST Insurance*), lidhur me metodologjitë më të mira për t’u përdorur në llogaritjen e provigjoneve matematike. Kjo rregullore është e ngjashme në përmbajtje me Rregulloren nr. 8, datë 25.01.2016 “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike” dhe për këtë arsye kjo e fundit shfuqizohet në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 270, të Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014;
13. Rregullorja nr. 200, datë 27.12.2016 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është caktimi i llojeve dhe karakteristikave të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, parimeve dhe rregullave të investimit nga shoqëritë e sigurimit/risigurimit që ushtrojnë veprimtari sigurimi në klasat e sigurimit të Jetës kategorive të tjera të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, si dhe rregullave për diversifikimin

kufizimin në lidhje me investimin e aktiveve, vlerësimin e tyre, si edhe mënyrat dhe afatet e raportimit në Autoritet;

14. Manuali i Mbikëqyrjes për Parandalimin e Pastrimit të Parave nr. 136, datë 29.09.2016 u hartua në vijim të plotësimit të bazës rregullore të mbikëqyrjes për zbatimin e dispozitave ligjore për parandalimin e pastrimit të parave nga ana e subjekteve që AMF licencon dhe mbikëqyr. AMF si autoriteti mbikëqyrës, në bashkëpunim me FSVC (Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare) ka hartuar Manualin e Mbikëqyrjes për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave (*AML Supervision Manual*). Manuali thekson rëndësinë e mbledhjes së informacionit dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe planifikimin e rregullt të inspektimeve dhe fushëveprimin e tyre, përpara ndërmarrjes së inspektimeve në vend. Objekti i këtij manuali është garantimi që siguroesit dhe bizneset të cilave u shërben të jenë në dijeni për rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me të cilin ata përballen si dhe garantimi që siguroesit veprojnë në përputhje me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.


Aktet nënligjore të mësipërme, të hartuara dhe miratuara pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", kanë si qëllim përafrimin e mëtejshëm me kuadrin ligjor evropian *Solvency I* dhe Direktivën 2009/138/KE datë 25 nëntorit 2009 mbi krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit (*Solvency II*).

Amendime

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 u bënë disa shtesa e ndryshime në 6 rregullore të tregut të sigurimeve.

Me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes sa më efektive të aktivitetit të tregut të sigurimeve dhe operatorëve të këtij tregu, AMF realizoi ndryshime në:

1. Rregulloren nr. 34, datë 28.05.2015 "Për raportimin e detyruar dhe periodik të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit", ndryshuar me vendim Bordi nr. 17, datë 26.02.2016 dhe me vendimin e Bordit nr. 77, datë 30.05.2016. Këto ndryshime u gjykuan të nevojshme për të bërë disa detajime të cilat do të shërbenin për një evidentim më të qartë të disa elementëve materialë të shpenzimeve, si dhe llogaritjen e treguesve të aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, si edhe për të adresuar nevojën për raportimin nga ana e shoqërive të mjaftueshmërisë së kapitalit të një grupi sigurimi sipas kërkesave të Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014;
2. Rregulloren nr. 48, date 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime" ndryshuar me vendim Bordi nr. 18, datë 26.02.2016. Ndryshimi u realizua me qëllim nxitjen e një bashkëpunimi efektiv ndërmjet bankave dhe shoqërive të sigurimit, bashkëpunim ky që është në funksion të një shërbimi cilësor për konsumatorin dhe për vetë zhvillimin e tregut të sigurimeve;
3. Rregulloren nr. 26, datë 23.02.2011 "Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg" ndryshuar me vendim Bordi nr. 41, datë 31.03.2016. Qëllimi ishte përshtatja e referencave ligjore me ligjin e sigurimeve;
4. Rregulloren nr. 137, datë 21.12.2015 "Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit, ndryshuar me vendim Bordi nr. 39, datë 31.03.2016. Sipas nenit 145, pika



2 të Ligjit 52/2014, Autoriteti duhet të parashikojë në rregullore kriteret që duhet të përmbushin personat të cilët administrojnë veprimtarinë e grupit kontrollues të sigurimit të përzier dhe grupit kontrollues të sigurimit, pikërisht rregullorja përmbushi këtë detyrim;

5. Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, ndryshuar me vendim Bordi nr. 88, datë 27.06.2016. Ndryshimet kryesore të kësaj rregulloreje lidhen me nevojën e shoqërisë së sigurimit për risigurim të mbështetur në vlerësimin e rreziqeve që parashikon të marrë në sigurim nëpërmjet përfshirjes së saj në bashkësigurime apo krijimit të grupimeve të veçantë për mbulimin e rreziqeve të mëdha;
6. Rregulloren nr. 110, datë 26.10.2015 “Për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 170, datë 31.10.2016. Këto ndryshime do të shërbejnë për të adresuar nevojën për publikimin nga ana e shoqërive të treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve. Ky ndryshim kërkohet për të plotësuar kuadrin rregullator të shoqërive të sigurimit si dhe synon garantimin e tregjeve më transparente si dhe përgjegjshmëri më të lartë nga ana e shoqërive të sigurimit.

9. MBIKËQYRJA E KUJDESSHME ME FOKUS RREZIKUN

9.1 Të dhëna Financiare për Shoqëritë e Sigurimit

Nga shqyrtimi i të dhënave të raportimit financiar të datës 31.12.2016 dhe të dhënave të pasqyruara në dy tabelat e mëposhtme konstatohet se:

Totali i aktivitetit është rritur me 16% ose rreth 4.4 miliardë lekë, nga 27.6 miliardë lekë në fund të vitit 2015, duke shënuar vlerën 32 miliardë lekë për vitin 2016.

Pesha që zënë investimet në bono thesari dhe obligacione ndaj totalit të aktivitetit është ulur, nga 11.5% në 31.12.2015, në 9.5% në 31.12.2016. Ndërkohë, pesha e zërit "Aksione dhe Pjesëmarrje" është rritur ndjeshëm, nga 11.2% në 17.3%, e ndikuar kryesisht nga blerja e shoqërisë Insig sh.a. nga shoqëria Eurosig sh.a. në muajin qershor 2016. Gjithashtu, edhe pesha për zërin "Debitorë" është rritur nga 7.9% në fund të vitit 2015, në 9.32% në fund të vitit 2016. Elementët e tjerë përbërës të aktiveve të shoqërive të sigurimit kanë ruajtur pak a shumë të njëjtën peshë për tre vitet e fundit, me ndonjë ndryshim jo domethënës.

Përsa i përket ndryshimeve nga periudha në periudhë të vlerave të tyre, vihet re se ndikimin më të lartë në rritjen e aktivitetit, e ka dhënë zëri "Aksionet dhe Investimet në Pjesëmarrje", i cili është rritur me 79%, ose me rreth 2.4 miliardë lekë, në krahasim me fundin e vitit 2015. Gjithashtu, zëri "Aktive të tjera" ka pësuar një rritje të konsiderueshme me 23%, ose rreth 1.7 miliardë lekë në krahasim me vitin 2015. Ndërkohë, zërat "Depozita" dhe "Bono Thesari" janë të vetmit zëra të aktivitetit që kanë pësuar një rënie në krahasim me një vit më parë, përkatësisht me 5.3%, ose 530 milionë lekë dhe 4.4%, ose 139 milionë lekë.

Në pasivin e bilancit, pesha që zënë "Detyrime të tjera" është rritur nga 12.28% në 31.12.2015, në 14.20% në 31.12.2016, ndërsa pesha e zërit "Provigjone teknike bruto" është ulur në 48.6%, nga 50.8% një vit më parë.

Ndikimin më të madh në rritjen e totalit të pasivit gjatë vitit 2016 e ka dhënë zëri "Kapitalet e veta" të shoqërive të sigurimit, i cili u rrit me rreth 1.7 miliardë lekë, ose 1.6% krahasuar me fundin e vitit 2015, si rrjedhojë e mbajtjes së fitimit të periudhës, rritjes së rezervave të rivlerësimit të kapitalit si dhe shtesës së kapitalit themeltar. Në vijim, pozitivisht në rritjen e pasivit ka ndikuar zëri "Provigjone teknike bruto", i cili në fund të vitit 2016 është rritur me rreth 1.6 miliardë lekë, ose 11.1% në krahasim me fundin e vitit 2015. Një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e pasivit në 31.12.2016 ka dhënë gjithashtu edhe rritja e zërit "Detyrime të tjera" me rreth 1.2 miliardë lekë, ose 34.1%, në krahasim me fundin e vitit 2015.



Tabela 26: Struktura dhe dinamika e aktivitetit dhe pasivitetit të tregut të sigurimeve⁹

<i>Emërtimi</i>	<i>31.12.2014</i>	<i>31.12.2015</i>	<i>31.12.2016</i>
<i>struktura (në %)</i>			
Depozita	36.26	36.00	29.39
Toka dhe ndërtime	7.93	7.21	6.76
Aksione dhe pjesëmarrje	10.92	11.18	17.26
Bono thesari dhe obligacione	10.85	11.52	9.50
Debitorë	8.88	7.93	9.32
Aktive të tjera	25.16	26.16	27.76
Totali i Aktivitetit	100.00	100.00	100.00
Provizionet teknike bruto	45.16	50.76	48.63
Detyrime të tjera	13.32	12.28	14.20
Kapitalet e veta	41.62	36.96	37.17
Totali i Pasivitetit	100.00	100.00	100.00
<i>Emërtimi</i>	<i>31.12.2014</i>	<i>31.12.2015</i>	<i>31.12.2016</i>
<i>dinamika (në %) viti i mëparshëm = 100</i>			
Depozita	107.20	110.43	94.67
Toka dhe ndërtime	95.82	101.08	108.84
Aksione dhe pjesëmarrje	100.84	131.82	179.02
Bono thesari dhe obligacione	163.63	118.19	95.64
Debitorë	97.21	99.35	136.27
Aktive të tjera	121.09	115.68	123.04
Totali i Aktivitetit	111.76	112.92	115.95
Provizionet teknike bruto	122.16	125.30	111.08
Detyrime të tjera	111.25	102.58	134.07
Kapitalet e veta	102.47	102.45	116.62
Totali i Pasivitetit	111.76	112.92	115.95

Shënim: ⁹ Pasqyrat e bilancit në këtë tabelë përfshijnë shoqëritë e sigurimeve të Jo-Jetës dhe Jetës. Raportimi i pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit bëhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe mbështetur në bazën ligjore të AMF-së.

Tabela 27: Të dhëna financiare të tregut të sigurimeve

(Në mln. lekë)

Periudha Ushtrimore	2012	2013	2014	2015	2016
Totali i Aktiveve	20,343	21,839	24,451	27,610	32,014
Jetë	3,207	3,788	4,009	3,857	3,287
Jo-Jetë	17,136	18,051	20,442	23,752	28,728
Totali i investimeve	13,692	14,082	15,721	18,996	21,404
Jetë	2,748	2,971	2,684	2,904	2,743
Jo-Jetë	11,334	12,750	15,175	16,092	18,660
Provigjonet teknike bruto	8,317	9,650	11,191	14,014	15,568
Jetë	1,175	1,522	1,529	1,605	1,690
Jo-Jetë	8,475	9,669	11,486	12,409	13,878
Totali i kapitalit	10,005	9,173	9,954	10,204	12,280
Jetë	1,899	2,195	1,988	1,782	1,503
Jo-Jetë	8,105	6,978	7,966	8,421	10,778
Totali i kapitalit të nënshkruar	8,247	8,652	8,152	8,190	10,300
Jetë	1,351	1,355	1,217	1,221	1,221
Jo-Jetë	7,301	6,797	7,339	6,969	9,079
Totali i investimeve të huaja	3,592	3,435	3,620	3,807	4,432
Jetë	458	442	468	496	567
Jo-Jetë	2,977	3,178	3,447	3,311	4,999

9.2 Qeverisja e Shoqërive të Sigurimit

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me dy nivele, ku këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori apo bordi i drejtorëve ushtron funksione administrimi.



Figura 36: Skema e strukturës aktuale të drejtimit të shoqërive të sigurimit




Tabela 28: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

(Në numër)

<i>Emërtimi</i>	
Shoqëri sigurimi	11
Aksionarë gjithsej	35
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>	
nën 10%	19
mbi 10% nën 20%	4
mbi 20% nën 33 %	2
mbi 33% nën 50%	1
mbi 50%	9
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës</i>	
Aksionarë të huaj	3
Aksionarë vendas	33
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:</i>	
Aksionarë individë	28
Aksionarë shoqëri	7

Figura 37: Të dhëna për aksionarët sipas pjesëmarrjes influencuese

(Në %)




Figura 38: Të dhëna për aksionarët sipas vendit të origjinës

(Në %)





Figura 39: Të dhëna për aksionarët sipas statusit

(Në %)






Tabela 29: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore

<i>Arsyeja e Ndryshimit të Statutit</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>
Statut i ri e ndryshime të tjera	2	2	2	6	6	2	6	4	4
Rritje kapitali	9	4	2	4	4	3	5	2	2
Ndryshim i strukturës aksionere	2	2	5	3	2	2	3	3	4

9.3 Raportet e Vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Në zbatim të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18, datë 28.04.2015 mbi: “Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2016 kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë. Ky raportim është i pari i këtij lloji si një risi e ligjit të ri të sigurimeve. Autoriteti ka analizuar raportet e vetëvlerësimit të shoqërive të sigurimit, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të:

- Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat e veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
- Proceseve, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit; dhe - kontrolleve, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

Në vijim të analizimit të raporteve të vetëvlerësimit, në kuadër të mbikëqyrjes dhe të monitorimit, u bë i mundur nga Autoriteti një vlerësim prospektiv i aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin në të ardhmen të këtij raporti.

9.4 Aktivitete në Koordinim me Autoritete të tjera Kombëtare dhe të Huaja

Inspektime të përbashkëta me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave


Në zbatim të Ligjit 52/2014 “Për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në kuadër të bashkëpunimit, gjatë vitit 2016, AMF dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave kanë kryer një inspektim të përbashkët në një nga shoqëritë e sigurimit të Jetës. Fokusi i inspektimit ishin verifikimet lidhur me respektimin e kuadrit ligjor në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

Nga ky inspektim nuk u konstatuan kundravajtje administrative nga ana e shoqërisë së sigurimit të Jetës.

Inspektim i përbashkët me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)

Me ftesë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, AMF' mori pjesë në një inspektim të përbashkët në një nga shoqëritë në Maqedoni, filial i një shoqërie sigurimi Shqiptare.

Ky inspektim u krye në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis të dy institucioneve që është në veprim prej vitit 2010. Një bashkëpunim i tillë ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë së shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë.



10. MBROJTJA E KONSUMATORIT

10.1 Veprime të Ndërmarra për Mbrojtjen e Konsumatorit

Tregu i Sigurimeve

AMF vazhdon të theksojë rëndësinë e mbrojtjes konsumatore, si instrument i rëndësishëm për të siguruar stabilitetin e financiar dhe zhvillimin e tregut financiar jobankar.

Instrumentet kryesore të Autoritetit në mbrojtje të konsumatorit:

- Krijimi dhe ndryshimi i legjislacionit të nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;
- Krijimi dhe përmirësimi i biznesit dhe kodeve të sjelljes për institucionet financiare;
- Zbatimi i programeve për të rritur njohuritë financiare dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, zhvillimin dhe përmirësimin e mjeteve të edukimit financiar;
- Zhvillimi dhe administrimi i veçantë web-faqe (www.amf.gov.al) projektuar për konsumatorët e sektorit financiar jobankar.

Në Autoritet funksionon njësi për mbrojtjen e konsumatorit/investitorit, e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave ligjore të konsumatorit në sistemin financiar nëpërmjet një sjelljeje të drejtë nga ofruesit e shërbimeve, ruajtjes së një mjedisi të përshtatshëm institucional dhe edukimit financiar.

Ushtrimi i funksioneve të kësaj njësie bazohet në:

- Kontrollin mbi transparencën dhe zhvillimin e drejtë të praktikave të shitjes;
- Kontrollin mbi veprimtarinë dhe transparencën e ndërmjetësve në sigurime;
- Kontrollin mbi afatet kohore dhe trajtimin ligjor në pagesën e dëmshpërblimit;
- Kontrollin mbi materialet me karakter publicitar;
- Ndhima për konsumatorët nëpërmjet Qendrës së Informacionit.

Transparenca me konsumatorin dhe publikimi i informacionit ka qenë fokus edhe gjatë vitit 2016, me qëllim përmirësimin e standardeve të marrëdhënieve me konsumatorin.

Për këtë qëllim Autoriteti i ka kushtuar rëndësi përfshirjes në ligj të dispozitave që lidhen me sjelljen e biznesit të shoqërive të sigurimit ndaj konsumatorit. Këto rregulla përfshijnë parashikime mbi dhënien e informacionit, duke siguruar që konsumatorët të marrin informacionin e duhur dhe të qartë. Masat e marra lidhur me publikimin e informacionit, kanë rezultuar efektive, pasi tashmë të gjithë subjektet financiare jobankare publikojnë në faqen e tyre online raportet vjetore.

Gjatë vitit 2016, si rezultat i masave të ndërmarra nga Autoriteti është rritur ndërgjegjësimi dhe angazhimi i shoqërive të sigurimit për çështjet e transparencës dhe publikimit të informacionit duke bërë publike raportet financiare dhe raportet e tjera në përputhje me kërkesat ligjore.

Nëpërmjet publikimit të informacionit nga ana e subjekteve të mbikëqyrura, konsumatori duhet të jetë në gjendje të zgjedhë produktin financiar që i përshtatet më mirë, pritjet e tyre, kërkesave dhe mbulimit të rrezikut. Dhënia e informacionit dhe transparenca, ka qenë në vëmendjen e Autoritetit dhe me ndërmjetësit e shërbimeve financiare si agjentët e licencuar,

brokerat, të cilët gjithashtu janë të detyruar të japin informacione për konfliktet e interesit që lidhen me ndërmjetësin nëpërmjet të cilit shitet produkti.

Shoqëritë e sigurimit duhet t'u japin konsumatorëve informacionet kryesore duke i bërë të njohur ata për përfitimet, risqet dhe kushtet themelore të produktit. Mënyra e dhënies së informacionit në kuadër të mbrojtjes konsumatore duhet të përfshijë gjithë aspektet që lidhen me produktin financiar. Informacionet e duhura duhet të jepen në të gjitha stadet e marrëdhënies me publikun.

Ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të sigurojnë informacione të qarta, konçize, të sakta, të sigurta, të krahasueshme, lehtësisht të aksesueshme dhe në kohën e duhur, me shkrim dhe me gojë mbi produktet dhe shërbimet financiare të ofruara, në mënyrë të veçantë mbi veçoritë kryesore të produkteve dhe (ku është e nevojshme) mbi shërbimet ose produktet e mundshme alternative, duke përfshirë ato më të thjeshtat që ato ofrojnë. Në parim, informacioni duhet të përfshijë çmimet, kostot, penalitetet, tarifat, risqet dhe modalitetet e përfundimit.

Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun

Komunikimi me publikun e gjerë dhe me grupet e veçanta të popullsisë, edhe gjatë vitit 2016 ishte në qendër të vëmendjes së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Synimi ka qenë rritja e transparencës dhe informacionit cilësor që AMF ofron për tregjet financiare nën mbikëqyrje. Për të realizuar këtë komunikim publik dhe për të pasqyruar aktivitetin, AMF ka përdorur disa forma, si bashkëpunim me median e shkruar dhe elektronike, intervista, artikuj, deklarata për shtyp, komunikimet elektronike nëpërmjet faqes online të AMF-së, takimet e drejtpërdrejta me grupe të veçanta të interesit dhe takime tematike për tregjet financiare nën mbikëqyrje.

Pasqyrimi në median tradicionale i informacioneve për aktivitetet e AMF-së dhe tregjet financiare ka vazhduar të rritet gradualisht nga viti në vit.

Tregu i Sigurimeve

Gjatë vitit 2016 tematikat më të shpeshta të pasqyruara në media lidhen me tregun e sigurimeve dhe më specifikisht me sigurimet motorike. Luhajtjet e tarifave të sigurimit të detyrueshëm motorik, zhvillimet në procesin e tarifimit me bazë rreziku, ecuria dhe mundësitë që ofron zbatimi i sistemit Bonus-Malus, etj. kanë qenë disa nga temat që kanë zënë më tepër vend në media. Për të pasur një transparencë më të madhe, në faqen e saj online të AMF-së janë prezantuar edhe detajet teknike dhe përlllogaritëse lidhur me primet e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Përgjatë vitit 2016 mediat i kushtuan vëmendje edhe disa grupeve të tjera të sigurimeve sidomos atyre të lidhura me pronën dhe sigurimin nga katastrofat natyrore. Nëpërmjet shprehjes publike të opinioneve, drejtues nga shoqëritë e lidhën nevojën e zhvillimit dhe shtrirjes së mëtejshme të këtyre sigurimeve në vend edhe me ngjarje e vështirësi të mëdha natyrore, me të cilat po përballëj vendi e më gjerë rajoni ynë.

Zhvillimin e tregut të sigurimeve, AMF e ka mbështetur edhe me realizmin e projekteve dhe bashkëpunimeve me partnerë të huaj. Rezultatet e këtyre bashkëpunimeve janë prezantuar edhe në faqen online të AMF-së. Kështu në faqen online janë prezantuar seminarët lidhur me sigurimin e përgjegjësisë profesionale të zhvilluar në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë, trajnimet mbi aspekte teknike të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, zhvilluar në kuadër të projektit të reformës në tregun e sigurimeve, në bashkëpunim me Bankën Botërore, si edhe bashkëpunimet me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA).




10.1.1 Trajtimi i Ankesave

Autoriteti nëpërmjet Njesisë për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Investitorëve ka shqyrtuar dhe verifikuar ankesat e ardhura nga konsumatorët, duke kërkuar nga subjektet nën mbikëqyrje korrigjimin apo rishqyrtimin e çështjeve të ankimuar, apo duke i shpjeguar konsumatorit rrugën ligjore në mënyrë sa më të qartë për të. Procedurat e AMF-së për trajtimin e ankesave të konsumatorëve fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimet ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontaktet e vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale të çështjes së ankimuar, etj.

Gjatë vitit 2016, në Autoritet kanë ardhur 49 ankesa nga persona fizikë, ente shtetërore apo subjekte juridikë. Nga këto ankesa 35 prej tyre lidhen me pagesën nga Fondi i Kompensimit, ndërsa ankesat e tjera lidhen kryesisht me kontratat e garancive, sigurimin e Jetës së debitorit apo rishikimin e masës së dëmshpërblimit për sigurimin e detyrueshëm motorik. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për praktika të Fondit të Kompensimit në Autoritet janë depozituar në mënyrë të vazhdueshme kërkesa nga përmbaruesit gjyqësor. Për këtë qëllim dhe në funksion të mbrojtjes konsumatore, Autoriteti ka investuar në marrjen e vendimeve me qëllim pagesat e dëmeve objekt i këtij fondi për ngjarjet e sigurimit 2002-2006.

Figura 40: Ankesat e trajtuara nga AMF për periudhën 2007-2016

(Në numër)



Njësia për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Investitorëve, nëpërmjet Qendrës së Informacionit, ka ndihmuar konsumatorin për dhënie informacioni duke iu përgjigjur kërkesave për konfirmimin e kontratave të sigurimit.

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar rreth 168 kërkesa të tilla, për të cilat Autoriteti ka informuar konsumatorin brenda afateve kohore shumë të shkurtra.

Mjet tepër i rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen konsumatore është dhe monitorimi nga Autoriteti i transparencës së subjekteve, element tepër i rëndësishëm që lidhet me zgjedhjen reale nga konsumatori, mbi bazën e një informacioni të saktë dhe të besueshëm.

Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” i mundëson konsumatorit informacionin e nevojshëm dhe transparencën e vazhdueshme, me synimin që të krijojë besimin dhe sigurinë për të bërë zgjedhjen e duhur.

Gjatë vitit 2016, rëndësi të veçantë Autoriteti i ka kushtuar mbikëqyrjes së çdo informacioni promociional që ofrohet nga shoqëritë e sigurimit, me qëllim që ky informacion të mos jetë çorientues dhe dizinformues për konsumatorin.

Autoriteti ka mbështetur ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, edhe duke marrë rolin e ndërmjetësuesit, në përputhje me rregullat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, veçanërisht në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve për shkak të paqartësive të krijuara nga komunikimi ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit, për informacione apo interpretime të kushteve të kontratës.

Autoriteti përdor një sërë mekanizmash komunikimi dhe informimi të konsumatorit, pasurimi në vazhdimësi i të cilave inkurajon dhe rrit besimin e konsumatorit në rolin e tij.

Mekanizmat e AMF-së për realizimin e transparencës, komunikimit efektiv me publikun dhe edukimin financiar

- Sistemi telefonik i ndihmës së konsumatorëve. Ky sistem përfshin numrin e komunikimi me telefoninë fikse, (355 4 2257 557) numrin e telefonit jeshil pa pagese për konsumatorin (0800 6969), sistemin e sms falas për kontaktet (355 694060671) dhe adresën elektronike të e-mail (konsumatori@amf.gov.al);
- Faqja online e AMF-së www.amf.gov.al pasqyron në mënyrë të vazhdueshme informacionin lidhur me bazën ligjore të përditësuar për tregjet nën mbikëqyrje, njoftimet për veprimtarinë vendimmarrëse të Bordit të Autoritetit;
- Faqja online pasqyron informacion për subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura duke dhënë formën e organizmit dhe stafin drejtues ekzekutiv;
- Në rubrika të veçantë në faqen online pasqyrohen raporte periodike statistikore, informacione edukuese për konsumatorin, si edhe njoftime për zhvillimet e reja në vendet e rajonit për këto tregje, nëpërmjet publikimeve të përmuajshme të lajmeve.



10.2 Mbiqyrja e Ndërmjetësve në Sigurime

Në zbatim të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Autoriteti mbiqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime, me qëllim kontrollin dhe vlerësimin e përmbushjes prej tyre të rregullave të përcaktuara në aktet e Autoritetit, të legjislacionit të zbatueshëm në fushën e sigurimeve si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Mbiqyrja e ndërmjetësve në sigurime ushtrohet nga Autoriteti nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raporteve dhe njoftimeve të depozituara sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti, kontrollit në vend të veprimtarisë, si dhe vendosjes së masave mbiqyrëse në përputhje me këtë legjislacion në fuqi.

Zhvillime mbi aktivitetin e brokerimit për periudhën janar-dhjetor 2016

Shoqëritë e brokerimit, me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 2, datë 25.01.2016 "Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raportimeve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime" kanë raportuar veprimtarinë e tyre duke depozituar në Autoritet të dhëna financiare dhe statistikore.

Për periudhën janar-dhjetor 2016, nga raportimet financiare të shoqërive të brokerimit, rezulton tabela e mëposhtme:

Tabela 30: Të dhëna financiare të shoqërive të brokerimit

(Në lekë)

Total i Aktiveve	514,322,543
Total i Investimeve	5,685,186
Total Kapitali dhe Rezervat	97,045,692
Total Kapitali i Nënshkruar	57,350,000
Total i Detyrimeve	70,891,986
Fitim/Humbja e vitit	247,910,387

Primet e shkruara bruto të sigurimit të ndërmjetësuar nga shoqëritë e brokerimit për periudhën janar-dhjetor 2016 janë në shumën 7,452,282,263 lekë. Krahasuar me totalin e primeve bruto të shkruara të tregut të sigurimeve, për të njëjtën periudhë, treguesi i ndërmjetësimit nëpërmjet brokerave rezulton në masën 48.51%. Për vitin 2016 numri i kontratave të sigurimit të ndërmjetësuar nga shoqëritë e brokerimit zënë rreth 39.84% të kontratave të sigurimit të të gjithë tregut. Në totalin e primeve të shkruara bruto të brokeruara, 99.78% e zë sigurimi i Jo-Jetës dhe 0.22% sigurimi i Jetës. Veprimtaria e brokerimit të produkteve të sigurimit të Jo-Jetës është e orientuar nga sigurimi i detyrueshëm motorik.

Figura 41: Primet e shkruara bruto të brokeruara – sipas grupeve të sigurimit të Jo-Jetës

(Në %)






Figura 42: Primet e shkruara bruto (Jetë, Jo-Jetë) të brokeruara sipas shoqërive të sigurimit

(Në %)





11. EDUKIMI PËR SIGURIMET- QENDRA E EDUKIMIT

Ligji 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” mundësoi krijimin e Qendrës së Edukimit si pjesë e strukturës organizative të AMF-së, për të organizuar trajnime për formim profesional (kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim) me synim që të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve profesionale të drejtuesve dhe profesionistëve që operojnë në tregun e sigurimeve si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të AMF-së, duke iu përgjigjur nevojave të tyre për trajnime.

Në zbatim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Programin e Trajnimit Afatgjatë të Kualifikimit Profesional për Aktuar”, të nënshkruar në vitin 2015 me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër, si dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve, Qendra e Edukimit gjatë vitit 2016 ka zhvilluar nëntë module trajnimi në gjuhën angleze, të programit afatgjatë të kualifikimit profesional për aktuar, i cili përfundoi në muajin prill të vitit 2017. Programi mësimor i këtij trajnimi është në përputhje me programin e Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve dhe është i bazuar në praktikat më të mira të Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve në Londër. Nga ekspertiza e anëtarëve të Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve në Londër kanë përfituar trajnim për rritje profesionale edhe profesionistët e licencuar si aktuarë dhe gjithashtu anëtarë të Shoqatës Shqiptare të Aktuarëve.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve të AMF-së dhe duke iu përgjigjur nevojave të tyre për trajnime, gjatë vitit 2016 Qendra e Edukimit ka organizuar seminarin me temë “Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale” dhe trajnimin dy javor “Menaxhimi i rrezikut në sigurime” duke përdorur ekspertizë nga autoritete mbikëqyrëse të rajonit dhe më gjerë, me përvojë shumë vjeçare në fushën e sigurimeve. Gjithashtu Qendra e Edukimit, ka filluar punën gjatë vitit 2016, për të zhvilluar kurrikula të përshtatshme për trajnimin e punonjësve të rinj në AMF.

Gjatë vitit 2016, Qendra e Edukimit e AMF-së, ka vijuar me organizimin e trajnimeve për formim profesional për profesionistët që ushtrojnë veprimtarinë si broker dhe vlerësues dëmsh në sigurime, si dhe trajnime për rritje profesionale për drejtues të lartë në tregun e sigurimeve, duke kontribuar kështu në zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët. Qendra e Edukimit gjithashtu ka krijuar dhe administron regjistrin e të dhënave për formim profesional, i cili përmban të dhëna personale dhe profesionale për të gjithë individët e trajnuar. Informacioni për veprimtarinë e Qendrës së Edukimit për vitin 2016 dhe programet trajnuese gjendet edhe në faqen zyrtare online të AMF-së.

Tabela 31: Profesionistë të trajnuar në formim profesional, organizuar nga Qendra e Edukimit gjatë vitit 2016

(Në numër)

<i>Profesionistët</i>	<i>Kualifikim profesional</i>	<i>Edukim në vazhdim</i>
Aktuar	9	10
Vlerësues Dëmsh	15	30
Broker	20	11
Pjesëmarrës të tjerë		16

12. BYROJA SHOIPTARE E SIGURIMIT

Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) është person juridik, në përbërje të të cilit është çdo sigurues i licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm motorik.

Roli i Byrosë gjatë veprimtarisë së saj përmbledhet në:

- Përfaqësimin e anëtarëve në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të fushës së sigurimeve, të detyrueshme në sektorin e transportit;
- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore lidhur me sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit;
- Pajisja e anëtarëve me Certifikatën Ndërkombëtare të Sigurimit (Kartoni Jeshil), sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli i Byrove;
- Ratifikimin e marrëveshjeve me byrotë homologe;
- Kryerjen e funksioneve të byrosë trajtuese, paguese dhe të shërbimit, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove;
- Administrimin e Fondit të Kompensimit dhe Fondit të Kartonit Jeshil.

Objekt i veprimtarisë së Byrosë është përmbushja e funksioneve, detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, “Rregullorja e brendshme e Këshillit të Byrove” dhe Statuti i saj.


Byroja është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të dispozitave të përcaktuara në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, cilëson veprimtarinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, e ndër të tjera edhe zbatimin dhe garantimin e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil.

Në tetor të vitit 2013, Këshilli i Byrove ka marrë vendim për monitorim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Këshilli i Byrove ka kërkuar plotësimin e Kriterëve Financiare që i adresohen Byrosë Shqiptare të Sigurimit tashmë në monitorim, kritere të cilat janë plotësuar brenda muajit dhjetor 2013.

Në qershor të vitit 2016, Komiteti i Menaxhimit të Këshillit të Byrove, ka vendosur ritjen e garancisë bankare të Kartonit Jeshil, në shumën totale prej 2,750,000 euro. Shkaqet e ritjes së kësaj garancie janë vonesat në pagesat e thirrjeve të garancive, për të cilat ka përfunduar pagesa në mars 2016, si dhe problemet në stabilitetin e menaxhimit të BSHS-së. Gjatë vitit 2016, rezultojnë të raportuara katër thirrje garancie që lidhen me dy dëme Karton Jeshil, si dhe interesat për njërin nga këto dëme.

Ndryshimet e ligjit të sigurimit të detyrueshëm kanë parashikuar përmirësimin e organeve drejtuese të BSHS-së, me qëllim shmangien në të ardhmen të problematikave që lidhen me menaxhimin e këtij subjekti.



12.1 Fondi i Kompensimit

Një vëmendje të veçantë Autoriteti i ka kushtuar mbikëqyrjes së BSHS-së, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorit duke ndjekur me përparësi pagesat e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit. Burimet e financimit të Fondit të Kompensimit parashikohen në nenin 45 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009.

Fondi i Kompensimit

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagesën e dëmeve pasurore dhe jopasurore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, në rastet e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti të pasiguar, të paidentifikuar dhe në rastet e mbylljes apo falimentimit të një shoqërie të sigurimit. Ai krijohet nga:

- Kontributi i përvitshëm i shoqërive të sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimin e detyrueshëm motorik;
- Arkëtime nga rimbursimi i shumave nga personat përgjegjës për dëmet të Byroja;
- Gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit të cilët nuk kanë lidhur kontratat e sigurimit të detyrueshëm;
- Burime të tjera të cilat nuk ndalohen me ligj.

Në vazhdim të angazhimit për përmbushjen e detyrimeve, sipas rekomandimeve bazë të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, AMF në mars të vitit 2016, ka miratuar fondin e kompensimit të ndarë përkatësisht:

- Fond për shlyerjen e detyrimeve për dëme pezull deri më 31.12.2013, në vlerën 468,126,732 lekë;
- Fond për pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, duke filluar minimalisht nga vlera 116,310,254 lekë.

Bordi i Autoritetit çdo muaj është informuar lidhur me situatën e pagesave të praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit. Autoriteti ka monitoruar nivelin e pagesave, duke përcjellë pranë çdo shoqërie kërkesën për vijimin me ritme të shpejta të këtij procesi.

Gjatë vitit 2016, rezulton se pagesat nga shoqëritë e sigurimit, për dëmet pezull objekt i Fondit të Kompensimit për ngjarjet deri më 31.12.2013, janë realizuar në masën 90%, ndërsa pagesat e dëmeve me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim, janë realizuar në masën 79%. Autoriteti do të inspektojë gjatë vitit në vazhdim arsyet e vonës në trajtimin dhe përfundimin e pagesës, për praktikën me ngjarje sigurimi nga data 1 janar 2014 e në vazhdim.

Shkaku i mosplotësisht të detyrimit të përcaktuar në vendim, për dëmet pezull për ngjarjet deri më 31.12.2013, është se nga dy shoqëri sigurimi, është ankimuar në gjykatë ndarja e vlerës së detyrimit për çdo shoqëri sigurimi.

Për ngjarjet e sigurimit më të hershme, vitet 2002-2006, Autoriteti ka kryer verifikim në vend pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me qëllim shlyerjen e detyrimeve që i përkasin Fondit të Kompensimit.

Autoriteti referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar, me qëllim shlyerjen e gjithë detyrimeve që i përkasin ngjarjeve të sigurimit 2002-2006, si dhe në zbatim të vendimit të Bordit nr. 35, datë 24.03.2016 "Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016", ka marrë Vendimin nr. 185, datë 31.10.2016, "Për pagesat e praktikave Fond Kompensimi".

Sipas këtij vendimi Byroja Shqiptare e Sigurimit ka autorizuar shoqëritë e sigurimit për përfundimin e pagesës së praktikave për ngjarjet 2002-2006, (për praktikat për të cilat është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nga Zyrat Përmbarimore, dhe për praktikat administrative të miratuara por të papaguara).

Autoriteti, me qëllim zbatimin e këtij vendimi, ka pasur komunikime të vazhdueshme me shoqëritë e sigurimit si dhe më datë 22 dhjetor 2016, ka zhvilluar takim me drejtorët e shoqërive të sigurimit.

Ndër masat e marra me qëllim ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me kërkesat e ligjit, gjatë vitit 2016, Autoriteti ka marrë vendime lidhur me detyrimin e BSHS-së për auditimin e veprimtarisë së saj ndër vite, si dhe për përzgjedhjen e drejtuesit të saj sipas kërkesave të ligjit.

Lidhur me auditimin e veprimtarisë së BSHS-së, është kërkuar që në objektin e auditimit të shoqërisë audituese e cila do të auditojë pasqyrat financiare të vitit 2016, të shtohet dhe auditimi i veprimtarisë së BSHS-së që lidhet me gjithë detyrimet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.


Vendimet e Autoritetit të marra gjatë vitit 2016


- Vendim nr. 35, datë 24.03.2016, "Mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2016".
- Vendim nr. 119, datë 19.07.2016, "Për marrjen e masave lidhur me përzgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv të BSHS-së".
- Vendim nr. 158, datë 03.10.2016, "Mbi auditimin e veprimtarisë së Byrosë Shqiptare të Sigurimit".
- Vendim nr. 185, datë 31.10.2016, "Për pagesat e praktikave Fond Kompensimi".
- Vendim nr. 198 dhe 199, datë 22.12.2016, që lidhen përkatësisht me shfuqizimin e Vendimit nr. 119 dhe ndryshimin e Vendimit nr. 158.

Më poshtë paraqitet Fondi i Kompensimit i miratuar nga Autoriteti për vitet 2010-2016.

Figura 43: Fondi i Kompensimit, 2010-2016

(Në mln. lekë)





13. INSPEKTIMET

Shoqëritë e Sigurimit

Inspektime të plota me Fokus Rrezikun

Gjatë 2016, Autoriteti i Mbikëqyrjes kreu inspektimin e plotë në vend në tre shoqëri sigurimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun. Inspektimi u përqendrua në strukturimin e procedurave të inspektimit, si dhe hartimin e planit të intervistave me të gjitha nivelet e menaxhimit të shoqërive. Gjatë inspektimeve u diskutua lidhur me rreziqet e pranishme në shoqëri sipas aktiviteteve të biznesit, si edhe administrimin e tyre nga menaxhimi dhe drejtuesit e lartë të shoqërive.

Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet në përgjegjësinë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë së sigurimit, duke ju përmbajtur politikave dhe praktikave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, për të zbutur rreziqet e konsiderueshme që shoqërojnë këtë biznes.

Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë e sigurimeve, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri sigurimi, brenda vitit 2017.

Inspektime Tematike

Gjatë vitit 2016 janë kryer tre inspektime tematike në shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, si dhe një inspektim tematik pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit me fokus Fondin e Kompensimit. Gjithashtu, pranë të gjitha shoqërive të sigurimit është kryer dhe një inspektim i palajmëruar lidhur me tarifat e MTPL.

14. MASAT MBIKËQYRËSE DHE ADMINISTRATIVE

Marja e masave administrative nga ana e Autoritetit ka qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit. Në këtë mënyrë synohet parandalimi apo ndërprerja e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit, mbrojtja e konsumatorit dhe forcimi i besimit të tij në rolin e AMF-së.

Masat mbikëqyrëse, korrigjuese e sanksionuese janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke reflektuar konkluzionet nga ushtrimi i mbikëqyrjes. Në vendosjen e masave administrative janë respektuar parimet e efektshmërisë, vazhdimësisë, proporcionalitetit me rrethanën apo veprimin që përbën shkelje dhe ndikimit mbi interesat e të siguruarve.

Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes, identifikimit të problematikave duke ndërmarrë masa përkatëse, me qëllim zbatimin e tyre në praktikën e përditshme. Marrja e masave është bazuar në inspektimet në vend, kontrollin mbi dokumente, verifikim të informacionit, apo në shqyrtim të ankesave të depozituara. Nëpërmjet masave mbikëqyrëse, Autoriteti ka diktuar ndërmarrjen e hapave të caktuar për zgjidhjen e problematikave të konstatuara brenda një afati të përshtatshëm kohor. Vendimet e detajuara sipas llojit të masave administrative paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela 32: Masat mbikëqyrëse të marra nga AMF në tregun e sigurimeve për vitin 2016

(Në numër)

<i>Urdhër për eliminim shkëlqeje</i>	<i>Plan masash për eliminim të shkëlqejeve</i>	<i>Rekomandim për rritje kapitali</i>	<i>Ndalim pagese të dividendit</i>	<i>Paralajmërim për shkarkim të anëtarëve të organeve drejtuese</i>	<i>Ndalim të dhënies së huave</i>	<i>Ndalim të transaksioneve me palë të lidhura</i>	<i>Sanksion me gjobë ndaj shoqërive</i>	<i>Sanksion me gjobë ndaj personave përgjegjës</i>
5	4	2	1	2	3	1	13	4

Në gjithë procesin e marrjes së masave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka mbajtur një qëndrim objektiv ndaj të gjitha subjekteve të mbikëqyrura. Konstatimet e gjetura përfshijnë shkëlqe të dispozitave të ligjit në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, rregullat e menaxhimit të rrezikut, hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, ndryshimin e primit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, etj.

Për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve, Bordi i AMF-së, gjatë vitit 2016, ka marrë gjithsej 19 vendime për masa administrative si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiare ashtu edhe nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti. Gjatë vitit 2016, janë ankimuar në Gjykatë dhe vijon gjykimi për 7 prej vendimeve të marra nga Bordi i AMF-së.

Tabela 33: Masat sanksion me gjobë të marra nga AMF në tregun e sigurimeve për vitin 2016

(Në numër)

<i>Sanksion me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit</i>	<i>Sanksion me gjobë ndaj personave përgjegjës</i>
13	4

Gjatë vitit 2016, janë arkëtuar në llogarinë e Autoritetit gjokat në vlerën totale 7 milionë lekë, e cila lidhet me vendimet e marra gjatë këtij viti.

AMF ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Gjatë vitit 2016, Autoriteti ka ndjekur 16 procese gjyqësore.



Tabela 34: Proceset gjyqësore të ndjekura nga AMF për vitin 2016

(Në numër)

<i>Totali</i>	<i>Të përfunduara</i>	<i>Në proces</i>
16	4	12

Gjatë vitit 2016, ka përfunduar gjykimi për katër çështje gjyqësore. Një nga çështjet lidhet me ankimin e vendimit të Bordit të vitit 2010, për ndalim transaksionesh me palë të lidhura. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë pranuar ankimin, duke shfuqizuar vendimet e Bordit të AMF-së.

Për një nga çështjet gjykimi ka filluar në vitin 2011 dhe lidhet me masë të sigurimit të padisë për pezullim të zbatimit të aktit administrativ heqje licence për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Kjo çështje është fituar nga AMF.

Objekti i padisë për një çështje lidhet me ankimin e vendimit të Bordit të vitit 2016 për sanksion me gjobë. Gjykimi për këtë çështje ka përfunduar me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe është fituar nga AMF.

Çështjet gjyqësore për të cilat vijon shqyrtimi gjyqësor i përkasin periudhave si më poshtë:

Për një çështje ka filluar shqyrtimi gjyqësor në vitin 2008. Ajo është ndjekur dhe fituar nga AMF në të tre shkallët e gjykimit por aktualisht pritet të gjykohet kërkesa për rishikim të vendimit të Gjykatës së Lartë.

Dy prej çështjeve të cilat pritet të gjykohen në Gjykatë të Lartë lidhen me vendime të Bordit të AMF të vitit 2012 për heqje licence për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Një tjetër çështje lidhet me kërkesën për dëmshpërblim si pasojë e heqjes së licencës për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime.

Dy çështje lidhen me vendimet e Bordit të vitit 2014 dhe 2016 për çështjen e Fondit të Kompensimit përkatësisht për vitet 2014 dhe 2016.

Pesë prej çështjeve për të cilat vijon shqyrtimi gjyqësor lidhen me vendime të Bordit të AMF-së të vitit 2016, me të cilat janë vendosur masa administrative sanksion me gjobë.

Kapitulli 3

TREGU I PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

15. STRUKTURA E TREGUT

Gjatë vitit 2016, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 3 fonde pensioni vullnetar të administruar nga tre shoqëri administruese, përkatësisht “Raiffeisen Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Raiffeisen”, “SIGAL–Life Uniqa Group Austria” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “Sigal”, si dhe “Credins Invest” sh.a., që administron Fondin e Pensionit Vullnetar “SiCRED Pensions”.

Skema e pensioneve vullnetare u krijua mbështetur në Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009. Miratimi i kuadrit ligjor e rregullativ për tregun e fondeve të pensionit vullnetar ka krijuar hapësirat e nevojshme për lehtësimin në plan afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre.


Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të pensionit vullnetar në fund të vitit 2016 është 17,317 anëtarë, duke shënuar rritje prej 4,758 anëtarë, ose 37.89% krahasuar me fundin e vitit 2015. Në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm pasqyrohet numri i anëtarëve dhe vlera e aseteve neto detajuar sipas fondeve të pensionit vullnetar.

Tabela 35: Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar (31.12.'16)

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
Sigal	5,794	672.69
Raiffeisen	2,653	412.21
SiCRED Pensions	8,870	233.84
Total	17,317	1,318.74

Figura 44: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar, 31.12.2016

(Në %)







Figura 45: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar
31.12.2016 (Në %)



16. MBIKËQYRJA DHE ANALIZA E RREZIQEVE TË TREGUT

Gjatë vitit 2016, u hartua dhe filloi zbatimi i një metodologjie të re mbikëqyrëse, ajo me bazë rreziku për fondet e pensioneve vullnetare. Nëpërmjet kësaj metodologjie evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm.

Ndjekja e kësaj metodologjie bën të mundur ndërtimin e matricës së rrezikut të pranishëm, e cila tregon shpërndarjen e rreziqeve të sistemit të kategorizuar nga dy dimensione: probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes që shkakton problemin dhe ndikimi i materializimit të kësaj ngjarje. Kjo matricë vjen në ndihmë për të ndërtuar matricën e rrezikut të mbetur, e cila është specifike për secilin prej fondeve të pensionit vullnetar. Nëpërmjet këtyre matricave bëhet i mundur vlerësimi i përpjekjeve që duhen bërë në monitorimin e përputhshmërisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit me praktikën më të mira dhe për të siguruar përmirësimin e situatës. Në këtë mënyrë matrica e rrezikut të mbetur shërben për të orientuar strategjitë e mbikëqyrjes së fondeve të pensionit vullnetar nga AMF drejt subjekteve që paraqesin rreziqe më të mëdha.

Kjo metodologji, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij gjatë këtij viti me miratimin e Metodologjisë së re mbikëqyrëse. Gjatë mbledhjes së Komitetit të Rrezikut u prezantuan matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem, u ra dakord për vlerësimin e rreziqeve në sistem, si dhe u diskutua për rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objekt zbutjen e rreziqeve, miratoi planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

Në kuadrin e kësaj metodologjie të re mbikëqyrëse me bazë rreziku, gjatë vitit 2016, AMF me asistencën teknike të konsulentëve të Bankës Botërore kreu inspektim pilot pranë një prej shoqërive që administrojnë një fond pensioni. Inspektimi me metodologjinë me bazë rreziku u mbështet në parimet e qeverisjes së mirë të shoqërisë dhe të menaxhimit të rrezikut si elementë kryesorë të kësaj metodologjie të re mbikëqyrëse. Objekti i këtij inspektimi ishte

vlerësimi i nivelit të rrezikut në drejtim të qeverisjes së shoqërisë, strategjisë së investimit si dhe kontrollit të aseteve nga ana e shoqërisë. Qasja e ndjekur gjatë këtij inspektimi ishte shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar paraprakisht nga shoqëria, zhvillimi i intervistave me punonjës që mbajnë pozicione kryesore në shoqëri si dhe verifikimi ose testimi në vend në lidhje me çështje të ndryshme. Pas përfundimit të inspektimit, mbi bazën e gjetjeve të identifikuar, u vlerësua përputhshmëria e aktivitetit të shoqërisë me parimet e qeverisjes së mirë dhe niveli i rrezikut të planifikimit strategjik të investimeve dhe të sigurisë së aseteve. Nga gjetjet e këtij inspektimi AMF ka lënë rekomandimet përkatëse, për të cilat shoqëria administruese ka punuar për t'i përmbushur.

Ky proces do të zbatohet për të gjitha shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, duke krijuar kështu një bazë të dhënash në nivel tregu, e cila ndihmon në vlerësimin e rrezikut të secilës shoqëri administruese.

Gjithashtu në fund të vitit 2016 nisi puna për zbatimin e programit të inspektimit në vend me bazë rreziku pranë njësisë së depozitarit të dy prej fondeve të pensionit, punë e cila do të vijojë edhe gjatë vitit 2017.

17. POZICIONI FINANCIAR

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që me fillimin e aktivitetit të tij, ka pasur tendencë në rritje përsa i përket aseteve që menaxhon si dhe numrit të kontribuesve. Megjithatë, vlera neto e aseteve të këtij tregu është ende në masë të papërfillshme kundrejt PPB-së në Shqipëri. Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2016 është 1,318.74 milionë lekë me një numër prej 17,317 anëtarë.

Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2016 kanë pësuar një rritje me 41.99%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 37.89% krahasuar me fundin e vitit 2015.

Ecuria e vlerës neto të aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar për tre vitet e fundit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 36: Asetet neto të fondeve të pensionit vullnetar

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)			Ndryshimi (në %)	
	2014	2015	2016	31.12.'14-31.12.'15	31.12.'15-31.12.'16
Asetet neto të tregut të FP	629.14	928.74	1,318.74	47.62%	41.99%

Asetet e këtij tregu janë investuar në obligacione të qeverisë shqiptare. Në 31.12.2016 investimet në obligacione të RSH-së përbëjnë 94.71% të totalit të aseteve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 48.90% krahasuar me fundvitin 2015. Struktura e aseteve të këtij tregu gjatë tre viteve të fundit dhe ndryshimi i kësaj strukture jepet në tabelat e mëposhtme:



Tabela 37: Struktura e asetëve të tregut të fondëve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		
	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'16
Periudha			
Asetet neto të fondëve të pensionit	629.14	928.74	1,318.74
Totali i asetëve të fondëve	631.96	930.40	1,325.36
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	39.60	69.07	46.31
Obligacione Thesari të RSH	581.71	843.02	1,255.29
Depozita bankare	0.00	0.00	0.00
Asete të tjera ¹⁰	10.65	18.31	23.76
Totali i Detyrimeve të Fondëve	2.82	1.66	6.62

Tabela 38: Ndryshimi i strukturës së asetëve të tregut të fondëve të pensionit vullnetar më 31.12.2016 krahasuar me 31.12.2015

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.2015	31.12.2016		31.12.'15	31.12.'16
Periudha					
Asetet neto të fondëve të pensionit	928.74	1,318.74	41.99		
Totali i asetëve të fondëve	930.40	1,325.36	42.45	100	100
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-	-
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	69.07	46.31	(32.95)	7.42	3.49
Obligacione Thesari të RSH	843.02	1,255.29	48.90	90.61	94.71
Depozita bankare	0.00	0.00	-	0.00	0.00
Asete të tjera	18.31	23.76	29.77	1.97	1.79
Totali i Detyrimeve të Fondëve	1.66	6.62	298.80	0.18	0.50

Shënim: ¹⁰ Përfaqëson interesin e përlogaritur të investimeve në obligacione të RSH-së


Gjatë vitit 2016, totali i investimeve të fondeve të pensionit ka qenë 1,255.29 milionë lekë dhe këto investime konsistojnë në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë (94.71% ndaj totalit të aseteve). Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 48.90% krahasuar me 31.12.2015. Ecuria e investimeve gjatë tre viteve të fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 39: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar (Në mln. lekë)

Periudha	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'16
Totali i investimeve të FP	581.71	843.02	1,255.29

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Kështu kjo politikë e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 3, 5, 7 dhe 10 vjeçare siç mund të shihet dhe në grafikun më poshtë:

Figura 46: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar, 31.12.2016 (Në %)



Mbështetur në të dhënat e tregut të pasqyruara në tabelat e mësipërme, ndonëse ky treg ka një dinamikë pozitive, fokusi i punës së Autoritetit gjatë vitit 2016 e në vijim ka qenë forcimi dhe zhvillimi i këtij tregu.

18. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, për ta përshtatur me zhvillimet e fundit në fushën e pensioneve vullnetare, me direktivat e BE-së, si dhe në zbatim të rekomandimeve të progres raporteve të BE-së, finalizoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”. Përmirësimi i kuadrit ligjor në tregun e pensioneve vullnetare lindi edhe si nevojë e përmbushjes së angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015-2020, të miratuar me VKM nr. 404, datë 13.05.2015.



Aktualisht draftligji është përcjellë nga Ministria e Financave, pranë Këshillit të Ministrave për miratim.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji synojnë të sjellin përparësi në tregun e pensioneve vullnetare si dhe të zgjidhin disa problematika të hasura gjatë zbatimit të tij. Risitë e projektligjit konsistojnë në:

- Krijimin e kushteve të përshtatshme për zbatimin e mbikëqyrjes me fokus riskun, objektivi i së cilës është që problemet financiare të parandalohen përpara se të ndodhin, në vend që të punohet për zgjidhjen e tyre pasi ato të kenë ndodhur;
- Rritjen e transparencës dhe informimit të konsumatorit nga ana e shoqërive. Detyrimi për informim fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë të kontratës;
- Futjen e konceptit të “fondit me model të gatshëm”, që nënkupton fondin e pensionit të zgjedhur nga shoqëria administruese/ofruesi i autorizuar në fushën e pensioneve, me kushte të përcaktuara nga kjo e fundit, që u ofrohet anëtarëve në rastet kur këta nuk kanë zgjedhur vetë fondin(et) e pensionit ku do të kontribuojnë;
- Parashikimi i detyrimit të shoqërisë administruese të krijojë struktura dhe të parashikojë procedura për trajtimin e ankesave;
- Rregullimi i përgjegjësisë së depozitarit dhe funksioneve të tij;
- Rregullimi i planit profesional të pensionit dhe në veçanti rolin e punëdhënësit në këto skema, për të rritur kështu numrin e planeve profesionale, si një zgjidhje e përshtatshme për të siguruar përfitime shtesë në moshën e pensionit.

Ndryshimet në projektligj synojnë përqasjen e tij me Direktivën 2003/41/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës të datës 3 qershor 2003 “Mbi aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve për dhënien e pensioneve profesionale”, parimet e mbikëqyrjes së pensioneve private të hartuara dhe të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve (IOPS), si dhe Udhëzuesit e OECD-së.

Aktet nënligjore

Aktet e Autoritetit në tregun e pensioneve private vullnetare konsistuan në miratimin e manualit të mbikëqyrjes dhe amendimin e një rregulloreje.

Manuali i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit, u miratua me vendimin e Bordit nr. 146, datë 29.09.2016 si produkt i projektit të asistencës teknike të BB-së në fushën e pensioneve private vullnetare “Mbikëqyrja e fondeve vullnetare të pensionit dhe zgjerimi i tregut privat të pensioneve”. Një nga shtyllat kryesore të këtij projekti ishte forcimi i bazave të mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve private duke përdorur mënyra moderne të mbikëqyrjes si ajo me bazë rreziku. IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Pensioneve) e identifikon mbikëqyrjen me bazë rreziku si pjesë të rëndësishme të paketës së mbikëqyrjes duke e parashikuar edhe në parimet e mbikëqyrjes së këtij sektori. Objektivi i këtij manuali është t'i sigurojë Autoritetit material referimi që mundëson zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rreziku për tregun e fondeve të pensionit vullnetar. Kështu, në qendër të mbikëqyrjes me bazë rreziku është një metodologji e cila i siguron Autoritetit mundësinë që të përdorë me efektivitet burimet e tij, për ta zbutur rrezikun e subjekteve të mbikëqyrura në nivele të pranueshme. Manuali i mbikëqyrjes me bazë rreziku është një qasje e strukturuar ku si elementë themelorë ka fokusimin te rreziqet më të mëdha, zgjedhjen e strategjive të përshtatshme për zbutjen e rrezikut dhe përzgjedhjen se cilat rreziqe duhen shqyrtuar dhe në cilin subjekt. Kjo bën të mundur shpërndarjen e burimeve të mbikëqyrjes drejt problematikave dhe subjekteve që paraqesin kërcënim më të madh.

Ndryshimi i Rregullores nr. 1, datë 28.01.2010 “Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit” ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 120, datë 24.08.2016, e cila ka bërë gjithashtu përaftrim me direktivën 2011 61 EU “Për administratorët e Fondeve të Investimit alternative”.

19. TRANSPARENCA DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes dhe stabilitetit të tregut financiar jobankar, ka në objektivat e tij dhe mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit.

Gjatë vitit 2016, Autoriteti ka monitoruar website-t e shoqërive administruese të fondeve të pensionit lidhur me publikimin dhe përditësimin e vlerës së kuotës së pensionit duke zbatuar bazën ligjore në fuqi.

Synimi kryesor i Autoritetit në aspektin e mbrojtjes konsumatore në pensionet vullnetare:

- Orientimi drejt praktikave më të mira mbi rolin e rregullatorit për mbrojtjen konsumatore në sistemin e pensioneve private;
- Mbrojtjen e konsumatorit nga konfliktet e interesit që mund të kenë këshilluesit për sistemin e pensioneve private;
- Masat e marra në fushën e dhënies së informacionit;
- Iniciativat për ritjen e njohurive mbi pensionet private.

Gjithashtu, Autoriteti ka kërkuar nga shoqëritë administruese, përpara se të fillojë promovimin e fondit të pensionit dhe lidhjen e kontratës së fondit të pensionit me çdo person dhe jo më vonë se 31 marsi i çdo viti duhet të publikojë një prospekt, i cili përmban informacion të vërtetë dhe korrekt për fondin e pensionit që administron.

Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun: Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Në faqen online të AMF-së janë pasqyruar edhe aktivitetet promovuese për tregun e pensioneve që Autoriteti ka organizuar në kuadër të projektit “Shqipëria: Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve”. Për ndërgjegjësimin e publikut dhe për një pasqyrim sa më të gjerë të përparësive që sjell pjesëmarrja në fondet e pensioneve, AMF organizoi disa sesione informuese gjatë periudhës mars–maj 2016. Grupet e synuara në këto seanca informimi ishin punëdhënësit e mëdhenj, agjencitë e punësimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, grupe të caktuara të profesionistëve të lirë, gazetarë të mediave të shkruara dhe elektronike, etj. Këto seanca informimi u pasqyruan edhe nga mediat e specializuara në mbulimin e lajmeve ekonomike.

Informacione në faqen online janë vendosur edhe për bashkëpunimin e AMF-së me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë, FMA, sidomos lidhur me mbikëqyrjen e fondeve të pensionit.

Megjithatë, tregu i pensioneve vullnetare ka pasur një mbulim mediatik më rastësor dhe më të pakët se dy tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së, kjo e lidhur edhe me realitetin aktual se ky treg është ende mjaft i vogël krahasuar me dy tregjet e tjera nën mbikëqyrjen e AMF-së. Mbulimet janë lidhur më së shumti me aktivitetin dhe publikimet që Autoriteti bën për këtë treg. Kështu, mediat sidomos ato të specializuara në çështjet ekonomike kanë pasqyruar publikimet tremujore të të dhënave për tregun e pensioneve.

Kapitulli 4

PROJEKTET, PARTNERITETI, BASHKËPUNIMI RAJONAL, PROCESET INTEGRUESE



20. PARTNERITETI KOMBËTAR

Bashkëveprimi i rregullatorëve të ndryshëm ekonomikë dhe financiarë është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi AMF, edhe gjatë vitit 2016, ka thelluar marrëdhëniet me institucionet ekonomike të vendit, rajonit e më gjerë për zhvillimin e rregullimin e tregut të sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare.

Gjatë 2016, një vend të rëndësishëm zuri bashkëpunimi dypalësh ndërmjet AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe bashkëpunimi shumëpalësh ndërmjet tyre në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) (takimet tremujore) dhe të grupit teknik (takimet mujore). Thelbi i procesit të bashkëpunimit gjatë vitit 2015 ka qenë ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të FSAP, veçanërisht i atyre rekomandimeve, zbatimi i të cilave lidhet me fushat e veprimit të këtyre institucioneve, siç ishin paketa ligjore; trajtimi fiskal i produkteve të sigurimeve dhe të pensioneve; masat stabilizuese, etj.

Në funksion të forcimit të tregut të sigurimeve, dhe në mënyrë specifike për sigurimet e detyrueshme motorike, AMF ka punuar ngushtësisht me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, si edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Në sajë edhe të marrëveshjeve të realizuara më parë me këto institucione, bashkëpunimi ka mundur kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme.

AMF, në funksion të zgjerimit të platformës së regjistrave elektronikë në administrim, si dhe në zbatim të VKM, nr. 945, datë 2.11.2012, gjatë vitit 2016 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e cila mundëson administrimin dhe ndërveprimin e bazave të të dhënave me institucione të tjera shtetërore. Ky bashkëpunim ka mundur lidhjen e drejtpërdrejtë me të dhënat e regjistrat të Gjendjes Civile dhe të dhënave të regjistrat të mjeteve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, në funksion të sistemit Bonus-Malus. Një marrëveshje shumë e rëndësishme ishte dhe ajo me ALCIRT (Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike) e cila administron dhe mirëmban portalin online, si dhe ndihmon me bllokimin e faqeve të Internetit me përmbajtje të paligjshme në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor.

Në maj të vitit 2016, Autoriteti nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni me Universitetin Ekonomik të Tiranës. Duke synuar zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në kuadër të transmetimit të dijeve mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë, palët ranë dakord mes tyre për një bashkëpunim midis dy institucioneve lidhur me përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të studimit me koncepte dhe analiza të mënyrës së funksionimit dhe të mbikëqyrjes së tregut financiar. Dy institucionet u angazhuan të punojnë së bashku në përputhje me kërkesat ligjore dhe frymën e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje në fushën e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare. Gjithashtu, për një shkëmbim sa më efikas të materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore të dy institucioneve, për një bashkëpunim të ekspertëve/burimeve njerëzore të dy institucioneve, me qëllim përbushjen e funksioneve të secilit institucion, si dhe organizimin e konferencave të përbashkëta, trajnimeve, internshipeve, leksioneve të hapura, seminareve, praktikave mësimore apo takimeve, si dhe për dhënien e informacionit në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve, ruajtjen dhe stabilitetin e transparencës.

21. PARTNERITETE DHE ANËTARËSIME NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (IAIS), që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, si dhe mbrojtjen e të siguruarit dhe të kontribuojë në stabilitetin financiar global. Ky anëtarësim ka ndihmuar në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar mes autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve.

Gjatë vitit 2016, AMF vazhdoi pjesëmarrjen në mënyrë aktive në aktivitetet e IAIS. Këto janë disa nga aktivitetet e IAIS, ku AMF ka marrë pjesë si anëtare e kësaj organizate:

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IAIS

- Mbledhje e Nënkomiteteve të Punës;
- Seminar “Aftësia paguese dhe standardet e kapitalit për siguruesit në nivel ndërkombëtar”;
- Seminar “Grupet e Sigurimeve, siguruesit e rëndësishëm për sistemin global dhe zgjidhjet”;
- Forumi “Mbikëqyrja e Menaxhimit të Rrezikut të Shoqerive të Sigurimit”;
- Takimi Rajonal i IAIS për Evropën Qendrore, Lindore dhe Transkaukazinë;
- Mbledhje e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Punës;
- Konferenca Vjetore, 2016 “Roli i mbikëqyrësit në mbrojtjen e policëmajtësve, stabiliteti financiar dhe zhvillimi i tregut”.

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s që prej vitit 2009. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë është organizmi ndërkombëtar që mbledh së bashku rregullatorët e letrave me vlerë në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e letrave me vlerë. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtarisht për rregullimin e letrave me vlerë.


AMF ka qenë e angazhuar në plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në këtë organizatë dhe vazhdon të plotësojë kuadrin rregullator, me qëllim përafrimin me standardet e parimet e IOSCO-s. AMF është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në Komitetin Evropian të IOSCO-s (*European Regional Committee, ERC*) dhe e Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim (*Growth and Emerging Markets Committee, GEM*).

Më poshtë është një përmbledhje e pjesëmarrjes së AMF-së në aktivitetet e organizuara nga IOSCO gjatë vitit 2016.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOSCO-n

- Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian;
- Mbledhja Vjetore dhe konferenca e vendeve në rritje 2016;
- Mbledhjet e Komiteteve të IOSCO-s (GEM dhe ERC);
- Mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian, ERC;
- Seminar “Çështjet e librave tregëtarë dhe Infrastrukturës së tregut”.

AMF është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS), që prej vitit 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare, e cili përfaqëson ato institucione që janë përfshirë në mbikëqyrjen e marrëveshjeve të pensioneve private. IOPS aktualisht ka 87 anëtarë dhe vëzhgues që përfaqësojnë 75 vende dhe territore në të gjithë botën.



Pjesëmarrja e AMF-së në këto aktivitete konsiston në angazhimin për hartimin e dokumenteve politikë dhe studimorë. Gjatë vitit 2016, AMF ka vazhduar kontributin e saj si pjesëmarrëse në plotësimin e dokumenteve dhe pyetësorëve të ndryshëm, duke dhënë informacion lidhur me praktikën e ndjekura aktualisht në tregun shqiptar të pensioneve private. Këto janë disa nga aktivitetet ku AMF ka marrë pjesë si anëtare e IOPS-it.

Veprimtaritë kryesore në kuadër të bashkëpunimit me IOPS-in

- Mbledhje të Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike;
- Mbledhja e Komiteteve të IOPS-it;
- Mbledhja e përbashkët e Grupit të Punës së IOPS/OECD mbi Pensionet Private;
- Forumi Global OECD/IOPS mbi pensionet private;
- Mbledhja e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore.

Anëtarësimi në këto organizata i vjen në ndihmë Autoritetit duke e mbështetur atë në zgjidhjen e problematikave dhe çështje të lidhura me tregjet nën mbikëqyrje. Kështu gjatë vitit 2016, në kuadër të marrëveshjes shumëpalëshe të Mirëkuptimit (MMoU) me IOSCO-n, AMF ka patur edhe komunikime me Autoritetin e Sjelljes Financiare (Financial Conduct Authority, FCA) në Londër, për më shumë informacion në lidhje me një nga platformat e tregëtimit online që vepron në mënyrë të pa miratuar në territorin e Shqipërisë.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët

Projektet strategjike dhe rritja e kapaciteteve institucionale të AMF-së janë mbështetur edhe gjatë vitit 2016 nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëdhënieve efektive me institucionet ndërkombëtare, financiare dhe donatorët.

Banka Botërore, mbetet një partner i rëndësishëm strategjik që mbështet Autoritetin në përbushje të misionit themelor. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të FSAP-it, Autoriteti i mbështetur nga Banka Botërore prezantoi projektin e asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i fokusuar në zhvillimin e tregut të kapitaleve”. Banka Botërore nëpërmjet ekspertizës dhe ekspertëve të saj do të ndjekë dhe zhvillimin e këtij projekti të rëndësishëm, i cili është i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike Zvicerane (SECO) përmes Grantit (Trust Fund Grant).

Gjithashtu, gjatë 2016 në kuadër të përbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative) AMF ka punuar për zbatimin e projektit të asistencës teknike për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare në vend “Mbikëqyrja e pensioneve në Shqipëri dhe zgjerimi i mbulimit”.

Përsëri në kuadër të përbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet FIRST Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative) AMF ka punuar për zbatimin e projektit të asistencës teknike për reformën e tregut të sigurimeve.

Gjithashtu një partner shumë i rëndësishëm për AMF-në është dhe Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID). Ndër vite kjo organizatë ka ndihmuar AMF-në në projekte të ndryshme, për forcimin e rolit mbikëqyrës dhe rregullator, si edhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Ky organizëm vazhdon të mbetet një ndër partnerët kryesorë të AMF-së, në drejtim të asistencës teknike.

22. BASHKËPUNIMI RAJONAL


Edhe gjatë vitit 2016, bashkëpunimi me institucionet homologe të rajonit ka qenë mjaft i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së rolit të AMF-së për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jobankare.

AMF ka bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA). Marrëveshja e Mirëkuptimit midis të dy institucioneve që është në veprim prej vitit 2010 ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të të dy vendeve sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Maqedonisë. Gjithashtu, në shtator 2016, AMF ishte e ftuar të merrte pjesë në inspektimin e përbashkët të kompanisë INSIG, në Maqedoni. Inspektimi u bë së bashku me pjesëmarrjen e homologëve maqedonas dhe është pjesë e planit të përbashkët që AMF ka me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Maqedonisë, ISA. Inspektimi është pjesë e planit të përbashkët me homologët maqedonas mbi kontrollin e veprimtarisë së kompanive shqiptare të sigurimit që veprojnë në Maqedoni, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave përkatëse të secilit rregullator. AMF mori pjesë në këtë inspektim, me qëllim harmonizimin e mekanizmave për mbikëqyrjen e grupeve në përputhje me Parimet Bazë të Mbikëqyrjes dhe praktikat ndërkombëtare, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të ri të sigurimeve.

Në muajin qershor, AMF mori pjesë në një konferencë e cila u organizua nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Maqedonisë ku midis të tjerash u diskutua mbi perspektivën evropiane për tregjet e kapitalit në rajon dhe pritshmëritë e konsumatorit në një mjedis të dixhitalizuar. Gjatë zhvillimit të konferencës tema të veçanta diskutimi ishin: përvoja e shteteve të reja anëtarë në BE dhe efektet mbas këtij anëtarësimi, sfidat e reja që vijnë nga procesi i harmonizimit ligjor, u diskutua mbi arritjet e një konsolidimi rajonal të tregjeve të kapitalit, shkëmbimit ndërkufitar të shërbimeve financiare në rajon si dhe trendi i këtij shkëmbimi, etj.

Gjithashtu një bashkëpunim të rëndësishëm AMF ka dhe me BOK (Bankën Qendrore të Kosovës). Në këtë kuadër të thellimit të bashkëpunimit midis dy institucioneve janë zhvilluar takime pune, ku është diskutuar për vijimin e bashkëpunimit në mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, pjesë të grupeve të sigurimit në Shqipëri. Gjithashtu, është planifikuar që në vitin 2017 të zhvillohen inspektime të përbashkëta me BOK përsa i përket degëve të kompanive shqiptare që kanë aktivitet në Kosovë.

Një takim tjetër i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit rajonal është dhe "Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore", (CESEE), e cila ka vazhduar të mbështesë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave më të mira midis stafeve të autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve. Gjatë 2016 janë zhvilluar takimi i dhjetë dhe i njëmbëdhjetë i kësaj iniciative. Në takimin e 11-të në Varshavë, Poloni, të Iniciativës CESEE, çështjet e trajtuara lidheshin me krijimin e strukturave mbikëqyrëse efektive bazuar në risk, shkëmbimin e përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, mbulimin e kompensimit për dëmet jomateriale nga sigurimi i detyrueshëm motorik, si dhe skemat e garancisë si një mekanizëm për mbrojtjen nga rreziqet. Në takimin e 12-të, në Sloveni, u trajtuan sfidat e mbikëqyrjes së degëve në BE, praktikat e BE-së lidhur me mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe ndryshimet e pritura në legjislacionin e BE-së që lidhen me ndërmjetësit, monitorimi/ kontrolli i cilësisë së auditimeve të jashtme, kërkesat për anëtarët e bordit dhe mbajtësit e funksioneve.



Bashkëpunimi me autoritete homologe në BE

Gjatë vitit 2016, Autoriteti ka pasur në vëmendje zgjerimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tij dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe, duke marrë pjesë në takimet apo veprimtaritë e organizuara për njohjen dhe përditësimin me tendencat më të fundit mbikëqyrëse dhe rregullatore, shkëmbimit të përvojave të ndërsjella.

Një partner mjaft i rëndësishëm i AMF-së në zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje prej vitesh është Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA). Bashkëpunimi me FMA-në, është konsoliduar ndër vite edhe materializuar me takime të shpeshta të drejtuesve të lartë të institucioneve, si edhe të stafeve teknike. Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri. Mbi këtë bazë janë ndërtuar marrëdhënie të suksesshme ndërmjet dy institucioneve, duke u konkretizuar me shkëmbim përvoje dhe me firmosjen në vitin 2016 të Marrëveshjes së Koordinimit për Kolegjet Mbikëqyrëse VIG, e cila ka për qëllim të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij Grupi, shkëmbimin e informacionit dhe sekreteve profesionale midis tyre, bashkëpunim se më efikas mes anëtarëve të Grupit dhe eprorit, si dhe një konsultim për procesin e vendimmarrjes mes anëtarëve të Grupit.

Që prej vitit 2014 e në vazhdim, AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse të Grupit UNIOA. Ekspertët e departamentit të mbikëqyrjes të AMF-së disa herë gjatë vitit 2016 morën pjesë në mbledhjet e Kolegjit të Mbikëqyrjes për “UNIOA Insurance Group” (UIG) dhe “Vienna Insurance Group” (VIG).

Gjatë vitit 2016 në kuadër të Kolegjit të Mbikëqyrësve të Grupit UNIOA u lidh Marrëveshja e Konfidencialitetit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut Financiar Zviceran, FINMA. Kjo marrëveshje plotëson Marrëveshjen e Koordinimit të UNIOA Group.

Qëllimi i marrëveshjes së konfidencialitetit është shkëmbimi i informacionit konfidencial që do të përdoret nga palët vetëm për qëllime të ligjshme mbikëqyrëse.

Një bashkëpunim të ngushtë AMF ka dhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve Sllovene. Në këtë kuadër, në mars 2016 këto dy institucione firmosën Marrëveshjen e Mirëkuptimit për Bashkëpunimin Reciprok dhe Shkëmbim të Informacionit për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni) firmosën këtë Memorandum Mirëkuptimi duke marrë në konsideratë rritjen e treguesve të zhvillimit ndërkombëtar në tregun e sigurimeve dhe nevojën për bashkëpunim reciprok. Në këtë marrëveshje theksi bie tek mbrojtja e interesave të të siguruarve të kompanive të sigurimit, si dhe promovimi i integritetit, stabilitetit dhe efikasitetit të industrisë së sigurimeve duke ofruar një kuadër për bashkëpunim, duke përfshirë mënyra komunikimi, duke zhvilluar mirëkuptimin reciprok, shkëmbimin e informacionit, si dhe duke dhënë asistencë deri në kufijtë që lejohet nga ligji vendas i palëve.

23. PROJEKTET


AMF gjatë vitit 2016 ka zbatuar disa projekte për tregjet nën mbikëqyrje. Falë bashkëpunimit të frytshëm e të vazhdueshëm me institucione si Banka Botërore, SECO, FSVC janë zhvilluar dhe zbatuar projektet e mëposhtme:

1. Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve;
2. Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve vullnetare;
3. Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve;
4. Projekti i asistencës teknike mbi menaxhimin e skenarëve të rrezikut.

1. Projekti i asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2016 është punuar për përfundimin me sukses të projektit të asistencës teknike për reformën në tregun e sigurimeve, projekt i cili vjen në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe është mundësuar me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet First Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative). Projekti ka pasur një kohëzgjatje prej 24 muajsh, kohë e cila është kërkuar të zgjatet nga Banka Botërore deri në fund të muajit mars 2017, dhe përmban tre komponentë kryesorë të cilat janë:

- Sigurimi i produktit MTPL. Në këtë komponent synohet të hartohen kërkesa rregullatore për përcaktimin e rezervave për produktin MTPL, që janë të përshtatshme nga ana aktuariale dhe për t'i inkuadruar ato me praktikën e mbikëqyrjes në vend. Objektivat e këtij komponenti janë: (i) të sigurohet për konsumatorët kryerja e pagesave të duhura dhe në kohë në lidhje me dëmet për produktin MTPL; (ii) të ndiqen të njëjtat standarde në sigurimin MTPL; dhe (iii) të sigurohet vlerësim i përshtatshëm i aftësisë paguese për të gjitha shoqëritë e sigurimit;
- Mbikëqyrja e sigurimeve të përgjithshme. Në këtë komponent synohet zhvillimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit të miratuar për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, paketës së manualeve të mbikëqyrjes në vend dhe kuadrit rregullator për sigurimin e Jetës. Objektivi i këtij komponenti është forcimi i kapacitetit mbikëqyrës institucional të AMF-së. Ky komponent fokusohet në veprimtarinë e sigurimit të Jetës dhe në këtë aspekt u punua me parimet aktuariale dhe rregullat për përcaktimin e provigjoneve matematike; aktivet në mbulim të provigjoneve matematike; mbrojtjen e konsumatorit në kontratat e sigurimit të Jetës. Këto koncepte së bashku me manualët e mbikëqyrjes së sigurimeve të Jetës apo të pronave pritet të përfundohen në një kuadër të miratuar rregullativ gjatë vitit 2017;
- Programi kombëtar i sigurimit nga tërmetet. Në këtë komponent synohet plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore me elementët e sigurimit nga tërmeti dhe përmbytja. Në bashkëpunim me Bankën Botërore, pritet të vijojë puna së bashku me palët e tjera të interesit për hartimin e këtij ligji.



Në punën vjetore në përmbushje të detyrimeve dhe arritjes së rezultateve të këtij projekti, janë zhvilluar disa takime me ekspertë të Bankës Botërore mbi ecurinë e projektit dhe konkretisht janë hartuar dhe miratuar në formën e tyre përfundimtare dokumentat e mëposhtëm:

- Hartim i metodologjisë së provigjonimit të dëmeve MTPL;
- Hartimi i instrumenteve për metodologjinë e provigjonimit të dëmeve MTPL;
- Draft final i Rregullores mbi përlllogaritjen matematikore të provigjonimeve (sigurimi i Jetës);
- Draft final i Rregullores mbi asetet që mbulojnë provigjonet (sigurimi i Jetës).

2. Projekti i asistencës teknike për zgjerimin e tregut dhe mbikëqyrjen e pensioneve “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend”

Gjatë pjesës së parë të vitit 2016 është punuar për përfundimin me sukses të projektit “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare”, i cili filloi në vitin 2014, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP) dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet FIRST Initiative (Financial Sector Reform and Strengthening Initiative), pati si synim forcimin dhe zhvillimin e pensioneve private në Shqipëri. Ky projekt përfundoi me sukses, me vizitën e fundit të ekspertëve të Bankës Botërore në muajin maj 2016.

Objekti i këtij projekti ishte mbështetja e zgjerimit të procesit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së pensioneve private, si dhe zgjerimi i shtrirjes së tregut të pensioneve private në një sistem pensionesh më të sigurt, të qëndrueshëm dhe efektiv. Ky projekt përqendrohej në dy komponentë kryesorë si rregullimi dhe mbikëqyrja, si dhe zgjerimi i tregut, duke ndihmuar në ndërtimin e kuadrit të mbikëqyrjes mbi bazë rreziku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse; rishikimin e bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës; apo përcaktimin e një plani strategjik dhe veprimi për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Fushat kryesore që u mbuluan në kuadër të këtij projekti ishin:

- Ndërtimi i kuadrit të mbikëqyrjes me bazë rreziku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse;
- Rishikimi i bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës;
- Përcaktimi i një plan veprimi strategjik për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Pas përfundimit të këtij projekti, Autoriteti ka miratuar gjatë mbledhjes së datës 29.09.2016, Manualin e Mbikëqyrjes me bazë rreziku për fondet vullnetare të pensionit, si dhe ka kryer implementimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku në tregun e pensioneve private.

3. Projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve

Projekti “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në mbikëqyrjen e tregut të fondeve të investimeve dhe tregjet e obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë vendore. Ky projekt mbështetet nga Banka Botërore, e cila do të ndjekë edhe zbatimin e tij, ndërsa Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) është financues i këtij projekti përmes Grantit (*Trust Fund Grant*).

Projekti, i cili ka filluar të zbatohet në muajin korrik 2016, ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh dhe pritet të përfundojë në muajin mars të vitit 2019. Ai është hartuar për të përballuar sfidat me të cilat po përballlet AMF dhe fushat që do të mbulojë ky projekt janë kryesisht:

- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve të investimeve. Në këtë komponent synohet të kryhen vlerësimet diagnostikuese, të zhvillohet paketa e mbikëqyrjes (metodologjia, manualët dhe mjetet), si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për t'u përgatitur për emetimet e obligacioneve të shoqërive aksionare dhe atyre të qeverisë vendore. Në këtë komponent synohet të kryhen analiza, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në fushën e instrumenteve dhe tregjeve të borxhit.

Nga zbatimi i këtij projekti priten rezultatet e mëposhtme:


- AMF të zhvillojë një metodologji dhe praktikë gjithëpërfshirëse të mbikëqyrjes për fondet e investimeve, si dhe manuale dhe mjete të tjera operative që lidhen me këtë mbikëqyrje;
- AMF të jetë në gjendje për të mbështetur zhvillimin e tregut të obligacioneve të korporatave dhe të qeverisë vendore nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator;
- Forcimi i burimeve profesionale dhe njerëzore të AMF-së për të mbikëqyrur veprimtarinë e tregut të kapitaleve përmes aktiviteteve të ndërtimit të kapaciteteve *on-site* dhe *off-site*.

Për arritjen e këtyre rezultateve, projekti është ndarë në tre faza zbatimi. Konkretisht, secila prej fazave ka objektivat e mëposhtme:

- Faza e parë: Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së të mbikëqyrë dhe rregullojë sektorin e fondeve të investimeve / Vlerësim i nevojave mbikëqyrëse të AMF-së në lidhje me zhvillimin e shpejtë të sektorit të fondeve të investimeve;
- Faza e dytë: Shqyrtimi dhe zhvillimi i legjislacionit dhe kuadrit mbikëqyrës për sektorin e fondeve të investimeve dhe tregun e obligacioneve;
- Faza e tretë: Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së të mbikëqyrë dhe rregullojë sektorin e fondeve të investimeve dhe tregut të bonove / ndërtimi i kapaciteteve.

Gjatë vitit 2016 është punuar për zbatimin e fazës së parë të projektit i cili synon zhvillimin e kapaciteteve të AMF-së për të mbikëqyrur dhe rregulluar sektorin e tregut të investimeve, si dhe vlerësimi i nevojës për mbikëqyrje të AMF-së përballë zhvillimit të shpejtë të sektorit të fondeve të investimit. Gjatë këtij viti konsulentët kanë kryer dy vizita në Tiranë, ku kanë kryer takime me drejtuesit dhe stafin e AMF-së, përfaqësues të tregut, dhe palët e interesit. Gjithashtu, janë kryer edhe *workshop*-e për të prezantuar punën dhe gjetjet e kësaj faze.

Gjetjet dhe rekomandimet e tyre lidhur me strukturën aktuale të Autoritetit dhe mundësitë e zhvillimit të kapaciteteve të tij në linjë me zhvillimin e ardhshëm të tregut, si dhe vlerësimin e situatës aktuale të tregut të fondeve të investimit dhe titujve, konsulentët i përmbledhën në raportet, të cilat ishin edhe produktet finale të kësaj faze. Këto gjetje u prezantuan gjithashtu edhe në *workshop*-in final ku morën pjesë drejtuesit dhe përfaqësues të AMF-së;



përfaqësuesi i Bankës Botërore; përfaqësues nga CFCU-ja; përfaqësues të shoqërive që operojnë në tregun e fondeve të investimeve, fondeve të pensionit, dhe bankave depozitare të aseteve të këtyre fondeve; si edhe palë të tjera interesi nga institucione shqiptare si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave apo Komisioni i Ekonomisë.

Në vijim, për të ndjekur zbatimin e këtij projekti është ngritur edhe *Project Steering Committee* me përfaqësues nga AMF, Banka Botërore dhe SECO

Projekte të mbështetura nga Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC / USAID)

Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC/USAID), është një ndër partnerët e rëndësishëm që ka mbështetur ndër vite AMF-në në projekte të ndryshme duke ofruar asistencë teknike sipas nevojave. Gjatë vitit 2016, pas dakordësimit të listës së projekteve dhe vendosjes së prioritetit për radhën e zbatimit të tyre, gjatë muajit nëntor (21 -23) filloi projekti për hartimin e kuadrit të menaxhimit të skenarëve të krizave për fondet e investimit (*Assisting the AFSA establish a crisis management framework for investment funds*). Axhenda e këtyre takimeve parashikonte takime me stafin e AMF-së, Ministrinë së Financave, Drejtues të Sektorit të Supervizionit dhe të Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë, si dhe me Drejtues të Fondeve kryesore të Investimeve të licencuara në Republikën e Shqipërisë. Në vijim është dërguar nga konsulentët draft raporti, mbi të cilin AMF ka kryer komentet përkatës dhe po punohet drejt përkthimit dhe finalizimit të këtij raporti me paraqitjen e tij në Bord.

Projekti REPARIS

Projekti REPARIS, është një projekt i cili menaxhohet nga Qendra e Reformës së Raportimit Financiar (*Centre for Financial Reporting Reform, CFRR*), institucion i BB-së me qendër në Vjenë, pjesë e World Bank's Governance Global Practice. Ky Projekt mbështet vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore në përshtatjen dhe adaptimin e Standardeve më të larta të raportimit financiar si një çelës suksesi për një sistem qeverisje transparente.

Qëllimi i tij është të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të rëndësishme të kontrollit financiar në nivel ekspertize, sistemin dhe kapacitetin rregullator si dhe në drejtim të përshtatjes dhe adoptimit të standardeve më të larta të legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij projekti, AMF përfiton asistencë teknike për stafin e saj, në drejtim të përmirësimit të aftësive audituese, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbikëqyrjes së auditimit dhe forcimit të institucioneve rregullatore dhe monitoruese për një cilësi sa më të lartë të raportimit financiar.

Gjatë viti 2016 janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të BB-së në lidhje me këtë projekt, si dhe është dhënë kontributi i AMF-së në hartimin e Dokumenteve Standarde të Tenderimit, proces i cili do të shpallë edhe fituesin, që do të ofrojë asistencën teknike për stafin e AMF-së.

24. PROCESIT INTEGRUESE PËR TREGJET NË MBIKËQYRJE

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian është një objektiv kombëtar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Evropës së Bashkuar. Statusi kandidat që iu dha Shqipërisë nga Këshilli Evropian në qershor 2014 është inkurajim për të përshpejtuar ritmin e reformave. Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vijuar nëpërmjet strukturave përkatëse në përputhje me MSA-në. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ka qenë në fuqi që prej prillit 2009 dhe Shqipëria ka plotësuar mirë detyrimet e saj.

Në datë 9 nëntor 2016, Shqipëria mori rekomandimin pozitiv për çeljen e bisedimeve për anëtarësim, që do të thotë se Qeveria u angazhua në ndërmarrjen e reformave që lidhen me BE-në dhe vazhdoi të bëjë përparim në plotësimin e objektivave të identifikuar në pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) përcakton një angazhim të veçantë të Republikës së Shqipërisë: përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian, proces ky që duhet të përfundojë në dy faza 5-vjeçare, brenda vitit 2019. Afati përfundimtar për realizimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është data 31 mars 2019.

AMF si institucion kontribues në këtë proces ka punuar intensivisht për të përket përafrimit të kuadrit ligjor me acquis e BE-së në fushën e shërbimeve financiare jobankare.

Më datë 9 nëntor 2016, Komisioni Evropian publikoi Raportin për Shqipërinë, i cili përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria gjatë periudhës tetor 2015- shtator 2016. Hartimi i Raportit të KE-së mbështetet edhe në kontributet e përgatitura nga Qeveria e Shqipërisë mbi përparimin dhe arritjet e institucioneve publike shqiptare në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Në këtë kuadër Autoriteti në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, në Kapitullin 9 "Shërbimet financiare" ka pasqyruar qartësisht zhvillimet aktuale për të përket përafrimit të kuadrit ligjor, zhvillimeve dhe reformave në sektorin financiar për tregjet nën mbikëqyrje. AMF po në këtë proces ka dhënë kontributin e vet edhe në kapitullin "Kriteri Ekonomik". Pjesë e këtij Raporti janë edhe vlerësimet e Komisionit Evropian për përparimet e bëra në fushën financiare jobankare.


Konkluzionet e Raportit të KE-së (tetor 2015-shtator 2016) (Kapitulli 9 - Shërbimet Financiare)

"Rregullat e BE-së synojnë sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, konkretisht në sektorin bankar, sigurimet, pensionet suplementare, shërbimet e investimit dhe tregjet e letrave me vlerë .

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë disa përparime në këtë fushë".

Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve, Raporti vlerëson progresin e arritur kryesisht në kuadrin legjislativ: "AMF miratoi disa rregullore që lidhen me aktivitetin e risigurimit dhe disa rregullore e procedura të tjera për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin në AMF. Ajo miratoi dhe kodin e etikës së aktuarëve. Përfundoi me sukses privatizimi i shoqërisë së sigurimeve shtetërore INSIG".

Raporti vlerëson punën e AMF-së edhe në fushën e tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit, ku vë në dukje se: "Janë miratuar ndryshimet në ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive".



Gjatë vitit 2016, AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Integritimit Evropian si institucioni koordinues në procesin e integritimit evropian. AMF ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Kyçi i suksesit të Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian është zbatimi i shpejtë i reformave, përmes aktiviteteve të planifikuara, në një nga dokumentet bazë siç është Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) për periudhën 2015-2020, i cili shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë.

AMF gjatë vitit 2016 ka përcjellë në Ministrinë e Integritimit informacione periodike për monitorimin e realizimit të PKIE 2015-2020 për kapitujt “Shërbimet Financiare” dhe “Kriteri Ekonomik”, si dhe ka punuar për përditësimin e këtij plani për periudhën 2017-2020, si një nga instrumentet kryesore për planifikimin dhe monitorimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.

Një tjetër drejtim i punës së AMF-së ka qenë përgatitja dhe prezantimi i raporteve pranë Komisionit Evropian në kuadrin e zhvillimit të takimeve periodike midis Shqipërisë dhe BE-së, konkretisht takimi i tetë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën” në muajin maj 2016 dhe i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri në qershor 2016.

Gjatë vitit 2016 Autoriteti në cilësinë e koordinatorit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” ka zhvilluar takime mujore të GNPIE-së për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, pjesë e të cilit është edhe Banka e Shqipërisë, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integritimin evropian”, si dhe ka marrë pjesë edhe në takimet mujore të GNPIE-ve të Kapitullit “Kriteri ekonomik” dhe Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” si anëtare e këtyre grupeve ndërinstitucionale.

Asistenca nga Bashkimi Evropian

Autoriteti gjatë vitit 2016 ka vlerësuar dhe shfrytëzuar instrumentin e asistencës afatshkurtër *TAIEX* (*Technical Assistance and Information Exchange*), i cili ofrohet nga BE-ja për të ndihmuar vendet candidate dhe candidate potenciale, në drejtim të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së. Të gjitha aplikimet në kuadër të instrumentit *TAIEX* kryhen në bazë të direktivave evropiane, duke parashtruar argumentimet përkatëse të nevojës së këtij instrumenti, si dhe qëllimin dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij instrumenti.

Për vitin 2016, çështjet për asistencë teknike afatshkurtër, të përzgjedhura nga AMF dhe të miratuara nga *TAIEX* konsistuan në:

- Mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarisë së ndërmjetësve në sigurime, në formën e Vizitës Studimore, e cila do të zhvillohet në Budapest, Hungari pranë Bankës Qendrore të Hungarisë gjatë 2017;
- Trajtimin e problematikave të ndryshme në fushën e sigurimit të detyrueshëm në formën e *Expert Mission*. Aktiviteti do të zhvillohet me ekspertë italianë të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve (*IVASS*), në ambientet e AMF-së gjatë 2017;
- Gjithashtu AMF ka aplikuar në formën e *Workshop*, edhe për çështjet që lidhen me implementimin e rregullave të reja evropiane mbi manipulimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm.

Autoriteti Europian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA)

Autoriteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale Evropiane (EIOPA) është themeluar më 1 janar 2011 me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e 9 nëntor 2010 për krijimin e një autoriteti mbikëqyrës Evropian duke zëvendësuar Komitetin e Mbikëqyrësve Evropianë të sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale. Detyra kryesore e EIOPA-s është të bashkojë organizmat mbikëqyrës kombëtare, në mënyrë që të standardizojë rregulloret dhe praktikat e mbikëqyrjes. Përgjegjësitë kryesore të EIOPA-s janë mbështetja e stabilitetit të sistemit financiar, transparenca e tregjeve dhe produkteve financiare, si dhe mbrojtja e të siguruarit, anëtarëve të skemës dhe përfituesve të pensioneve. EIOPA është i autorizuar për të monitoruar dhe për të identifikuar tendencat, rreziqet e mundshme dhe dobësitë që rrjedhin nga operatorët e tregut, përtej kufijve dhe në të gjithë sektorët.

EIOPA dhe ESMA u krijuan në të njëjtën kohë si pjesë e Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes Financiare që përfshin tre Autoritetet Evropiane Mbikëqyrëse, një për sektorin bankar, një për sektorin e letrave me vlerë dhe një për sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve profesionale, si dhe Bordin Evropian i Rrezikut Sistemik, si një përgjigje ndaj krizës financiare globale. Para dhe gjatë krizës financiare në vitin 2007 dhe 2008, Parlamenti Evropian bëri thirrje për një lëvizje drejt një mbikëqyrje më të integruar Evropiane në mënyrë që të sigurohet një nivel i njëjtë pjesëmarrje për të gjithë aktorët në Bashkimin Evropian dhe për të reflektuar një rritje të integritit të tregjeve financiare në BE. Si rezultat, kuadri mbikëqyrës është forcuar për të zvogëluar rrezikun dhe pasojat e krizave të ardhshme financiare. Sistemi Evropian i mbikëqyrjes financiare është një rrjet i integruar i autoriteteve mbikëqyrëse kombëtare dhe evropiane, që ofron lidhjet e duhura midis niveleve makro dhe mikro të kujdesshmërisë, duke lënë mbikëqyrjen e përditshme në nivel kombëtar.

Autoriteti Europian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA)


Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA) është themeluar më 1 janar 2011 dhe është një Autoritet i pavarur i BE-së që kontribuon në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar të Bashkimit Evropian duke siguruar integritetin, transparencën, efikasitetin dhe funksionimin e rregullt të tregjeve të titujve, si dhe duke siguruar rritjen dhe përmirësimin e mbrojtjes së investitorëve. Në veçanti, ESMA nxit bashkërendimin mbikëqyrës si ndërmjet rregullatorëve të titujve, ashtu edhe në të gjithë sektorët financiarë duke punuar ngushtë me autoritete të tjera mbikëqyrëse evropiane. Puna e ESMA-s në legjislacionin e titujve kontribuon në zhvillimin e një kuadri të vetëm rregullator në Evropë. Kjo shërben për dy qëllime, së pari, siguron trajtim të qëndrueshëm të investitorëve në të gjithë BE-në dhe së dyti, promovon kushte të barabarta konkurrence për ofruesit e shërbimeve financiare, si dhe garanton efektivitetin e mbikëqyrjes për subjektet e mbikëqyrura.

Angazhime të tjera në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA)

AMF është përfshirë si institucion pjesëmarrës në grupin negociator për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në kuadër të Marrëveshjes CEFTA, për shërbimet financiare jobankare, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 170, datë 28.05. 2014 "Për ngritjen e grupit negociator për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve në kuadër të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).

CEFTA është marrëveshja e tregtisë së lirë midis vendeve si: Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë dhe Moldavi. CEFTA e nisur në vitin 2007 konsiderohet si pjesë e integritit të Ballkanit në tregun e Bashkimit Evropian, objektivat kryesore të së cilës janë zgjerimi i tregtisë në mallra dhe shërbime, nxitja e investimeve, eliminimi



i barrierave ndaj tregtisë mes palëve, harmonizimi i dispozitave sa i përket çështjeve të politikave tregtare, etj.

Në prill 2016 Autoriteti mori pjesë në raundin të shtatë të negociatave (raundet e tjera të zhvilluara kishin lidhje me sektorët e tregtisë së mallrave dhe disa shërbime të tjera), ku u diskutuan shërbimet financiare (bankare dhe jobankare) në lidhje me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve në rajon.

Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)

Në kuadrin e zbatimit të detyrimeve dhe angazhimeve që Republika e Shqipërisë ka ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë, OBT, në maj 2016 në Gjenevë, pranë OBT-së, u zhvillua raportimi i dytë i Shqyrtimit të Politikës Tregtare për Shqipërinë. Për herë të parë ky raportim është bërë në vitin 2010. Autoriteti ishte pjesë e delegacionit të Shqipërisë, si një nga institucionet kontribuese për përgatitjen e këtij raporti.

Raportimi dhe shqyrtimi i politikës tregtare për çdo vend është një aktivitet shumë i rëndësishëm. Në qendër të kësaj pune është mekanizmi i Rishikimit të Politikave Tregtare të çdo vendi anëtar në OBT. Në hartimin e raportit të shqyrtimit të politikës tregtare të Shqipërisë, një kontribut të veçantë dha edhe AMF për pjesën e shërbimeve financiare jobankare.

Vlerësimi për Shqipërinë i sekretariatit dhe i anëtarëve pjesëmarrës të OBT-së sidomos atyre me peshë të madhe në OBT si përfaqësuesit e BE-së, SHBA-ve, Brazilit, Turqisë apo Kanadasë ishte shumë pozitiv, lidhur me zhvillimet ekonomike, sidomos me masat për rimëkëmbjen ekonomike, konsolidimin fiskal, reformën strukturore në energjetikë, lehtësimit të tregtisë, praktikave rajonale dhe më gjerë.

Direktiva MiFID II (Direktiva për Tregjet e Instrumentave Financiare)

Direktiva MiFID II 2014/65/BE (Market in Financial Instruments Directive) është direktiva bazë, më e rëndësishmja e rregullimit të tregjeve financiare të BE-së, e cila përcaktohet si perspektiva e re evropiane për instrumentet financiarë. MiFID II do të sjellë ndryshime dhe ndikim shumë të madh në tregjet financiare. Ajo do t'i bëjë ato më të integruara, më efikase, konkurruese dhe do të përmirësojë mbikëqyrjen dhe transparencën dhe risë mbrojtjen e investitorëve dhe konsumatorëve.

Kjo direktivë mundësoi për herë të parë konkurrencën në tregtimin e titujve midis firmave dhe tregjeve të ndryshme të investimit që operojnë në BE dhe ju dha atyre "një pasaportë" për të tregtuar kudo në BE, bazuar vetëm në autorizimin e shtetit të tyre anëtar. Direktiva gjithashtu përfshiu dhe masa të ndryshme për mbrojtjen e investitorëve. Në tetor 2011, mbas konsultimeve për reformimin e kësaj direktive, Komisioni Evropian publikoi propozimet legjislativ të cilat morën formën e MiFID II dhe rregullores së re MiFIR. (Market in Financial Instruments Regulation). Të dyja MiFID II dhe MiFIR hynë në fuqi në 2 korrik 2014, duhen të transpozohen brenda korrikut 2017 në ligjet e shteteve anëtare, dhe aplikimi fillon në janar 2018.

Synimet e MiFID II janë:

- Të krijojë një treg financiar të sigurt, të shëndoshë, më shumë transparent dhe të përgjegjshëm;
- Të sigurojë më shumë integritet, konkurrencë efikase të tregut financiar të BE-së;
- Të mundësojë angazhimin e G20 për të trajtuar pjesët më pak të rregulluara dhe të paqarta të sistemit financiar (kryesisht në Instrumentet Tregtare mbi Bankat);

- Të ndihmojë zhvillimin e mëtejshëm të një fushe loje të barabartë midis shteteve anëtare dhe pjesëmarrësve në treg;
- Të përmirësojë mbikëqyrjen dhe zbatueshmërinë;
- Të ulë kostot e pjesëmarrësve, të përmirësojë kushtet e aksesit dhe të rrisë konkurrencën globale.

Direktiva e Shpërndarjes në Sigurime

Direktiva 2016/97 KE (IDD) rregullon mënyrën e shitjes së produkteve të sigurimit. Ajo përcakton informacionin që i duhet dhënë konsumatorëve përpara se ata të nënshkruajnë një kontratë sigurimi, imponon sjellje të caktuar të biznesit dhe rregulla transparente të shpërndarësve, sqaron procedurat dhe rregullat për biznesin ndërkufitar dhe përmban rregullat për mbikëqyrjen dhe sanksionimin e shpërndarësve të sigurimit në rast se ata shkelin dispozitat e direktivës.

Për shkak të rrezikut potencial në rritje që produktet e sigurimit të bazuara në investime përfaqësojnë për konsumatorët, direktiva imponon kërkesa shtesë për shpërndarësit. Mbrojtja e policëmbajtësve të sigurimit duhet të jetë në një nivel me klientët e produkteve të investimeve (të rregulluara sipas direktivës MiFID II), pasi produktet e sigurimit janë shpesh të këmbëshme me produkte të investimeve të shitjes me pakicë. Prandaj, shpërndarësit në sigurime duhet të ndjekin rregulla të veçanta për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesave, të bëjnë të njohura të gjitha kostot dhe pagesat e tyre për konsumatorin, dhe duhet të ndjekin rregulla specifike për pranimin e pagesave nga palët e treta. Ata duhet të vlerësojnë jo vetëm nëse produkti i sigurimit i plotëson kërkesat dhe nevojat e konsumatorit, por edhe nëse njohja e klientit në fushën e investimeve është e përshtatshme, dhe nëse produkti i rekomanduar i sigurimeve me bazë investimi është i përshtatshëm për atë klient.

Direktiva hyri në fuqi më 23 shkurt 2016. Shtetet anëtare kanë 24 muaj kohë për të transpozuar dispozitat e saj në ligjin kombëtar. Më 23 shkurt 2018, shpërndarësit në sigurime duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e reja.

Vetë direktiva i nënshtrohet një shqyrtimi pesë vjet pas hyrjes së saj në fuqi.



25. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR I AMF-SË

Akte të reja

Me qëllim plotësimin e kuadrit të brendshëm rregullativ të Autoritetit u miratuan 2 rregullore të reja të cilat janë:

- Rregullorja nr. 10, datë 25.01.2016 “Mbi funksionimin e bibliotekës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave për administrimin dhe funksionimin e Bibliotekës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- Rregullorja nr. 75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median dhe publikun, publikimet dhe hartimin e funksionimin e faqes së Internetit” e cila përcakton procedurat në lidhje me funksionimin sa më të mirë të komunikimit dhe të marrëdhënieve të Autoritetit me median dhe publikun. Ajo ndihmon në përmbushje të detyrimit për transparencë maksimale në veprimtarinë e AMF-së dhe është në funksion të rritjes së besueshmërisë së publikut në aktivitetin e Autoritetit si dhe prezantimit sa më pozitiv dhe dinjitoz të Autoritetit në publik.

Amendime

AMF amendoi tre rregullore të brendshme të saj, si vijon:

- Rregullorja nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, u ndryshua me vendim Bordi nr. 23, datë 26.02.2016 dhe me vendimin e Bordit nr. 93, datë 27.06.2016. Këto ndryshime bazohen kryesisht në ndryshimet e fundit që ka pësuar Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë si dhe ndryshime të cilat gjatë zbatimit në praktikë të rregullores kanë sjellë nevojën e rishikimit;
- Rregullorja nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” u ndryshua me vendim Bordi nr. 90, datë 27.06.2016. Ky ndryshim është në përmbushje të misionit të Bordit të Autoritetit për ruajtjen e stabilitetit dhe mosdëmtimit të imazhit të subjekteve të mbikëqyrura, duke qenë i kujdesshëm në publikimin e vendimeve për masat e marra në mënyrë që të ruajë një ekuilibër ndërmjet të drejtës së informimit të publikut nga njëra anë dhe interesit për ruajtjen e konfidencialitetit të personave të prekur nga ana tjetër;
- Rregullorja nr. 90, datë 18.07.2012 “Për rregullat e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve në zotërim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” u ndryshua me vendimin e Bordit nr. 171, datë 31.10.2016. Ndryshimet e miratuara kanë ardhur si pasojë e ndryshimit të strukturës organizative dhe konfigurimit të Bordit, ndryshime të cilat konsistojnë në zëvendësimin e emërtesave.

26. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE POLITIKAT E BURIMEVE NJERËZORE

AMF për vitin 2016, vijoi funksionimin në bazë të strukturës së miratuar nga Bordi i Autoritetit, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 27, datë 28.04.2015. “Mbi strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimeve të punës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

Numri i punonjësve në përputhje me strukturën e miratuar është rritur gradualisht. Në fund të vitit 2016, numri i punonjësve në AMF, ishte 70 vetë. Shkalla e plotësimit të vendeve të punës në AMF, e matur me numrin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar, për vitin 2016 ka arritur në 89.7%. Plotësimi i vendeve të lira të punës, kryesisht në plotësimin e funksioneve mbikëqyrëse në Autoritet ka ndihmuar në përballimin më cilësor të vëllimit gjithnjë në rritje të aktivitetit të AMF-së në përmbushje të objektivave.

Në AMF, 78% e numrit të punonjësve i përkasin njësive që kryejnë funksione kryesore, të cilat lidhen me mbikëqyrjen, licencimin dhe rregullimin. Bazuar në strukturën e re organizative, shpërndarja e punonjësve sipas funksioneve të AMF-së dhe profesioneve jepet si më poshtë:

Figura 47: Struktura e punonjësve të funksioneve kryesore sipas njësive

(Në %)






Figura 48: Struktura e punonjësve sipas profesionit

(Në %)





Figura 49: Struktura e punonjësve sipas grupmoshës

(Në numër)



AMF edhe gjatë vitit 2016, është kujdesur të ruajë raporte optimale në strukturën e punonjësve bazuar në tiparet e tyre si arsimimi apo mosha. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punësimit të të rinjve që janë diplomuar apo kualifikuar me rezultate të larta, duke mundësuar pasurimin e mjedisit profesional me përvoja të reja dhe shërbyer si një burim real zhvillimi të punës në Autoritet. Mosha mesatare e punonjësve është 39 vjeç, 71 % e stafit janë femra, të cilat në AMF mbajnë pozicione drejtuese më shumë se meshkujt.

27. PASQYRAT FINANCIARE

Përcaktimi i buxhetit bazohet në dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligjit nr. 54/2014, datë 29.05.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". AMF edhe gjatë vitit 2016 ka vazhduar të financohet tërësisht nga burimet e veta.

Pasqyrat financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2016 janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Të dhënat e detajuara paraqiten në raportin e ekspertit kontabël të regjistruar të pavarur në shtojcën D.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, konceptit të materialitetit dhe të kontabilitetit mbi bazë konstatimesh.

Të ardhurat gjithsej të AMF-së për vitin 2016 janë 297.95 milionë lekë ose 23% më shumë krahasuar me planin. Pjesa më e madhe e të ardhurave të realizuara, 277.74 milionë lekë, ose 93.2 % e tyre përftohen nga veprimtaria e subjekteve të mbikëqyrura dhe tarifat e licencimit apo miratimit, ndërsa pjesa tjetër ka ardhur nga gjobat, interesat bankare dhe të ardhurat nga Qendra e Edukimit në masën 20.22 milionë lekë.

Kontributi kryesor brenda grupit të të ardhurave të veprimtarisë i përket të ardhurave të përfituara nga tarifat e paguara prej subjekteve të tregut të sigurimeve, të cilat përbëjnë 77.8% të të ardhurave gjithsej.

Tabela 40: Burimet e fondeve të AMF-së për vitin 2016

(Në mijë lekë)

Emërtimi	2016
1. Të ardhura nga veprimtaria	277,747
1.1 Të ardhura nga tregu i sigurimeve	232,052
1.2 Të ardhura nga tregu i letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve	44,900
1.3 Të ardhura nga kontributet e shoq. admin. të fondeve të pensioneve private	795
1.4 Të ardhura nga Qendra e Edukimit	3,350
2. Të ardhura nga gjobat dhe interesat bankare, etj.	16,871
Totali (1+2)	297,968




Tabela 41: Përdorimi i fondeve të AMF-së për vitin 2016

(Në mijë lekë)

<i>Emërtimi</i>	2016
1. Shpenzime funksionimi	195,948
1.1 Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	133,688
1.2 Shpenzime operative	62,260
2. Alokim për Fondin Rezervë për vitin 2016	18,309
3. Fonde të regjistruara për periudhat e ardhshme	83,711
Totali (1+2+3)	297,968

Gjatë vitit 2016 të ardhurat e përdorura gjithsej ishin 196 milionë ose 16.2% më pak se plani. Shpenzimet e funksionimit përbëjnë përdorimin kryesor të të ardhurave të AMF-së, duke zënë 70% të shpenzimeve gjithsej.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investimeve, AMF ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2016, përmbante 6 procedura prokurimi me tenderim, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla. Të gjitha procedurat e prokurimit me tenderim janë realizuar me sukses.

28. INFRASTRUKTURA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, në kuadër të realizimit të objektivave dhe detyrave kyçe të AMF-së, ka vijuar punën për modernizimin e infrastrukturës TIK dhe rritjen e kapaciteteve të Qendrës së Informacionit, në përputhje me përcaktimet rregullatore dhe me praktikatat e rekomanduara teknologjike.

Gjatë vitit 2016, krahas zgjerimit dhe përmirësimit të shërbimeve të brendshme të instaluara, AMF ka realizuar veprimtaritë kryesore që mbështesin arritjen e objektivave të saj:


- Përmirësimi/optimizimi i platformave dhe programeve aktuale me fokus inteligjencën e biznesit, performancën, aftësitë mbikëqyrëse dhe raportuese;
- Administrimi dhe përmirësimi i platformave aktuale të Qendrës së Informacionit, si:
 - Regjistri Online i Shitjeve;
 - Regjistri Elektronik i Dëmeve;
 - Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (AMF In-Reg).
- Administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit dhe ndërfaqeve të komunikimit me Institucionet shtetërore/subjektet raportuese;
- Përmirësimi i procedurave dhe politikave të sigurisë në Qendrën e Informacionit;
- Kualifikimi profesional i stafit të TI, me qëllim rritjen e ekspertizës profesionale.


29. AUDITI I BRENDSHËM

Aktiviteti i Njesisë së Auditimit është bazuar mbi zbatimin e Planit Vjetor të miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2016. Njësia e auditimit të brendshëm ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm në sektorin publik. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Me qëllim garantimin e një efëience sa më të lartë, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, në përputhje me fushën për auditim. Nga analiza e treguesve më specifike të auditimit rezultojnë se ato kanë ndryshuar në vite, të ndikuara si nga numri i auditimeve, ashtu dhe nga specifikat e objekteve apo fushat e audituara. Natyra e 13 gjetjeve të auditimit i referohet kryesisht parregullsive në zbatimin e procedurave, ndërsa 35 rekomandime kanë synim përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Gjetjet dhe rekomandimet janë raportuar tek Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe tek Bordi i Autoritetit.

Figura 50: Statusi i Rekomandimeve gjatë vitit 2016

(Në numër)





30. SFIDAT DHE OBJEKTIVAT

Sfidat dhe Objektivat e Autoritetit për vitin 2017 do të përqendrohen në këto drejtime:

1. Rritja e rolit parandalues ndaj shoqërive që promovojnë platformat e tregtimit online

Autoriteti synon marrjen e masave të duhura për licencimin dhe monitorimin e subjekteve që promovojnë platformat e tregtimit online me qëllim minimizimin dhe shmangien e rreziqeve që burojnë nga veprimtaria e palicencuar për të mirën dhe sigurinë e publikut investues. Në këtë proces, Autoriteti do të kërkojë vëmendje më të madhe nga institucionet shtetërore ligjzbatuese në drejtim të parandalimit të skemave dhe fenomeneve të paligjshme.

2. Monitorimi i Tregjeve dhe Mbikëqyrja me Fokus Rrezikun

Nëpërmjet zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi synohet marrja e masave për ruajtjen e shëndetit financiar të shoqërive që operojnë në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të tyre në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, duke vendosur objektivat si në vijim:

Për tregun e sigurimeve

Inspektime

- Kryerja e tre inspektimeve të plota sipas metodologjisë me fokus rrezikun në tre shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë, ku nuk është kryer inspektim sipas kësaj metodologjie;
- Kryerja e dy inspektimeve tematike për të verifikuar në vend masën e plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e plota të kryera gjatë vitit 2016 në shoqëritë që rezultojnë me mungesë të aftësisë paguese.

Analizat financiare (në distancë/*off-site*)

- Përgatitja e 44 raporteve të analizave financiare nga zyra (në distancë/jo në vend) për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe jetë për periudhat tremujore raportuese, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit si dhe informacioneve nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimin e raporteve të audituesit të jashtëm për shoqëritë e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2016;
- Analizim të raporteve të vetëvlerësimit për 8 shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Për 11 shoqëritë e sigurimit, kryerja për çdo tremujor e llogaritjeve të provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e aftësisë minimale paguese;
- Për 11 shoqëritë e sigurimit, kryerja e analizave të marrëveshjeve të risigurimit, si dhe vlerësimi për cilësitë e risiguresit;

- Për 11 shoqëritë e sigurimit, kryerja e monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10 përqind të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, nëse tarifat e primit të sigurimit, janë llogaritur nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

Tregu i fondeve të investimit dhe pensione ve vullnetare

Inspektime

- Kryerja e 2 inspektimeve në vend, për të dy shoqëritë administruese dhe fondeve të investimeve që ato administrojnë. Në një prej këtyre inspektimeve do të kemi edhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë për vlerësim të transparencës në tregëtimin e kuotave të fondeve të investimit nga degët e bankës që funksionon si agjent për tregëtimin e letrave me vlerë për investitorët;
- Kryerja e 2 inspektimeve lidhur me fondet e pensione duke zbatuar metodologjinë me bazë rrezikun sipas planit të miratuar në Komitetin e Rrezikut.

Analizat financiare (off-site)

- Për çdo tremujor, për tre fondet e investimit, tre fondet e pensionit vullnetar dhe shoqëritë administruese të tyre, do të kryhet shqyrtimi i paketës së pasqyrave financiare të depozituara, përgatitja e raporteve të analizës financiare, përgatitja e informacionit të konsoliduar për tregun e fondeve të pensionit dhe fondeve të investimit lidhur me treguesit financiarë.
- Shqyrtimin e raporteve të audituesit të jashtëm për Shoqëritë administruese të fondeve të pensione dhe të investimeve për veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2016.
- Kryerjen e ndryshimeve në formatin e pasqyrave të raportimit online dhe Vizor në bashkëpunim me strukturat përkatëse në AMF, bazuar në referencat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

3. Administrimi i Fondit të Kompensimit


Nëpërmjet këtij objektivi synohet të realizohen pagesat e detyrimeve të prapambetura, objekt i Fondit të Kompensimit.

4. Përmirësimi i Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Në këtë drejtim synohet:

Përmirësimi i kapaciteteve TIK të Qendrës së Informacionit:

- Përmirësimi i infrastrukturës hardware të Qendrës së Informacionit nëpërmjet rinovimit teknologjik të komponentëve mbështetës;
- Ndërtimi të dhomës së re teknologjike TI dhe instalimi i komponentëve mbështetës në përputhje me standardet e rekomanduara në fushë.



Përmirësimi i programeve aktuale të Qendrës së Informacionit;

- Modernizimi i platformave dhe programeve aktuale drejt një zgjidhje inteligjente të integruar dhe të sigurt për Qendrën e Informacionit;
- Konsolidimi dhe garantimi i vazhdueshmërisë së punës së Qendrës së Informacionit;
- Rritja e nivelit të sigurisë në rjetet e informacionit;
- Ruajtja e të dhënave të Qendrës së Informacionit;
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve IT.

5. Përmirësimi i Kuadrit Rregullativ

Do të vijojë kryerja e ndryshimeve rregullatore pas miratimit të amendimeve të Ligjit nr. 10 076 datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

6. Monitorimi dhe zbatimi i sistemit Bonus-Malus nga shoqëritë e sigurimit pas implementimit të tij, me miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 10076.

7. Nxitja dhe monitorimi e transparencës për konsumatorët e tregjeve financiare në mbikëqyrje:


Ky objektivi synon rritjen e besimit të konsumatorit si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregjeve nën mbikëqyrje.


8. Përbushja e detyrimeve për zbatimin e projekteve të asistencës teknike

Gjatë vitit 2017 do të vijojë ndjekja e zbatimit të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse: Fokusi në zhvillimin e tregut të kapitaleve” në lidhje me amendimin e Rregulloreve sipas sugjerimit të ekspertëve të projektit; përgatitjen e një udhëzimi për menaxhimin e krizave si dhe manualin e mbikëqyrjes me bazë rrezikun për fondet e investimit.

SHTOJCA A

Struktura e AMF-së






SHTOJCA B

Lista e institucioneve të mbikëqyrura

TREGU I SIGURIMEVE

	1. INSIG sh.a.	2. INSIG Jetë sh.a.	3. SIGMA INTERALBANIAN Vienna Insurance Group sh.a.	4. SIGAL Uniqa Group Austria sh.a.
<i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Erald HYSA	Eivana MINO	Klaidi ÇITOZI	Avni PONARI
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jetë	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jo-Jetë, Risigurime
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Kavajës", nr. 116, Tiranë	Rr. "Kavajës", nr. 116, Tiranë	Rr. "Komuna e Parisit", Pll. Lura, Kati 2, Tiranë	Bul. "Zogu I", Nr. 1, Kutia Postare Nr. 2387, Tiranë
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 223 838	+355 42 223 838	+ 355 4 2258254 +355 4 2258253	+355 42 233 308/ 253 407/408/ +355 42 250 220
<i>Faqja e Internetit</i>	www.insig.com.al	www.insig.com.al	www.sivig.al	www.sigal.com.al
<i>Posta Elektronike</i>	info@insig.com.al	info@insig.com.al	kontakt@sivig.al	info@sigal.com.al
<i>Nr. Licencës/ Data e licencës</i>	Nr. 3 dt. 08.06.2000	Nr. 4 dt. 08.06.2000	Nr. 01 dt. 03.02.1999	Nr. 02 dt. 23.06.1999 Nr. 01 dt. 03.02.2006
<i>Dt. mbarimit të licencës</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
	5. ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH sh.a.	6. INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a.	7. EUROSIG sh.a.	8. ALBSIG sh.a.
<i>Drejtor i Përgjithshëm</i>	Dritan ÇELAJ	Gentian SULA	Xhevdet KOPANI	Muhammet BARDHOCI
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jo-Jetë
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Ndërtesa Samos Tower, kati 2, Kutia Postare 8292, Tiranë	Rr. "Papa Gjon Pali II", vila Nr. 5, Tiranë	Rr. "George W. Bush", Nr. 10, Tiranë
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 230 506 +355 42 235 088	+355 42 270 576/577	+355 42 238 899/999, +355 42 223 841	+355 42 254 770 +355 42 254 664
<i>Faqja e Internetit</i>	www.atlantik.com.al	www.intersig.al	www.eurosig.al	www.albsig.com.al
<i>Posta Elektronike</i>	info@atlantik.com.al	info@intersig.al	info@eurosig.al	info@albsig.com.al
<i>Nr. Licencës/ Data e licencës</i>	Nr. 5 dt. 13.04.2001	Nr. 6 dt. 13.09.2001	Nr. 7 dt. 8.07.2004	Nr. 10 dt. 19.07.2004
<i>Dt. mbarimit të licencës</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat

	9. ANSIG sh.a.	10. SICRED sh.a.	11. SIGAL-LIFE Uniq Group Austria sh.a.	12. MAI sh.a.
Drejtor i Përgjithshëm	Edlir RUKA	Genc KOXHAJ	Edvin HOXHAJ	Elnar GASHI
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jo-Jetë	Sigurime Jetë	Sigurime Jetë	Broker në sigurime dhe risigurime
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital të huaj
Adresa e Selisë	Rr. "Donika Kastrioti", Vila 9/1 (Rr. 4 Shkurti), Tiranë	Rr. Brigada e VIII, Vila 3/1, Tiranë	Bul. "Zogu I", Nr 1, Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", pallati Gener 2 (Valle Verde), Kati III, zyra 4, Tiranë
Tel./Faks	+355 42 263 490/445/486	+355 42 237 549 +355 42 237 530	+355 42 253 407 / 408 +355 42 233 308	+355 42 500 514
Faqja e Internetit	www.ansig.al	www.sicred.com.al	www.sigal.com.al	www.mai-cee.com
Posta Elektronike	contact@sicred.com.al		infolife@sigal.com.al	elnar.gashi@mai-cee.com
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 12 dt. 22.06.2012	Nr. 8 dt. 26.07.2004	Nr. 11 dt. 28.07.2004	Nr. 1 dt. 11.09.2008
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
	13. 3B BROKER sh.a.	14. DEVON sh.a.	15. ALL - SIG sh.a.	16. A-EJA INSURANCE BROKER sh.a.
Drejtor i Përgjithshëm	Bashkim KRYEZIU	Valbona ÇARÇANI	Rezarta ZHUKRI	Anila QËNDRO
Fusha e Aktivitetit	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas
Adresa e Selisë	Rr. "Mustafa Matohiti", pallati 7, shk. 2, ap.8, Tiranë	Pallati i Kulturës, QTZHK, Sheshi Skënderbej, Tiranë	Rr. "Abdyl Frasherit", pallati De Rada, Tiranë	Rr. "Pjetër Bogdani", Pall 20, kat 1, Tiranë
Tel./Faks	+355 42 248 768/42 248 756	+355 42 4525270, +355 69 6067005	+355 42 257 903 / 42 238 018,	+355 42 249 952 +355 42 227 307
Faqja e Internetit	info@3bbroker.al	info@devon.al	info@allsigbroker.al	a.qendro@a-ejainsurance.com
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 2 dt. 26.03.2009	Nr. 3 dt. 10.12.2009 Nr. 12 dt. 23.12.2013	Nr. 5 dt. 19.03.2010 Nr. 15 dt. 28.04.2016	Nr. 7 dt. 21.05.2010
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat



	17. WVP Ndërmjetës në sigurime sh.a.	18. STAR BROKER sh.a.	19. IFIS Broker sh.a.	20. FIDENTIA sh.a. Broker në sigurime sh.a.
FFIF/Drejtor i Përgjithshëm	Ardian KELMENDI	Arben SIMAKU	Edmira MUÇKA	Përparim ISUFI
Fusha e Aktivitetit	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës dhe Jetës	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës	Broker në sigurime në klasat e Jo-Jetës, Jetës dhe Risigurime	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të vendas
Adresa e Selisë	Rr. "Sami Frashëri", Pallati Vortek 2, shkalla 2, Ap.5, Tiranë	Rruga "Nikolla Tupa", ndërtesa nr. 4, kati I, Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Pallati 2K, kati 8, Ap.40, Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Nr.27, Kulla Fratari, Kati 1, Tiranë Kutia Postare 2408/1
Tel./Faks	+355 42 224 525	+355 69 40 37 001	+355 69 20 87 987	+355 42 269 435 /69 20 45 790
Faqja e Internetit	www.wvp.al			www.fidentia.al
Posta Elektronike	wvptirana@vp.al	arben.simaku@starbroker.al	ifs@ifis.al	info@fidentia.al
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 10 dt. 25.04.2012	Nr. 11 dt. 23.05.2013	Nr. 13 dt. 23.01.2014	Nr. 14 dt. 26.11.2015
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
	21. BEST BROKER SIGURIME Sh.a.	22. RAIFFEISEN BANK sh.a.	23. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a.	24. ALPHA BANK sh.a.
Drejtor i Përgjithshëm	Olti PECINI	Christian CANACARIS	Seyhan PENCAPLIGIL	Periklis DROUGKAS
Përgjegjësi i njësisë së brokerimit		Gentiana GJINO	Klaida EMINAJ	Jerina LLUKMANI
Fusha e Aktivitetit	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës dhe Jetës	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës dhe Jetës	Broker në sigurime për klasat e Jo-Jetës dhe Jetës
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj
Adresa e Selisë	Rr. "Reshit Çollaku", pall.24, shk.13, ap.5, Tiranë,	Rr. e Kavajës, Pall.71, shk.1, Ap.4, Tiranë	Bul. "Zhan D'ark", Tiranë	Rr. Kavajës, G-KOM Business Center, Tiranë
Tel./Faks	+355 66 20 53 172	+355 42 226 699 +355 42 275 599	+355 4 250 955 +355 4 250 956	+355 42 233 550
Faqja e Internetit		www.raiffeisen.al	www.bkt.com.al	www.alphabank.al
Posta Elektronike	infobestbroker@gmail.com	info@raiffeisen.al	info@bkt.com.al	qualityassurance.albania@alpha.gr
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 16 datë 30.05.2016	Nr. 17 dt. 31.10.2016	Nr. 18 dt. 27.12.2016	Nr. 19 dt. 27.12.2016
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat

TREGU I LETRAVE ME VLERË

<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	1. RAIFFEISEN BANK sh.a.	2. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a.	3. INTESA SAN PAOLO Bank Albania sh.a.	4. ALPHA BANK -Tirana sh.a.
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Christian CANACARIS	Seyhan PENCAPLIGIL	Silvio PEDRAZZI	Periklis DROUGKAS
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.
<i>Adresa e Selisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj Bul. "Zhan D'arik", Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj "Rruga e Kavajës", G-KOM Business Center, Tiranë
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 226 699 +355 42 275 599	+355 4 250 955 +355 4 250 956	+355 42 276 000 +355 42 248 762	+355 42 233 550
<i>Faqja e Internetit</i>	www.raiffeisen.al	www.bkt.com.al	www.intesasanpaolobank.al	www.alphabank.al
<i>Posta Elektronike</i>	info@raiffeisen.al	info@bkt.com.al	opinton@intesasanpaolobank.al	qualityassurance.albania@alpha.gr
<i>Nr. Licencës/ Data e licencës</i>	Nr. 3 dt. 25.06.2009 Nr. 6 dt. 29.09.2010	Nr. 4 dt. 25.06.2009 Nr. 7 dt. 18.11.2010	Nr. 6 dt. 25.06.2009 Nr. 2 dt. 21.05.2010	Nr. 7 dt. 25.06.2009 Nr. 3 dt. 28.06.2010
<i>Data e mbarimit të licencës</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	5. BANKA CREDINS sh.a.	6. BANKA E TIRANËS sh.a.	7. BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a.	8. BANKA NDERKOMBËTARE TREGTARE sh.a.
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Maitin KORKUTI	Dritan MUSTAFA	Frederic BLANC	Gideon Van Den BROEK
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. dhe obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të Qeverisë vendore	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH.	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë
<i>Adresa e Selisë</i>	Shoqëri me kapital vendas Rr. "Ismail Qemali", Nr. 4, Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake I, Tiranë	Shoqëri me kapital të huaj Rr. "Murat Toptani", kati VII, pranë Gjergji Center, Tiranë
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 234 096 +355 42 222 916	+355 42 277 700 +355 42 263 022	+355 42 280 442/3 +355 42 280 441	+ 355 42 256 254 + 355 42 254 368


Faqja e Internetit	www.bankacredins.com	www.tiranabank.al	www.societegenerale.al	www.icbank-albania.com
Posta Elektronike	info@bankacredins.com	info@tiranabank.al	info@societegenerale.al	enquiry@icbank-albania.com
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 8 dt. 25.06.2009 Nr. 4 dt. 30.08.2010 Nr. 1 dt. 13.12.2011	Nr. 1 dt. 21.05.2010 Nr. 1 dt. 21.05.2010	Nr. 5 dt. 25.06.2009 Nr. 8 dt. 13.12.2011 Nr. 5/1 dt. 21.03.2012	Nr. 11 dt. 25.06.2009
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
9. FIRST INVESTMENT BANK sh.a.				
Drejtor Ekzekutiv	Bozhidar TODOROV	Majlind Lazimi	Lirim MUHAREMI	Mirela ANGJELI
Fusha e Aktivitetit	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë dhe Kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së R.SH. dhe i obligacioneve të shoqërive akcionare dhe të qeverisë vendore	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë (bono thesari) të Qeverisë së R.SH. në tregun me pakicë	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë dhe tregun me pakicë	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të Qeverisë së R.SH. në bursë
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital shtetëror	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital vendas
Adresa e Selisë	Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 kati i 14 & 15, Tiranë	Rr. "Reshit Collaku", nr. 4, Tiranë	Vila "Ajet Metaj", Njesia Bashkiake Nr.1, ish Uzina e Autotraktoreve, Tiranë	Rr. "M. Gjollështa", Kulla 2, ap. 13, Tiranë
Tel./Faks	+355 42 256 423/424 +355 42 256 422	+ 355 42 222 315 + 355 42 266 559	+355 42 280 202	+355 68 20 58 275 +355 42 256 081
Faqja e Internetit	www.fibank.com	www.postashqiptare.al		
Posta Elektronike		posta@postashqiptare.al		
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 12 dt. 29.09.2010 Nr. 5 dt. 29.09.2010 Nr. 2 dt. 23.12.2014	Nr. 10 dt. 25.06.2009	Nr. 9 dt. 25.06.2009	Nr. 2 dt. 25.06.2009
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat
10. POSTASHQIPTARE sh.a.				
11. KAPITAL INVEST sh.a.				
12. TRIUMF GROUP sh.a.				



	13. AKSIONER INTERNATIONAL SECURITIES BROKERAGE sh.a.	14. STOCK INTERNATIONAL ALBANIA sh.a	15. APIA WEALTH MANAGEMENT ALBANIA sh.a.	16. BURSA E TIRANËS
Drejtor	Alma HASANAJ	Eni KOÇO	Aleksandër PRIFTI	Pezullim i përkohshëm i veprimtarisë në përputhje me vendimin e aksionerit nr. 16, datë 07.04.2015
Fusha e Aktivitetit	Shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e R.SH., Agjent brokeri në letra me vlerë në emër dhe llogari të shoqërisë "Saxo Bank" si dhe Shoqëri këshillimi për investime në tituj	Shoqëri brokerimi në tituj për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në tregun e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Agjent brokeri në letra me vlerë në emër dhe për llogari të "LeadCapital Markets" Ltd, firme brokerimi në emër dhe për llogari të "LeadCapital Markets" Ltd	Shoqëri këshillimi për investime në tituj	Treg i organizuar letrash me vlerë
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital shtetëror
Adresa e Selisë	Rr. "Qemal Stafa", pall. 31.njësia tregtare 2, nr. 20, Tiranë	Rr. "Sami Frashëri", Pall. 2/251, sipër "Alpha Bank" sh.a., Tiranë.	Rr. "Sheshi "Italia", Sheraton, ambjent R.T. B7" Tiranë	Rr. "Rr. "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë
Tel./Faks	+355 44 400 600	+355 44 10 50 10		
Faqja e Internetit	www.aksioner.com	www.stock.com		
Posta Elektronike	info@aksioner.com ekoco@al.stock.com	aprifti@apiawealthmanagement.com		
Nr. Licencës/ Data e Licencës	Nr. 64 dt. 28.04.2011 Nr. 2 dt. 29.09.2016 Nr. 13 dt. 28.04.2011 Nr. 14 dt. 30.06.2015	Nr. 1 dt 16.07.2013	Dt. 13.07.2007	
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat

	17. QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE sh.a.	18. BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE sh.a.
Drejtor	Ardian MYSLIMAJ	Andi BALLTA
Fusha e Aktivitetit	Regjistruues i aksioneve të shoqërive tregtare	Shoqëri brokerimi në letra me vlerë të qeverisë të R.SH në bursë dhe në tregun me pakicë dhe Kujdestar i titujve të Qeverisë së R.SH
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital shtetëror	Shoqëri me kapital të huaj
Adresa e Selisë	Rr. "George W. Bush", Nr. 13, Kutia Postare 7424, Tiranë	Rr. e Kavajës, Ndërtesa Z7, Kati VIII, Kodi Postar 1001, Tiranë
Tel./Faks	+355 42 233 442, +355 42 233 425	+355 44537253; +355 4225875
Faqja e Internetit	www.qra.al	www.abi.al
Posta Elektronike	info@qra.al	ggjonca@abi.al
Nr. Licencës/ Data e licencës	dt. 05.11.2002	Nr.15 dt. 31.10.2016 Nr. 9 dt. 31.10.2016
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat

FONDI I INVESTIMIT	FONDI I INVESTIMIT	FONDI I INVESTIMIT
RAIFFEISEN PRESTIGJ	"RAIFFEISEN INVEST EURO"	"CREDINS PREMIUM"
(Ref. FI-B1)	(Ref. FI-B2)	(Ref. FI-B3)
Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a.	Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a.	Nën administrimin e "CREDINS INVEST"-Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a.



TREGU I PENSIONEVE PRIVATE VULLNETARE

	1. Raiffeisen Invest - Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a.	2. Shoqëri administruese e fondeve të pensionit SIGAL-LIFE Uniq Group Austria sh. a.	3. "CREDINS INVEST"-Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh. a.	4. FIRST INVESTMENT Bank sh.a.
<i>Administrator i Përgjithshëm</i>	Resmi HIBRAJ	Naim HASA	Estela KOCI	Bozhidar TODOROV
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive	Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar	Shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit si dhe administrimin e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive	Depozitar i asetëve të fondeve të pensionit vullnetar dhe i sipërmarrjeve të investimeve kolektive
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital vendas	Shoqëri me kapital të huaj
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Bajram Curri", ETC Kati 10, Tiranë.	Bul. "Zogu I", Tiranë	Rr. Nikolla Tùpe, nr.1 , kati 3, Tiranë, pranë ambasadës Daneze	Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2 Kati i 14 & 15, Tiranë
<i>Tel./Faks</i>	+ 355 42 277 901 +355 42 277 905	+355 42 233 308 +355 42 250 220	+355 45 351 030	+355 42 276 702/3 +355 42 280 210
<i>Faqja e Internetit</i>	www.raiffeisen.al	www.fpsigal.com.al	www.credinsinvest.com	www.fibank.com
<i>Posta Elektronike</i>	invest@raiffeisen.al	naimhasa@sigal.com.al	contact@credinsinvest.com	
<i>Nr. Licencës/ Data e licencës</i>	Nr. 1 dt.13.12.2011	Nr. 2 dt. 30.03.2011	Nr. 3 dt. 30.05.2016	Nr. 1 dt. 13.12.2011
<i>Data e mbarimit të licencës</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat	Pa afat

	5. BANKA E TIRANËS sh.a.	6. SOCIETE GENERALE ALBANIA sh.a.	7. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a.
Drejtor Ekzekutiv	Dritan MUJSTAFI	Frederic BLANC	Seyhan PENCAPLIGIL
Fusha e Aktivitetit	Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar	Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar	Depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital privat të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital të huaj
Adresa e Selisë	Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë	Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake I, Tiranë	Bul. "Zhan D'ark", Tiranë
Tel./Faks	+355 42 269 616/617/429 +355 42 269 707	+355 42 280 442/3 +355 42 280 441	+355 4 250 955 +355 4 250 956
Faqja e Internetit	www.tiranabank.al	www.societegenerale.al	www.bkt.com.al
Posta Elektronike	info@tiranabank.net	info@socgen.com	info@bkt.com.al
Nr. Licencës/ Data e licencës	Nr. 2 dt. 18.11.2010	Nr. 3 dt. 13.12.2011	Nr. 4 dt. 21.12.2015
Data e mbarimit të licencës	Pa afat	Pa afat	Pa afat
	FONDI I PENSIONIT VULLNETAR RAIFFEISEN (Ref. FP 1)	FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SIGAL (Ref. FP 2)	FONDI I PENSIONIT VULLNETAR SICRED PENSIONS (Ref. FP 3)
	Nën administrimin e "Raiffeisen Invest-shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive" sh.a.	Nën administrimin e "Shoqërisë administruese të fondeve të SIGAL-Life Uniq Group Austria" sh.a.	Nën administrimin e "CREDINS INVEST"-Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a.



SHTOJCA C


Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara

A. Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorëve	Viti	Institucioni
IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë)	1998	KLY (sot AMF)
IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve)	2001	AMS (sot AMF)
IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve)	2006	AMF
B. Marrëveshje të Nënshkruara me Institucione Homologe Jashtë Vendit		
Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë	1999	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebecut (Autoriteti i Tregjeve Financiare të Quebec)	2000	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës i Italisë	2002	KLY (sot AMF)
Agjencia e Tregut të Letrave me Vlerë të Sllovenisë	2003	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë)	2003	KLY (sot AMF)
Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë	2003	KLY (sot AMF)
Autoriteti Bankar dhe Pagesave i Kosovës (sot Banka Qendrore e Republikës së Kosovës)	2004	AMS (sot AMF)
Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë	2005	KLY (sot AMF)
Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë	2005	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Maqedonisë	2005	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursës së Malit të Zi	2005	KLY (sot AMF)
Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë (sot Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë)	2005	KLY (sot AMF)
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)	2008	AMF
Ministria Austriake e Financave & Autoriteti i Tregut Financiar të Austrisë	2009	AMF
Marrëveshja Multilaterale e Mirëkuptimit me IOSCO-n	2009	AMF

Agjencia e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA)	2010	AMF
Agjencioni për Mbiqëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)	2012	AMF
Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA)	2013	AMF
Agjencia e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve, (Slloveni)	2016	AMF
Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare Zvicerane FINMA	2016	AMF


C. Marrëveshje të Nënshkruara me Organizata Brenda Vendit

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	2002	KLV (sot AMF)
Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)	2003	KLV (sot AMF)
Banka e Shqipërisë	2005	AMS, KLV (sot AMF)
Autoriteti i Konkurrencës	2006	AMF
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2009	AMF
Bordi i Mbiqëqyrjes Publike	2010	AMF
Ministria e Brendshme	2011	AMF
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	2011	AMF
Marrëveshje në kuadrin e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF)	2012	AMF
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	2012	AMF
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	2016	AMF



SHTOJCA D

Raporti i Ekspertit Kontabël të Regjistruar të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Bordin Drejtues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Sh.p.k ("Institucioni" ose ("AMF")), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondet bazë dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit me datën 31 dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin


Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Institucioni në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Institucionit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Institucionin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit.



Përgjegjësi e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënie të informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me çëverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kledian Kodva, FCK

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
13 prill 2017




Pasqyra e Pozicionit Financiar

	31 dhjetor 2016 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)
Aktivitet		
Aktivitet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	59,215,573	56,762,366
Aktive afatgjata jo materiale	377,838	503,784
Total i aktiveve afatgjata	59,593,411	57,266,150
Aktivitet qarkulluese		
Mjetet monetare	217,936,822	151,334,638
Llogari të arkëtueshme	38,332,986	25,783,135
Llogari të tjera të arkëtueshme	88,165	111,421
Aktive të tjera (Garanci Bankare)	20,000	20,000
Total i aktiveve qarkulluese	256,377,973	177,249,194
Total i aktiveve	315,971,384	234,515,344
Pasivet		
Fondet e veta		
Fonde bazë	119,287,505	119,287,505
Rezerva	97,138,000	78,829,000
Rezultatet e mbartura	-	-
Totali i fondeve të veta	216,425,505	198,116,505
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	5,771,818	2,394,148
Detyrime për tatim taksa	4,715,798	2,622,430
Detyrime ndaj subjekteve të mbikëqyrura	83,711,263	25,149,081
Të tjera të pagueshme	14,380	-
Fondi i provizionit	5,332,620	6,233,180
Totali i detyrimeve afatshkurtra	99,545,879	36,398,839
Totali i Pasivit	315,971,384	234,515,344

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i AMF-së, më 10 prill 2017 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Znj. Mimoza Kaçi	Znj. Suzana Nana	Znj. Vangjelina Koçollari
Nëndrejtor Ekzekutiv	Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit Financiar	Specialiste e Sektorit të Administrimit Financiar



Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	31 dhjetor 2016 (Shuma në lekë)	31 dhjetor 2015 (Shuma në lekë)
Të Ardhurat		
Nga njësi ekonomike publike dhe private financiare	283,475,239	254,682,958
Gjoha dhe kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	14,100,000	340,000
Total	297,575,239	255,022,958
Shpenzime Operative		
Shpenzime korrente	(133,687,076)	(87,429,173)
Mallra dhe shërbime të tjera	(54,016,157)	(49,185,525)
Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara	(6,548,645)	(6,401,442)
Nxjerrje jashtë përdorimit	(211,162)	(355,978)
Total	(194,463,040)	(143,372,118)
Rezultati Operacional	103,112,199	111,650,840
Të Ardhura/(Shpenzime Financiare)		
Të ardhura nga interesat e depozitave	392,333	103,513
Humbje nga kursi i këmbimit	(1,484,269)	(1,080,253)
Total	(1,091,936)	(976,740)
Rezultati i Vitit	102,020,263	110,674,100
Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera		
Total i të ardhurave gjithpërfshirëse të vitit	102,020,263	110,674,100


SHTOJCA E PASQYRIMI MEDIATIK PËR TREGJET NËN MBIKËQYRJEN E AMF-së

Paqyrimi mediatik për të gjitha tregjet

Tendenca rritëse e pasqyritit mediatik të veprimtarisë së AMF-së vihet re edhe në numrin e pasqyrimeve në shtypin e shkruar, televizione dhe mediat online si më poshtë:

Grafik 51: Pasqyrimi mediatik i aktiviteteve të AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje në vite

(Në numër)



Në maj 2016, Bordi i AMF-së miratoi edhe Rregulloren nr. 75 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së Internetit” e cila përcakton procedurat në lidhje me funksionimin sa më të mirë të komunikimit të Autoritetit me median, publikun dhe jep përmbajtjen dhe klasifikimin e publikimeve, si dhe hartimin dhe funksionimin e faqes zyrtare të internetit të Autoritetit.


Edhe gjatë vitit 2016 tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen online të AMF-së ka shkuar paralel me zhvillimet e tanishme të medias në vend, ku komunikimet dixhitale po zëvendësojnë gradualisht komunikimet me mediat tradicionale duke u shndërruar në formën prioritare të komunikimit.

Gjatë vitit 2016, në faqen online të AMF-së ka pasur 487,589 klikime me një rritje rreth 22% të numrit të klikimeve krahasuar me vitin 2015. Në numrin e rritur të klikimeve ka ndikuar edhe hyrja e vizitorëve të rinj. Ata që hynin për herë të parë në faqe të cilët zin rreth 29% të numrit total të vizitorëve. Duke ju referuar informacioneve të vendosura në faqen online, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga AMF si edhe direktivat e ndryshme. Mbi 31% e klikimeve në faqen online janë për të lexuar lajmet e publikimet e ndryshme të bëra online. Një pjesë e rëndësishme e klikimeve, rreth 21% është e interesuar për publikimet e informacioneve statistikore për tregjet nën mbikëqyrje.



Grafik 52: Struktura e klikimeve në faqen online të AMF-së, 2016

(Në %)



Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si Itali, Kosovë, Spanjë, SHBA, Gjermani, Greqi dhe Angli.

Botimet e AMF-së

- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve
- Buletini Zyrtar
- Analiza e Vrojtimit: Qëndrimi i Ndërmarrjeve për Skemat e Pensioneve Private në Shqipëri
- Botimi i Punimeve të Konferencës “Sistemi i Pensioneve Vullnetare në Shqipëri – Zgjerimi i Mbulimit”
- Fletëpalosjet për tre tregjet nën mbikëqyrje

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare

